

**Debat**

**Pushteti për paga të larta, opozita kundër**

Fq.3



**GJYQËSORI I VENDIT**

**Për 5 vjet, 127 gjykatës më pak**

Fq.5



**Të jemi pjekur?!**

**Adelina Marku**

Fq.10



# Koha

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XII · Numri 3359 · e martë 8 maj, 2018

12°C | 24°C

15 DEN



**KOHA për kulturë**

Fq.12-15

**EDITORIAL**

**Shoqëria shqiptare, më e gjerë se individët**



Shoqëria shqiptare është shumë më e gjerë se sa individët, të cilët edhe mund të jenë të dobishëm në kryerjen e obligimeve e përgjegjësi të caktuara. Kryeministri Zoran Zaev, që ka proklamuar prej fillimit se do ta dëgjojë zërin e gjithsecilit që ka ide progresive në këtë vend, është mirë ta zgjerojë gamën e observimit, duke kaluar nga individët, tek grupet e interesit. Shpesh na ka rënë të dëgjojmë për...

Fq.2

**RAJON**

**Trumpi t'i kthejë sytë nga Ballkani**

Fq.16

**GLOBI**

**Kostoja e depresionit në Evropë, miliarda dollarë**

Fq.17



**KAFENETË, SI BAROMETËR**

# PARAJSË E RREJSHME SOCIALE



**Të papunë, por me para të mjaftueshme për të bjerrë kohën nëpër kafene. Kjo është pamja aktuale që aktualisht zotëron në shumë qytete të Maqedonisë, kurse sociologët janë të mendimit se mungesa e angazhimeve kreative ka bërë që të rinjtë të gjejnë alternativa, të cilat nuk kanë kurrfarë dobie as personale, as publike**

Fq.6

## Punë ka, por s'ka zanatçinj

Shkup, 7 maj - Biznesi privat në Maqedoni viteve të fundit ndeshet me fuqi punëtore të pakualifikuar, për shkak se nëse dikur këtë rol e kishin qendrat për rikualifikim të punëtorëve, si elektrikistë zdrukthëtarë, murator apo saldues - sot asnjë qendër arsimore në Maqedoni nuk e luan më këtë rol, ndërsa për të siguruar fuqi punëtore stabile, ky angazhim i mbetet vet sektorit të biznesit privat që të përgatit kua-

dro me kohë. Arben Halili nga Oda Ekonomike e Maqedonisë Veriperëndimore thotë se në Maqedoni, për momentin ekziston një gjendje latente në aspekt të thellimit të bashkëpunimit ndërmjet sektorit të biznesit dhe kompanive private. "Pavarësisht formave të ndryshme deklarative, realiteti në praktikë dëshmon që vullneti për të bashkëpunuar me veprimet konkrete të ndërmarra deri më tani..."

Fq.7





## EDITORIAL

SHOQËRIA  
SHQIPTARE, MË E  
GJERË SE INDIVIDËT

Emin AZEMI

Nëse një parti nuk tregohet e denjë të reagojë me kohë në eliminimin e anomalive brenda saj, atëherë do të gjenden plot individë jashtë saj që do të joshen nga liderët maqedonas dhe askush askujt në një shoqëri të lirë nuk mundet t'ia ndalojë angazhimet, qofshin ato edhe për përfitime personale

Shoqëria shqiptare është shumë më e gjerë se sa individët, të cilët edhe mund të jenë të dobishëm në kryerjen e obligimeve e përgjegjësi të caktuara. Kryeministri Zoran Zaev, që ka proklamuar prej fillimit se do ta dëgjojë zërin e gjithsecilit që ka ide progresive në këtë vend, është mirë ta zgjerojë gamën e observimit, duke kaluar nga individët, tek grupet e interesit. Shpesh na ka rënë të dëgjojmë për individë, të cilët kauzat e tyre personale i manifestojnë si kolektive, ndërkohë që përfitimet vazhdojnë të jenë vetëm personale. Jo rastësisht një shoqëri moderne funksionon mbi parimet kolektive të menaxhimit të resurseve profesionale e humane për interesa publike. Edhe kryeministri Zaev sigurisht që nuk i ka harruar këto parime, dhe ai nuk e ka të ndaluar që edhe brenda shoqërisë shqiptare të angazhojë individë, për të cilët mendon se janë të dobishëm për punë që ai i trajton me "kontratë në vepër". Fundja, teknologjia e përfaqësimit institucional tashmë ka një skemë mirë të përpunuar në Maqedoni dhe zor se ka dikush që mund të bindet për nevojën e aktivizimit të "motorëve dytaktësh" në sferën e përfaqësimit. Shqiptarët mund të jenë ekstremisht të pakënaqur me cilësinë e përfaqësimit nga ana e përfaqësuesve të tyre në institucione, mirëpo askush nuk mundet ta kontestojë këtë skemë që po funksionon, madje as kryeministri Zaev. Ky i fundit ka të drejtë të kërkojë e gurmtojë në shoqërinë shqiptare individë, të cilët mund të kryejnë detyra me nder nëpër institucione, por kjo nuk e mbyll dot ventilimin e prurjeve të reja nga grupe joformale brenda shoqërisë shqiptare, të cilët mund të jenë shumë më kreativ në ide dhe angazhime. Por, ajo çka është edhe më e rëndësishme, kryeministri Zaev duhet të mbajë llogari edhe për dimensionin etik të asaj që ai për momentin ndoshta nuk e ka marrë parasysh e që ka të bëjë me ruajtjen e frymës së konstruktivitetit dhe mirëbesimit me partnerët shqiptarë të koalicionit, të cilët në asnjë mënyrë nuk guxon t'i iritojë me ndonjë prurje individuale (rasti i Boshkovskit e ndonjë tjetër).

Se shoqëria shqiptare është shumë më e gjerë se sa individët, këtë do të duhej ta kenë kuptuar edhe partitë politike, të cilat duhet të hapen proporcionalisht me kapacitetet që aktualisht i ka kjo shoqëri. Nëse një parti perceptohet si kufiri që ndan të diturit nga të paditurit, të shkolluarit nga aktivistët hallexhinj, atëherë liderhipi i saj do të duhej urgjentisht ta ndryshojë këtë perceptim. Nëse një parti nuk tregohet e denjë të reagojë me kohë në eliminimin e anomalive brenda saj, atëherë do të gjenden plot individë jashtë saj që do të joshen nga liderët maqedonas dhe askush askujt në një shoqëri të lirë nuk mundet t'ia ndalojë angazhimet, qofshin ato edhe për përfitime personale. Por, në anën tjetër, nuk mendojmë se shoqëria shqiptare është aq e atrofuar sa të mos mund të absorbojë një dinamizëm më riprodhues të ideve e shanseve.

## KOSOVA, HARADINAJ DHE POLITIKA E JASHTME

"Një lapsus i kryeministrit Haradinaj u keqpërdor nga politika në Serbi. Në një televizion të Beogradit ai deklaroi se Kosova nuk ka politikë të vet të jashtme, gjegjësisht bën pjesë në atë grup shtetesh politika e jashtme e të cilave bëhet në Ëashington. Në Beograd ky konstatim u shfrytëzua për të treguar se vetë shqiptarët mohojnë shtetësinë e Kosovës. 'Çfarë shteti është ai që thotë se nuk ka politikë të jashtme të veten?', pyetën apo konstatuan liderët serbë.

Më duket se kryeministri, në vrullin për të treguar afërsinë e Kosovës me Amerikën, deshi të thoshte se, duke qenë nën mbrojtje të Amerikës, Kosova është në masë të madhe e lidhur në politikën e vet të jashtme e të sigurisë me Ëashingtonin. I doli, në thjeshtësim, formulimi, se Kosova nuk ka politikë të veten të jashtme.

Dhe, pastaj dolën komentet zhvlerësuese ndaj tij dhe Kosovës në Beograd.

Në fakt, kryeministri nuk ishte larg të së vërtetës. Kosova në masë të madhe ka treguar se nuk ka politikë të jashtme. Shpallja e pavarësisë së vendit (dhe këtë e di nga dora e parë, sepse kam qenë i përfshirë në fazën finale) ka qenë e përgatitur nga SHBA-ja dhe shtetet mike, në radhë të parë Britania e Madhe, Franca dhe Gjermania. Fushata e lobimit për njohje po ashtu. Ka pasur më shumë diplomatë francezë, për shembull, të angazhuar në njohjen e pavarësisë së Kosovës sesa ka pasur të punësuar Ministria e Jashtme e Kosovës, me shoferë e personel teknik", shkruan në profilin e tij në Facebook, publicisti Veton Surroi.

## ÇMENDURIA E TRANSICIONIT SHQIPTAR!?

"Derisa në Perëndim të PASURIT bëjnë biznes e POLITIKANËT rikonfirmojnë ligjësinë e shtetit, në Shqipëri dhe në Kosovë POLITIKANËT bëjnë biznes duke e KORRUPTUAR shtetin, kurse të pasurit duke varfëruar atë!", shkruan në profilin e tij në Facebook, sociologu kosovar Fadil Maloku

## KU MBETI GRAVITETI

"Vetëm Komuna e Likovës i ka 270 kilometër katror. 1 kilometër katror ka 1 milion metër katror. Komuna ka 270 milionë metër katror. Nëse në territorin e Komunës së Likovës bie shi 5 milimetra trashësi, do të thotë bien 1.350 milion litra ujë. Tek uji, litri është i barabartë me kilogramin. Kjo i bie që: me një shij 5 milimetra trashësi, bien 1.350.000.000 kilogram ujë (shi). Fenomeni nuk është këtu. Fenomeni është në faktin se e tërë kjo peshë qëndron diku rreth 2000 metra lartësi mbi sipërfaqen e tokës e nuk peshon as një kilogram meqë nuk bie në tokë po ndodh që as shi nuk bie vetëm kalon. Ku mbeti graviteti. Sepse, për ta mbajtur një avion në lartësi nga toka, dihet se çfarë motori dhe me çfarë fuqie duhet patur. Kjo sa për përkujtim dhe për të thënë. I lartësuar është ai që krijoi qiejt dhe token dhe gjithçka ne mes tyre", shkruan në profilin e tij në Facebook, aktivisti nga Kumanova, Sead Ramadani.

## MEDIACitate

CILADO  
ZGJIDHJE PËR  
KOSOVËN,  
ËSHTË FUNDI  
IM POLITIK

"Kur bëhet fjalë për zgjidhjen për Kosovën, shpresoj për zgjidhje. E di, cilado qoftë zgjidhja, ajo është fundi im në politikë", citon Kurir i Beogradit të ketë thënë Aleksandar Vučić. "Serbët janë të tillë. Serbët kurrë nuk do ta falin të ardhmen e vet më të mirë dhe paqen. Pra, në Serbi kremtohen vetëm disfata dhe luftërat", ka theksuar Vučić duke shtuar se mendon kështu pasi një serbë të cilët, ndër të tjera, nuk e kanë përkujtuar askënd që e ka siguruar dhe e ka sjellë paqen. "Jo, i kem i respektuar vetëm udhëheqësit e luftërave dhe askënd tjetër. Jam krejtësisht i sigurt se për çfarëdo vendimi për Kosovën, nuk do ta kem as mirëkuptimin dhe as shumicën e popullit tonë, por jam i sigurt se për këtë në të ardhmen do të ketë një këndvështrim tjetër për mua e edhe për rolin tim gjatë historisë rreth asaj çfarë është mundur dhe çfarë është dashur të bëhej", ka thënë Vučić, transmeton Koha.net. Për atë që është e pranueshme për të lidhur me Kosovën, kryetari i Serbisë Aleksandar Vučić thotë se nuk dëshiron të flasë publikisht, pasi që ai në këtë rast, nuk do të fliste me askënd. "Kam menduar të flas, sepse nuk më vjen turp nga ajo. Dhe atë do t'ia sqaroj lehtë popullit serb dhe çdo i mençur e normal këtë do ta kuptonte mirë, por nuk mund të dal me këtë në opinion për shkak se kështu do ta dobësoja pozitën juridike - ndërkombëtare të Serbisë para bisedimeve dhe negociatave. Këtë duhet ta kuptojnë njerëzit", ka thënë Vučić.

(Kurir, 7 maj)

NËSE NUK  
E KENI DITUR...

## Çfarë është Baptisteri i Butrintit?

Baptisteri i Butrintit është monument i rëndësishëm i periudhës paleokristiane. Përbëhet nga salla e pagëzimit dhe një sallë ndihmëse në veri të saj, të dyja të shtruara me mozaik. Salla e parë është rrethore në plan me diametër 13.50 m, brendashkruar një kuadrati, me dy radhë kolonash graniti. Figurat e mozaikut, kryesisht nga bota e kafshëve, janë vendosur në 69 medalione në shtatë rathë bashkëqendrorë, që

ndërpriten nga dy skena. Salla mendohet të jetë mbuluar me sistem qemeresh e kupolë qendrore mbi kolonat. Është ndërtuar në mesin e shek.VI. Edhe salla tjetër përafërsisht drejtqëndëshe, është e shtruar me mozaik me motive nga bota shtazore e figura gjeometrike. Mozaikët kanë vlera të veçanta artistike dhe zbukurimorja paraqet karakteristika të përbashkëta për një krahinë të gjerë që nga Vjosa deri në Nikopojë.



Shërbimet parlamentare në kushte anonimët i thanë gazetës KOHA se debati për pagat e anëtarëve të Këshillit të Agjencisë për media do të zgjatet dhe VMRO do të fitojë kohë për shkakun se nuk kanë mundur të merren vesh me LSDM-në për Ligjin e RTVM-së, konkretisht me ligjin e ri Qeveria propozon që anëtarët e Këshillit Programor të shkarkohen dhe të zgjidhen të rinj, derisa opozita kërkon të mbeten të vjetrit derisa t'u mbarojë mandati

VAZHDON DEBATI PËR LIGJIN E MEDIAVE

# PUSHTETI PËR PAGA TË LARTA, OPOZITA KUNDËR



Koha Fatos RUSHITI

Shkup, 7 maj - Të hënën, në Komision për transport, lidhje dhe ekonomi - pushteti dhe opozita debatuan mbi Ligjin për shërbime audio dhe audio-vizuale. Deputetët e VMRO-së akuzuan deputetët e LSDM-së se ndryshe kanë premtuar dhe kritikuar sa ishin në opozitë sa i përket harxhimeve të buxhetit të shtetit për paga dhe kompensime tjera, e ndryshe veprojnë kur janë në pushtet. Ishte deputetja e VMRO-së, Sllagjana Mitovska, e cila propozoi uljen nga katër paga sa paga mesatare mujore sa i kanë aktualisht - në dy paga mesatare për kompensim mujor për anëtarët e Këshillit të Agjencisë për media dhe shërbime audio dhe audio-vizuale, por që nuk mori përkrahjen e deputetëve të pozitës.

Nëse kalkulojmë në shifra, paga mesatare aktualisht është 24 mijë denarë, që i bie mbi 96 mijë denarë apo rreth 1600 euro të marrin pagesë mujore anëtarët e Këshillit të Agjencisë për media.

"Jeni ju ata që kur ishit në opozitë, na kritikonin neve për paga të larta mujore jo vetëm të anëtarëve të Këshillit në Agjencinë për media, por edhe në institucione tjera. Tani nuk pranoni ti zvogëloni në dy paga mesatare - që do të thotë se nuk i përmbaheni premtimeve tuaja parazgjedhore", akuzoi deputetja Mitovska. Nga ana tjetër, ministri për shoqëri informative dhe Administratë Publike, Damjan Mançevki iu përgjigj Mitovskës se propozimi i tyre nuk

mund të pranohet nga fakti se paga mesatare varion gjithmonë dhe dy paga janë pak për punën që e bëjnë anëtarët e Agjencisë për media.

Kundër propozimit të deputetes së VMRO-së doli edhe deputeti BDI-së, Rexhail Ismaili, duke thënë se një ulje e tillë do të ulte në masë interesin e gazetarëve dhe personave tjerë profesionistë për të konkurruar për anëtar të rinj në Këshillin e Agjencisë. "Nëse supozojmë se do të ulim pagën mujore, atëherë nuk jemi të sigurt se kemi profesionistë që do të kenë interes për dy paga mesatare të konkurrojnë për anëtarë të Këshillit të Agjencisë për media. Sipas analizës sonë që kemi bërë si deputetë, në asnjë variant nuk rezulton se kjo ulje do të ndikonte në rritjen e cilësisë së punës në këtë institucion të rëndësishëm për mediat. Ne duhet të vlerë-

sojmë mbi punën e anëtarëve të Këshillit e jo në atë që t'ia ulim pagesën mujore", tha mes tjerash deputeti Ismaili. Në replikën ndaj tij, deputeti i VMRO-së, Nikolla Bocevski, tha se kanë harruar shpejt se ishin në pushtet me VMRO-në dhe tani kur vazhdojnë të jenë në pushtet me LSDM-në, BDI po ndryshon qëndrimet.

"Deri dje ishit me ne në koalicion dhe nuk patët kritika ndaj trupave rregullator, sot flisni ndryshe. Nuk mund të thoni se drejtori nga ana jonë paska punuar keq e zëvendës drejtori nga ana juaj nuk paska vepruar ashtu", tha Nikolla Bocevski. Ne jemi në pushtet, iu përgjigj deputeti Ismaili, se ka thënë populli e jo se ka thënë BDI. "Ju arsyetoni se nuk do të kenë interesim dhe nuk paske mi profesionist që do të pranoinin dy paga mesatare, këtë e thonin ju se nuk paskemi njerëz. Dua t'ju

them se në Maqedoninë më 2 milionë e më shumë banorë kemi profesionist me bollëk që do ta pranoinin të ishin anëtarë të Agjencisë për media", u shpreh në kundër-replikë deputetja Sllagjana Mitovska ndaj deputetit Ismaili. Ndërkaq, shërbimet parlamentare në kushte anonimët i thanë gazetës KOHA se debati për pagat e anëtarëve të Këshillit të Agjencisë për media do të zgjatet dhe duan të marrin kohë për shkakun se nuk kanë mundur të merren vesh për pikën tjetër - atë për Ligjin për servis publik, konkretisht me ligjin e ri Qeveria propozon që anëtarët e Këshillit Programor duhet të shkarkohen dhe të zgjidhen të rinj. Më këtë propozim, opozita nuk po pajtohet duke propozuar që të mbeten të vjetrit derisa t'ju mbarojë mandate pavarësisht Ligjit të ri për RTVM-në.

## VONOHET SHKURTIMI I HARXHIMEVE MUJORE TË DEPUTETËVE

**Akoma po kërkohet model i cili do t'i ulë shpenzimet rrugore të deputetëve. Edhe pse Ligji për paga dhe kompensime për funksionarët e zgjedhur pësoi ndryshime para dy muajve, deputetja e LSDM-së, Frosina Tashevaska-Remenski, shprehet se edhe më tej po përgatitet Rregullorja me të cilën në mënyrë shtesë duhet të ulen shpenzimet që i marrin deputetët. Rregulloren duhet ta miratojnë kryetari i Parlamentit dhe sekretari i përgjithshëm. Ndërkohë, krahas presionit të madh nga opinioni se deputetët marrin shuma të majme për**

**shpenzime rrugore, edhe më tej nuk ka ndryshime drastike dhe shkurtime. Remenski thotë se përveç deputetët, nga shkurtimi i mjeteve rrugore nuk duhet të kursehen as zyrtarët qeveritarë. "Di shumë raste që janë më ekstreme nga ajo që e publikuat në opinion për shpenzimet e deputetëve", deklaroi Remenski, deputete e LSDM-s. Ndërsa Këshilli buxhetor i Parlamentit dje kishte takim me përfaqësuesit e Fondit Monetar Ndërkombëtarë për mënyrën se si të përzgjedhurit e popullit e miratojnë arkën e shtetit.**

## Hoxha mund të ndihmojë nëse paraqiten grupe ekstremiste

Shkup, 7 maj - Xhezair Shaqiri mund të ndihmojë shumë nëse paraqiten grupe të caktuara ekstremiste apo radikale në territorin ku jeton, ku e njeh terrenin, ndërsa mundet edhe në ndërtimin e konceptit "një shoqëri për të gjithë". Këtë e deklaroi dje kryeministri Zoran Zaev duke u përgjigjur në pyetjen e gazetarëve lidhur me emërimin e Shaqirit për këshilltar të tij për siguri të brendshme dhe radikalizëm. "Ai është qytetar i Republikës së Maqedonisë. Në pjesën e ri-socializimit të përgjithshëm apo konsolidimit në shoqërinë tonë dhe në lidhje me konceptin një shoqëri për të gjithë, unë nuk i ndaj qytetarët e Maqedonisë. Besoj absolutisht se secili mund të angazhohet diku si bashkëpunëtor, diku si këshilltar, diku drejtpërdrejtë i punësuar në institucionet publike nëse mund të ndihmojë", tha Zaevi. I pyetur pse Shaqiri nuk është angazhuar në Stacionin e policisë në Tanushë, por është emëruar këshilltar, tha se nëse një person me të kaluar si ai emërohet në Stacionin e policisë në Tanushë, kjo mund të shkaktojë edhe pakënaqësi. "E dimë se në atë kohë, policia e Maqedonisë ka luftuar kundër njerëzve që janë vendosur në luftën kundër policisë së Maqedonisë dhe ai vlen si një kandidat. Besoj se mund të jetë ndihmë e drejtpërdrejtë e kryeministrit, sepse edhe veten e konsideroj nga bartësit e parë të konceptit "një shoqëri për të gjithë", ndërsa edhe një nga përgjegjësit që duhet të mbajnë llogari për shtetin për parandalim të çfarëdo qoftë ekstremizmi apo radikalizmi", tha Zaev.

## Ligji për gjuhët nuk ka arritur në "Gazetën Zyrtare"

Shkup, 7 maj - Ligji për përdorimin e gjuhëve ende nuk ka mbërritur në "Gazetën Zyrtare", deklaroi dje drejtori i NP "Gazeta Zyrtare", Martin Kostovski. "Ende nuk ka mbërritur ligji në ambientet e "Gazetës Zyrtare". "Gazeta Zyrtare" si institucion përgjegjës do të veprojë konform Kushtetutës dhe ligjeve që kanë të bëjnë në publikimin e të gjitha rregullave", tha Kostovski në pyetjen e gazetarëve pas promovimit të botimit special të Kushtetutës së RM-së të hartuar me alfabetin e Braillit. I pyetur të sqarojë se çfarë janë këto procedura, Kostovski theksoi se tani për tani nuk dëshiron të spekulojë. "Kur do të mbërrijë ligji në "Gazetën Zyrtare" do të njoftoheni me kohë. Si kryeredaktor dhe përgjegjës, njëherit edhe si drejtor i "Gazetës Zyrtare" do të veproj në pajtim me Kushtetutën dhe ligjet", tha Kostovski në pyetjen e gazetarëve nëse do të shpallet në "Gazetën zyrtare" ligji pa nënshkrimin e presidentit të shtetit.

## Zaev-Cipras më 17 maj në Sofje

Athinë, 7 maj - Planifikohet, ndërsa në qoftë se nuk ndodh diçka e paparashikuar, më 17 maj në Sofje do të mbahet takim në katër sy ndërmjet Zoran Zaevit dhe Aleksis Cipras, në margjinat e Samimitit BE-Ballkani Perëndimor, bëri të ditur portali informativ grek "Njuz247". Në takimin ndërmjet dy kryeministrave pri-

tet që të kërkohet arritja e marrëveshjes përfundimtare në çështjen e zgjidhjes së "problemit të Maqedonisë". Burime diplomatike për "Njuz247" potencojnë se edhe krahas vështirësive të cilat ekzistojnë, është arritur përparim i rëndësishëm në pjesën më të madhe të temave në bisedimet, edhe krahas asaj që mbetet dalli-

mi kryesor për përdorimin e emrit erga omnes, shkruan portali dhe shton se Zaev dhe Cipras kanë "linjë të hapur telefonike", edhe pse bisedat dhe kontaktet nuk publikohen. Gazetari i portallit komenton se 11 dhe 12 maji janë me rëndësi të madhe për zhvillimin e ngjarjeve, duke pasur parasysh se të premtën, në

kuadër të konferencës në Sunio, sipas të gjitha gjasave Dimitrov dhe Koxias do të realizojnë takim të ri bilateral me ndërmjetësuesin Methju Nimic, raporton korrespondentja e MIA-s nga Athina. "Nimici, mendohet, është i vendosur të bëjë pak më tepër presion për arritjen e zgjidhjes", shkruan portali.





## Ivanovi nuk heq dorë nga Bogovi

Shkup, 7 maj - Banka Popullore e Maqedonisë nuk duhet të lihet pa guvernator, pasi kjo do të kishte implikime negative në ekonominë e vendit janë dakorduar presidenti Gjorge Ivanov dhe kryeministri Zoran Zaev në takim in e djeshëm në Vodno, i cili u mbajt me kërkesë të kryeministrit, ndërsa në të cilin u bisedua për propozimin e Ivanovit për guvernator të BPRM-së. Nga kabineti i presidentit informuan se Ivanov, si edhe në mbledhjen e mëparshme të mbajtur më 26 mars të këtij viti, kryeministrit Zaev ia shpjeguan qëndrimet dhe argumentet se pse mendon se Dimitar Bogov me shumë përgjegjësi do ta ushtrojë këtë funksion të rëndësishëm në Maqedoni dhe përkujtoi qëllimin e tij të atëhershëm, se nëse Bogov jep pëlqim për kandidim të serishëm, ky do të jetë propozimi i presidentit. Në takim, qëndron në kumtesë, është konfirmuar se pasi guvernatori aktual Dimitar Bogov dha pëlqimin e tij, më 25 prill ka realizuar takim me kryeministrin Zaev, të cilit ia shprehu pëlqimin e tij për vendimin e presidentit për rikandidimin e tij. Ivanov para se ta sillte vendimin për propozimin e guvernatorit, gjatë shkurtit dhe marsit të këtij viti ka kryer konsultime me Lidhjen e Odave Ekonomike të Maqedonisë, me Odën Ekonomike të Maqedonisë, me Shoqatën e Bankave, me ASHAM dhe me institucione të tjera dhe individë nga kjo fushë, dhe në të gjitha takimet është konstatuar se Dimitar Bogov është zgjedhja më e mirë për guvernatorin. Në takimin e djeshëm, Ivanov e njoftoi Zaevin se para marrjes së vendimit, ka realizuar gjithashtu takime edhe me kandidatët të tjerë të mundshëm për vendin e guvernatorit. Në takimi është diskutuar edhe për rregullativën ligjore për emërimin e guvernatorit. Është konstatuar se në përputhje me nenin 49 të Ligjit për Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë, guvernatorin e emëron Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, me propozim të Presidentit të Republikës së Maqedonisë.

NJË LETËR E NËNSHKRUAR NGA 30 KONGRESMENË

# IDENTITETI I PANDARË

Diaspora maqedonase në SHBA është duke punuar aktualisht për të gjetur një zgjidhje alternative ndaj bllokimit që i bëhet Maqedonisë nga Greqia



Shkup, 7 maj - Diaspora po punon me një letër të nënshkruar nga 30 kongresmenë amerikanë, që i drejtohet Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s, Jens Stoltenberg ku i kërkohet që të mos lejohet Greqia të bllokojë anëtarësimin e Maqedonisë në NATO. Metodija A. Koloski që drejton "United Macedonian Diaspora" në Uashington thotë për DW se për fat të keq, duhet të ndryshojmë emrin për të qenë pjesë e NATO-s. "Gati 90 për qind e maqedonasve janë kundër ndryshimit të emrit. NATO si organizatë nuk duhet të lejojë një vend të bllokojë pranimin e një vendi tjetër në organizatë. Ne jemi të shqetësuar për involvimin rus në Maqedoni si dhe në Greqi".

### NDIKIMI I HUAJ NË MAQEDONI

Edhe Tanya Domi flet për ndikimet e huaja në Maqedoni. Akademikja ka rreth 30 vjet që merret me

të drejtat e njeriut dhe marrëdhëniet ndërkombëtare në Ballkan. "Unë u çudita kur hapa emailat dhe pashë që më kishin ftuar për të dhënë mësim për Ballkanin në Kinë. Kina ka një departament akademik për Ballkanin Perëndimor. Kina shpenzon para, që nuk i lidh me kushte. Po ashtu edhe Turqia, e cila eksporton autokraci në rajon. Shtetet e Gjirit Persik duan po ashtu të ushtrojnë ndikim në Ballkan. Ato janë duke bërë shumë investime në Serbi, me shoqërinë ajrore dhe fonde zhvillimi që janë jo transparente". Për ndikimin rus në Maqedoni flet edhe Edmond Ademi, ministër për Diasporën në qeverinë e Maqedonisë. Më parë, në vitin 2001 për shembull në Maqedoni nuk dëgjohej të thuhej asgjë nga Rusia, as nga ambasadori, as nga Ministria e Jashtme. "Duke filluar nga 2015, ne kemi shumë reaksione nga Moskë, që tregojnë për pozicio-

nin e saj në mbrojtje të forcave të caktuara në Maqedoni, që i bëjnë presion qeverisë aktuale. Ne kemi një ambasador rus, që del para ambasadës ruse dhe mbledh rreth 50 veta që janë pro rusë dhe demonstron jashtë çdo rregull diplomatik. Ju shihni çdo ditë se si ambasada ruse në Shkup komenton aktivitetet e qeverisë. Ata kanë trefishuar stafin e ambasadës. Unë jam një nga personat non grata të ambasadës ruse, sepse ftohet nga ambasadat e vendeve perëndimore".

### ÇËSHTJA E EMRIT

Identiteti maqedonas është i pandarë nga gjuha, thotë Edmond Ademi. Kjo është përgjigja që Maqedonia i ka dhënë Greqisë në atë që quhet "grindje për emrin". Maqedonia ka rënë dakord për të ndryshuar emrin e vendit. Por, Greqia kërkon që qytetarët e Maqedonisë

të mos quhen maqedonas dhe gjuha të mos quhet maqedonase. "Ne duam të arrijmë një zgjidhje që mbron qytetarët maqedonas dhe gjuhën maqedonase. Greqia e ka kuptuar që nuk mund të vazhdojë më si deri më parë. Ngadalë por me hap të sigurt ne jemi duke ia marrë kartat nga duart Greqisë. Kartat negative që Greqia ka përdorur për të bllokuar Maqedoninë", thotë ministri Ademi. Maqedonia, sipas tij, bëri disa hapa që treguan se është e gatshme për kompromis. Autostrada quhet tani e Miqësisë, po ashtu aeroportit iu ndryshua emri. Nga ana e saj Greqia zhblllokoj fazën e dytë të stabilizim-asociimit me BE. Greqia pranoi që Maqedonia të jetë pjesë e nismës Adriatiko-Joniane, një nismë ekonomike me vendet e rajonit. "Unë mendoj se ne e vendosëm Greqinë në pozicion që të thonë 'lëri të kenë atë që duan'", thotë Ademi.

### DIASPORA

Dhe Metodija A. Koloski, ekspert në të drejtën e Maqedonisë për të pasur emrin e vet dhe të drejtat e minoriteteve nga Uashingtoni, mendon se diaspora mund të luajë një rol në Maqedoni dhe nuk duhet të keqpërdoret nga partitë ose etnitë. "Ne nuk kemi pasur homeland, atdhe, si maqedonas. Është hera e parë që ne të diasporës kemi një atdhe, Maqedoninë", thotë ai, ndërsa shton se për diasporën, është e rëndësishme krijimi i mundësisë për votimin elektronik.

ANKETË E AGJENCISË GREKE "PRORATA"

## Gati gjysma e grekëve kanë mirëkuptim për emrin "Maqedoni"

Athinë, 7 maj - Për 45 për qind të grekëve është e kuptueshme perspektiva për emrin e ndërlikuar emër me termin e përfshirë Maqedonia, tregojnë rezultatet e hulumtimit të zbatuar nga agjencia "Prorata" për Institutin grek për politikë alternative ENA, që i publikoi gazeta "Etnos". Në pyetjen e njëjtë, 23 për qind, e të anketuarve kanë thënë se "perspektiva për njohjen e IRJM-së me emrin e ndërlikuar që do ta përmbajë emrin Maqedonia u shkakton mllëfatyre që pranojnë diçka të tillë", 14 për qind janë përgjigjur se u vjen

turp që janë grek, 13 për qind janë indiferent, derisa sërish 5 për qind kanë refuzuar të përgjigjen. Siç njoftoi korrespondenti i MIA-s nga Athina, në hulumtimin, të anketuarve u parashtruhet pyetja edhe për atë se cilat janë vendet armiqësore të Greqisë. Armiku numër një, për 87 për qind e të anketuarve është Turqia, ndërsa 45 për qind konsiderojnë se Maqedonia është armiqësore ndaj fqinjët jugor. Në pyetjen "se cilat nga vendet e ardhshme i konsideroni armike", të anketuarit kanë pasur mundësi të zgjedhin përgjigje pozitive ose

negative. Më konkretisht: për Maqedoninë, 45% po, 38% jo; për Shqipërinë 47% po, 37% jo; për Bullgarinë 70% jo, 10% po; si dhe për Turqinë, 87% po, 7% jo. Gjashtëdhjetë e nëntë për qind e të anketuarve konsiderojnë se Maqedonia nuk paraqet kërcënim për integritetin territorial të Greqisë, përballë 21 për qind që janë përgjigjur pozitivisht. Në raport të asaj nëse integrimi i Maqedonisë, Shqipërisë dhe Turqisë në BE do t'i përmirësojë marrëdhëniet me Greqinë, për Shkupin dhe Tiranën kanë qëndrim pozitiv, deri-

sa sërish për Ankananë përgjigjen negativisht. Për Maqedoninë, 57% janë përgjigjur po dhe 35% jo; për Shqipërinë, 56% po dhe 37% jo; ndërsa për Turqinë, 27% po dhe 64% jo. Në pyetjen, se cili është problemi më i rëndë në politikën e jashtme greke, 46 për qind kanë thënë se ajo është menaxhimi me pozitën turke ndaj Greqisë, 34 për qind ballafaqimin me valën e refugjatëve në ishujt grek, ndërsa vetëm pesë për qind e të anketuarve konsiderojnë se problemi më i rëndësishëm është menaxhimi me çështjen e emrit.



PROBLEME TË SHUMTA NË GJYQËSORIN E MAQEDONISË

# PËR 5 VJET, 127 GJYKATËS MË PAK

Në kohën kur Qeveria e Maqedonisë, siç thuhet në Raport, është duke e zhvilluar procesin e reformimit të sistemit gjyqësor në vend, të dhënat e publikuara së fundmi nga Këshilli Gjyqësor tregojnë qartë se gjatë pesë viteve të kaluar (2013-2017), numri i gjykatësve në vend është zvogëluar për më pak se 127 gjykatës

NUMRI I GJYKATËSVE DHE PJESA E ADMINISTRATËS SË GJYQËSORIT 2013-2017					
VITI	2013	2014	2015	2016	2017
Anëtarë të Këshillit Gjyqësor	13	13	13	13	13
Apanazhë				1	
Anëtarë të Këshillit për Verifikimin e Fakteve				8	8
Gjykatës	658	609	579	555	531
Nëpunës administrativ	41	43	45	44	43
Të punësuar në KGJ, KVF, AGJ				11	12
Nëpunës gjyqësor	1.989	1.984	2.103	2.028	1.935
Policia gjyqësore	190	185	185	196	200
Të punësuar në gjykata	149	167	165	160	143
Gjithsej	3.040	3.001	3.090	3.016	2.885

Koha Omer XHAFFERI

Shkup, 7 maj - Sistemi gjyqësor në Maqedoni edhe më tej përballet me mungesë të mjeteve të mjaftueshme financiare. Ky konstatim, i cili përgjatë viteve të kaluara vazhdimisht është theksuar nga Këshilli Gjyqësor i Maqedonisë, është përfshirë edhe në Raportin e vitit 2017 të këtij institucioni, ku mes tjerash thuhet se, pushteti gjyqësor në vend ka nevojë për rritjen e parësive financiare. Dispozitat e Ligjit për buxhetin e gjyqësorit në vend parashohin që me 0.8 për qind nga arka shtetërore të mbulohen të gjitha nevojat e tyre, mirëpo kjo përqindje për vitin e kaluar ka kapur vetëm 0.34 për qind nga Buxheti shtetëror. Megjithatë, në Raportin e Këshillit Gjyqësor, thuhet se në periudhën që vijon pritet të rritet Buxheti konform normave ligjore, përmes të cilit institucionet

e drejtësisë në vend pa ndërprerë do t'i realizonin funksionet e veta.

Në pjesën e rekomandimeve për përmirësimin e gjendjes në sistemin gjyqësor, anëtarët e Këshillit Gjyqësor të Maqedonisë kanë konstatuar se në të ardhmen, përfaqësuesit e pushtetit gjyqësor duhet më tepër të marrin pjesë dhe të angazhohen në formimin e kornizës ligjore që zbatohet në gjyqësor. "Në periudhën që pason, siç njoftojnë nga ky Këshill, pritet të avancohet bashkëpunimi me Ministrinë e Drejtësisë si një nga organet përgjegjëse për propozimin e ligjeve që zbatohen në gjyqësor", thuhet në Raportin e Këshillit Gjyqësor.

"Duhet të bëhet sigurimi i funksionalitetit të Sektorit për statistikë dhe analitikë në gjyqësor, me plotësimin e vendeve të punës në pajtim me Rregullo-



Nga ana tjetër, edhe përfaqësimi i bashkësive tjera etnike, përveç asaj maqedonase, në administratën e gjyqësorit në vend nuk respektohet siç duhet. Kësisoj, në kuadër të 2278 të punësuarve në administratën gjyqësor, mbi 1800 janë maqedonas (81 për qind), rreth 309 administratorë janë shqiptarë (13 për qind) dhe 6 për qind i takojnë etnisë turke, serbe, rome, boshnjake e kështu me radhë

ren për sistematizim të vendeve të punës në Këshillin tonë, respektivisht përmes punësimeve të reja në Shërbimet profesionale. Kjo nevojë buron edhe nga Strategjia për reforma në sistemin gjyqësor 2017-2022, ku parashihet përforcimi i kapaciteteve të Këshillit Gjyqësor në Maqedoni. Në këtë drejtim, si qasje strategjike është paraparë formimi i Njësisë të specializuar për menaxhim të sistemit të mbledhjes, përpunimit dhe analizës së statistikave që rrjedhin nga puna e gjykatave", thuhet në Raportin e Këshillit Gjyqësor për vitin 2017. Në kohën kur Qeveria e Maqedonisë, siç thuhet në Raport, është duke e zhvilluar procesin e reformimit të sistemit gjyqësor në vend, të dhënat e publikuara së fundmi nga Këshilli Gjyqësor tregojnë qartë se gjatë pesë viteve të kaluar (2013-2017), numri i gjykatësve në vend është zvogëluar për më pak se 127 gjykatës. Ndërkohë në vitin 2017, siç thonë nga Këshilli Gjyqësor, për herë të parë është regjistruar edhe zvogëlimi i nëpunësve gjyqësor.

Nga ana tjetër, edhe përfaqësimi i bashkësive tjera etnike, përveç asaj maqedonase, në administratën e gjyqësorit në vend nuk respektohet siç duhet. Kësisoj, në kuadër të 2278 të punësuarve në administratën gjyqësor, mbi 1800 janë maqedonas (81 për qind), rreth 309 administratorë janë shqiptarë (13 për qind) dhe 6 për qind i takojnë etnisë turke, serbe, rome, boshnjake e kështu me radhë.

## Policët më afër qytetarëve

Shkup, 7 maj - Me dorëzimin e luleve dhe dhënien e respektit të përmendoret e pjesëtarëve të vdekur të forcave policore të Maqedonisë, si dhe me ndarjen e mirënjohjeve për punën e mirë të kreut policor të Maqedonisë, dje në qarkun e Ministrisë së Punëve të Brendshme ishte shënuar 7 Maji - Dita e Policisë së Maqedonisë. Ministri i Punëve të Brendshme, Oliver Spasovski, u ndau mirënjohje zëvendësministrit të Punëve të Brendshme, Agim Nuhiu, sekretares shtetërore Magdalena Nestorovska, drejtorëve të BSP-së dhe DSK-së, Lazo Velkovski dhe Goran Nikollovski dhe zëvendësve të tyre. Spasovski i priti edhe përfaqësuesit e familjeve të pjesëtarëve të vdekur të policisë së Maqedonisë. Me vendimin e Qeverisë të Republikës së Maqedonisë nga 20 prilli i vitit 1993, 7 maji është vendosur si Dita e Policisë së Maqedonisë. Nën moton "Policia për qytetarët", MPB të premtën filloi shënimin e 7 Majit - Ditës së Policisë së Maqedonisë me stërvitje taktike-demonstrative të pjesëtarëve të Njësisë për detyra speciale, e cila në tre situata të ndryshme i demonstroi



afhtësitë taktike-teknike në kazermën "Gjorçe Petrov". Manifestimi qendror u mbajt pambremë në stadiumin e qytetit në Shtip, ku pjesëtarët e MPB-së i prezantuan mundësitë e tyre përmes disa stërvitjeve treguese. Pjesëtarët e Njësisë për detyra speciale, policia e liqenit dhe njësia e helikopterëve të shtunën në suaza të shënimin, prezantuan një pjesë të mundësive të tyre profesionale. Ato performuan stërvitje taktike-teknike me sulm të objektit lun-

drues për shkak të mposhtjes dhe privimit nga liria të personave të rrezikshëm. Spasovski përmendi se lidhja mes qytetarëve dhe policisë së Maqedonisë duhet të përforcohet dhe të ripërtërihet me qëllim që të rritet siguria në vend. Ministri Spasovski në solemnitet qendror në Shtip tha se përmes proceseve reformuese MPB e kthen besimin te qytetarët, ndërsa paralajmëroi se nga 1 dhjetori i këtij viti 4900 policëve do t'u rriten pagat.

## KRONIKË

Hidhet nga kati i 11-të, vetëvritet

36-vjeçari nga Shkupi

Tridhjetë e gjashtëvjeçari T.J. nga Shkupi dje u hodh nga ballkoni në katin e 11-të ku si pasojë humbi jetën. Siç njoftoi MPB, ngjarja është denoncuar dje në mëngjes në orën 5:25 minuta. Mjeku i Ndhmës urgjente konstatoi vdekje. Është bërë hetim në vendin e ngjarjes.

Aksident në Gostivar, vdes 32 vjeçari

Në rrugën magjistrale Gostivar-Kërçovë, në afërsi të gurorëve të dielën rreth orës 17.20 minuta, ka ndodhur aksident trafiku, në të cilën kanë marrë pjesë dy vetura - "Reno Megan" me targa të Gostivarit, e drejtuar nga personi me iniciale S.P, 32 vjeçar nga Gostivari dhe vetura "Opel astra", me targa të Dibrës, e drejtuar nga personi Xh.A. 21 vjeçar nga Dibra. Në aksident, drejtuesi i veturës Reno, 32-vjeçari S.P. ka marrë lëndime vdekjeprurëse, ku edhe ka ndërruar jetë në vend të ngjarjes, ndërsa 24-vjeçarja M.M. nga Gostivari, bashkudhëtare në të njëjtën veturë, ka marrë lëndime të rënda trupore, derisa fëmija trevjeçar, i cili ka qenë ulur në ulësen e pasme ka marrë lëndime të lehta. Me lëndime të rënda trupore ka mbaruar edhe drejtuesi i veturës "Opel astra", ndërsa bashkudhëtarja, 25vjeçarja P.L. nga Dibra ka marrë lëndime të lehta trupore. Të gjithë të lënduarit, me vetura të Ndhmës së Shpejtë, janë dërguar në spitalin e në Gostivarit, ku pas dhënies së ndihmës mjekësore, dy personat e lënduar rëndë, janë dërguar në Klinikat e Shkupit, kurse dy personat me lëndime të lehta janë lëshuar për shërim shtëpiak. Prokurori publik dhe ekipi i stacionit policor nga Gostivari, kanë kryer hetimet në vend të ngjarjes, dhe po punohet në zbardhjen e plotë të rastit si dhe shkaqet dhe rrethanat në të cilat ka ndodhë aksidenti.

Shpëtohet 23 vjeçarja, tentoi të hidhet në lum

Në orët e para të mëngjesit të ditës së hënë, personi A.L. 26 vjeçar nga Tetova, ka paraqitur se në fshatin Raotincë, te ura e lumit Vardar, afër gardhit mbrojtës prej hekuri, ka vërejtur një femër e veshur me pizhame, e cila ka tentuar të kërcejë në lum. Në vendin e treguar, menjëherë janë dërguar zyrtarë të policisë nga SPB Tetovë, të cilët së pari kanë informuar prindin e vajzës, pastaj dy nga zyrtarët e policisë me kujdes janë afuar 23 vjeçares M.B. nga fshati Raotincë, të cilën e kanë kapur përpara se të kërcente në lum, dhe e kanë dorëzuar në duart e prindit të saj. (U.H)



Të papunë, por me para të mjaftueshme për të bjerrë kohën nëpër kafene. Kjo është pamja aktuale që aktualisht zotëron në shumë qytete të Maqedonisë, kurse sociologët janë të mendimit se mungesa e angazhimeve kreative ka bërë që të rinjtë të gjejnë alternativa, të cilat nuk kanë kurrfarë dobie as personale, as publike

Koha Zejnulla VESELI

Shkup, 7 maj - Nëse i hedhim një sy lokaleve gastronomike nëpër qytete tona, fitojmë përshtypjen se qytetarët jetojnë në një parajsë sociale. Nga ora 9 e mëngjesit e deri në 21 e mbrëmjes kafenet në kryeqytet si dhe nëpër qytetet tjera të vendit janë përplot me të rinj të cilët në mungesë të aktiviteteve, kohën e lirë e bjerrin nëpër kafene edhe përkundër faktit se shumica e tyre janë të papunë. Se të rinjve u pëlqen të rrinë sa më shumë në kafene, këtë e thonë pronarët e lokaleve sipas të cilëve numrin më të madh të klientëve i kanë të rinjtë apo 70 për qind të moshës 19 e deri në moshën 35 vjet të cilët pjesën më të madhe të ditës e kalojnë nëpër kafene.

Në anën tjetër derisa kafenet janë përplot me të rinj të dhënat e Entit të Statistikës tregojnë se numër më të madh të papunëve ka tek të rinjtë të moshës prej 15 vite e deri në 24 vite, apo 46.7 për qind e të

KAFENETË, SI BAROMETËR

## PARAJSE E RREJSHME SOCIALE



rinjve në Maqedoni janë të papunë gjegjësisht shkalla e të papunëve në Maqedoni në total është 21,9 për qind.

"Si duket në Maqedoni edhe për një kohë të gjatë do të kemi shkallë të lartë të papunësisë sidomos për të rinjtë. Pikërisht ky është dhe grupi i të rinjve që më së shumti rinë nëpër kafe. Për t'u ulur në lokalet si ky që është afër dy universiteteve, të duhet jo pak kohë të presësh në këmbë derisa të lirohet ndonjë vend. Kjo ndodh për çdo ditë dhe jo vetëm ditëve të vikendit. Kjo pamje është prezente pothuajse në të gjitha kafenet qofte këndeje urës së Vardarit apo në anën tjetër të Vardarit", thotë njëri nga pronarët e kafesë në afërsi të qendrës tregtare "Mavrovasja". Edhe të rinjtë të cilët i intervistua deri sa po pini kafenë e mëngjesit thonë se ata gjatë ditës

### SHQIPTARËT PINË KAFE E ÇAJ KUR T'JU TEKET

"Fenomeni i kafemanisë apo i harxhimit të kohës nëpër lokale të ndryshme si kafene, bare, restorante flet për një shoqëri të degraduar në aspektin e organizimit të jetës, ku koha e lirë ka përfshirë apo pushtuar gjithë ditën, jo një copë kohe siç është e natyrshme dhe siç bën bota e civilizuar. Dihet, anglezët e kanë tradicionale "tea at five" apo çaji në ora pesë pasdite, kurse shqiptarët pinë kafe e çaj kur t'iu teket, duke lënë pas dore të gjitha obligimet profesionale, familjare, jetike. Pasioni pas dëfrimeve mashtruese është kontraproduktiv, është pasivizues i brezave, krijon një kulturë të dembelizmit masovik, një gjeneratë që kënaqet me të arriturat e pararendësve dhe që jeton vetëm për zbavitje, llaf e muhabet, që e vret kohë, në fakt perspektivën e vet", thotë sociologu Ali Pajaziti.

disa herë rinë nëpër kafene dhe shpenzojnë nga 30 deri në 100 denarë në ditë.

"S'ka punë, edhe nuk kam çka të bëjë jo vetëm unë por edhe të rinjtë e tjerë që po i sheh ulur në kafe. Unë dal shpesh sepse nuk punoj, andaj kohën e lirë e kalojë në kafene ndonjëherë vetëm por ndonjëherë

edhe me shokë. Gjatë ditës shpenzoj 30 deri më 100 denarë", thotë i riu 23 vjeçar nga Shkupi.

Ndërkaq në pyetjen se si ja bën për para pasi nuk punon ai përgjigjet thjesht nga babi apo mami falë zotit që punojnë të dy dhe më japin para të mjaftueshme për të pirë kafe. Ndërkaq i riu i mo-

shës 27 vite ulur në tavolinën tjetër thotë se punon dhe se pothuaj se gjysmën e rrogës e shpenzon nëpër kafene. "Unë punoj dhe gjatë ditës, shpenzoj shumë. Gati gjysma e rrogës më shkon në kafeteri. Çdo herë që gjej kohë të lirë dal vetëm apo me koleg të punës dhe pijë kafe", thotë 27 vjeçari po ashtu nga Shkupi i punësuar në administratë. Sociologu Ali Pajaziti për fenomenin që kafenet pothuajse në të gjitha qytetet e Maqedonisë janë të mbushura plotë me të rinj, thotë se fajin e kanë institucionet shtetërore që shumë pak punojnë dhe kujdesen për rininë. Sipas Pajazitit mungesa e aktiviteteve kulturore, sportive ku të rinjtë do të shprehnin talentin, ndjekin pasionin-hobi, të krenohen për të arriturat, të jenë fitues të garave sportive, teatrore, muzikore ata zgjedhin kohën e lire ta kalojnë nëpër kafene edhe pse janë të papunë. "Fenomeni i kafemanisë apo i harxhimit të kohës nëpër lokale të ndryshme si kafene, bare, restorante flet për një shoqëri të degraduar në aspektin e organizimit të jetës, ku koha e lirë ka përfshirë apo pushtuar gjithë ditën, jo një copë kohe siç është e natyrshme dhe siç bën bota e civilizuar. Dihet, anglezët e kanë tradicionale "tea at five" apo çaji në ora pesë pasdite, kurse shqiptarët pinë kafe e çaj kur t'iu teket, duke lënë pas dore të gjitha obligimet profesionale, familjare, jetike. Pasioni pas dëfrimeve mashtruese është kontraproduktiv, është pasivizues i brezave, krijon një kulturë të dembelizmit masovik, një gjeneratë që kënaqet me të arriturat e pararendësve dhe që jeton vetëm për zbavitje, llaf e muhabet, që e vret kohë, në fakt perspektivën e vet., thotë sociologu Ali Pajaziti.

## 12 të dyshuar për vdekjen e Tamarës së vogël

Shkup, 7 maj - Nën dyshimin se kanë kryer veprën penale "punë e pandërgjegjshme", Prokuroria e Shkupit deri te Gjykata Penale e Shkupit, ka parashtruar propozim akuzë kundër 12 personave, të cilët mendohet se kanë lidhje vdekjen e vogëlush Tamara Dimovski, vite më parë. Prokuroria e Shkupit ka bërë të ditur se kjo lëndë është formuar në bazë të asaj që flitet në opinion dhe në bazë të padisë penale të ngritur nga Komiteti i Helsinkit. "Gjatë procedurës hetimore, prokurori përkatës e ka kërkuar dhe e ka siguruar dokumentacionin e plotë lidhur me mjekimin e vogëlushes Tamara nga Veseli. Dokumentacioni në fjalë është marrë nga Fondi për sigurim shëndetësor, Ministria e Shëndetësisë, Klinika universitare për sëmundje të fëmijëve, Spitali "Filipi i Dytë" dhe Spitali i përgjithshëm i Velesit. Njëkohësisht, përmes Prokurorisë së Velesit, e cila e ka urdhëruar obduksionin e fëmijës së ndjerë, është marrë protokollin e seksionit me të cilin nga Instituti për mjekësi ligjore vërtetohet arsyeja

kryesore se pse na ndërruar jetë Tamara Dimovska", thonë nga Prokuroria e Shkupit. Me qëllim mbledhjen e më shumë të dhënave për këtë ngjarje e cila vite më parë e tronditi opinionin, nga Prokuroria e Shkupit kanë theksuar se gjatë procedurës hetimore janë marrë deklarata edhe nga Kolegji i profesional, nënshkruar të Propozimit për udhëzim për mjekim jashtë shtetit. Deklaratë shtesë është marrë edhe nga një përfaqësues i Fondit për sigurim shëndetësor, sekretarët e Komisionit të Fondit (të shkallës së parë dhe shkallës së dytë), një drejtor, si dhe anëtarëve të komisionit të shkallës së parë dhe shkallës së dytë. Këtë të fundit kanë dhënë mendim negativ për mjekim jashtë shtetit të pacientit në fjalë. Duke e treguar rolin e Institutit për mjekësi ligjore dhe atij për mjekësi deontologjike, nga Prokuroria e Shkupit, thonë se kanë kërkuar realizimin e ekspertizës shtesë, me qëllim vërtetimin e vdekjes konkrete të Tamarës dhe gjendjes së përgjithshme shëndetësore të saj. (O.Xh)

"TORTURA" SHTYHET PËR MË 13 QERSHOR

## Mijallkov nuk i kërkon falje Boshkovskit

Shkup, 7 maj - Seanca për lëndën e PSP-së "Tortura" që dje duhej të mbahet në Gjykatën Penale në Shkup është shtyrë për më 13 qershor për shkak të mungesës të të akuzuarit të tretë Novica Stankovski. Mbrojtja dorëzoi dokumentacion mjekësor, për të cilin pohon se e arsyeton mungesën e tij nga seanca e djeshme. I akuzuari nga PSP, Gavril Bubevski, kërkoi që dokumentacioni të jetë më serioz sepse, sipas tij, nga dokumentacioni i sotëm mund të shihej vetëm se Stankovski ka marrë terapi. Gjykatësja Aleksandra Ristevska ka kërkuar në seancën e ardhshme të dorëzohet dokumentacion mjekësor shtesë. Në Gjykatë erdhi i akuzuari i parë Sasho Mijallkov, për mungesën e të cilit ishte shtyrë seanca paraprake më 23 mars. Në Gjykatën Penale erdhën edhe të akuzuarit e tjerë në këtë lëndë. "Tortura" ka të bëjë me mënyrën e privimit nga liria të liderit të "Të bashkuar për Maqedoninë" dhe ish-ministër i Punëve të Brendshme, Lube Boshkovski, më 6 qershor

të vitit 2011, një ditë pas zgjedhjeve të parakohshme parlamentare. I dëmtuari në rastin "Tortura", Lube Boshkovski pas anulimit të seancës, duke u përgjigjur në pyetjen e gazetareve, tha se mendon se i akuzuari i parë Sasho Mijallkov ndoshta është i gatshëm t'i kërkojë falje dhe se kjo pyetje duhet t'i parashtrohet personalisht Mijallkovit. Boshkovski vlerëson se të falës është mirë, por të harrohet një, siç tha, torturë e tillë dhe regjimi i tillë nëpër të cilin ka kaluar Maqedonia nuk duhet dhe nuk mund të harrohet. "Ai u ngrit që të më përshëndetë, ndoshta të kërkojë falje për atë që e ka bërë në të kaluarën. Ne për dallim nga ata e kemi atë linjë demokristiane brenda nesh. Ne kemi mirëkuptim. Ata janë në një pozitë jashtëzakonisht të rëndë, nga njerëzit më të fortë të shtetit tani janë në gjendje që të luftojnë për lirinë personale dhe ne duhet të kemi marrëveshje për situatën në të cilën ndodhen", tha Boshkovski. Në ndërkohë, ish-drejtori i Policisë Sekrete, Sasho Mijallkov, ka deklaruar se është përshënde-

tur me Lube Boshkovskin prej kulturës dhe në shenjë faljeje. "Kur të kaloni përkaj dikujt që e njihni, përshëndetja është çështje kulturore dhe 'bon toni'. Nëse dikush i ka kërcyer këto faza të edukimit, ajo është handikap i tij personal. Nuk i kam kërkuar falje Lube Boshkovskit as ka arsye për falje. Institucionet kanë vepruar në bazë të akuzës për krimin që e ka kryer dhe ashtu siç po e ndjek, ai proces është mbyllur me dëshmi. Vlerat demo-kristere thonë që të kërkojë falje ai që ka gënjyer dhe shpifur për ndonjë dobi. Në frymën e këtyre vlerave unë e pata pranuar Lube Boshkovskit ndaj meje përpara më shumë se gjashtë vjetëve dhe shpresoj se në të ardhmen do të ketë kujdes që të mos gënjëjë në opinion", deklaroi Mijallkov. Në lëndën "Tortura", krahas Mijallkovit, janë të akuzuar janë ish-njeriu i parë i njësitit "Alfat" Ivica Antevski - Puki dhe edhe pesë pjesëtarë të njësitit. PSP-ja e ndjek për keqtrajtim dhe mizori të tjera, veprim jonjerëzor ose poshtërues dhe dënim. (O.XH)



NXËNËSIT DHE STUDENTËT NUK E DUAN PRAKTIKEN

# PUNË KA, POR S'KA ZANATÇINJ

Në praktik, lidhur me këtë, Halili thotë se ndeshemi me dy fenomene kontradiktore: studentët më tepër interesohen për të marrë dokumentin e vulosur prej kompanive se sa vërtetë të shkojnë në praktikë dhe kjo ndodh në mbi 80 për qind të rasteve

Koha Zejnulla VESELI



Shkup, 7 maj - Biznesi privat në Maqedoni vite të fundit ndeshet me fuqi punëtore të kualifikuar, për shkak se nëse dikur këtë rol e kishin qendrat për rikualifikim të punëtorëve, si elektricitistë zdrukthetarë, murator apo saldues - sot asnjë qendër arsimore në Maqedoni nuk e luan më këtë rol, ndërsa për të siguruar fuqi punëtore stabile, ky angazhim i mbetet vet sektorit të biznesit privat që të përgatit kuadro me kohë.

Arben Halili nga Oda Ekonomike e Maqedonisë Veriperëndimore thotë se në Maqedoni, për momentin ekziston një gjendje latente në aspekt të thellimit të bashkëpunimit ndërmjet sektorit të biznesit dhe kompanive private. "Pavarësisht formave të ndryshme

deklarative, realiteti në praktikë dëshmon që vullneti për të bashkëpunuar me veprimet konkrete të ndërmarra deri më tani lë shumë për të dëshiruar. Ekziston një obligim ligjor për të kryer punë praktike për studentët gjatë ciklit të studimeve, një muaj në kompani konkrete, megjithëse shumë pak kompani nga sektori i biznesit privat, si dhe shkollat e mesme profesionale apo fakultetet i obligojnë nxënësit apo studentët ta kenë si detyrim të bëjnë praktikën në ndonjë kompani private", thotë Halili. Në praktik, lidhur me këtë, Halili thotë se ndeshemi me dy fenomene kontradiktore: studentët më tepër interesohen për të marrë dokumentin e vulosur prej kom-

panive se sa vërtetë të shkojnë në praktikë dhe kjo ndodh në mbi 80 për qind të rasteve.

Dhe e dyta, thotë ai, edhe ato pak studentë që shkojnë vërtetë në praktikë në kompani, qasja e tyre deri tek informatat ose edhe proceset reale ditore ekonomike brenda kompanisë janë të pakta, sepse akoma ka kompani që ngurojnë të jenë të hapura ndaj palëve të treta.

"Gjithsesi është nevojë e patjetërsueshme që bashkëpunimi i sektorit të biznesit me universitetet e pse jo edhe me shkollat e mesme, të fillojë sa shpejtë. Madje, besoj se bashkëpunimi me shkollat e mesme profesionale mund të jetë më i frytshëm, sepse pikërisht aty mund të rekrutohet fuqi punë-

tore potenciale, veçanërisht në shkollat profesionale", thotë Arben Halili nga OEMVP, duke shtuar se në të ardhmen - kompanitë private dhe shkollat e mesme profesionale dhe fakultetet duhet të nënshkruajnë memorandume duke i obliguar kështu nxënësit dhe studentët patjetër të mbarojnë praktikën.

Një memorandum të këtillë ditë më parë e nënshkroi kompania farmaceutike Alkaloid nga Shkupi me Fakultetin e Farmacisë dhe Institutin e Kimisë - të dyja pjesë e universitetit "Shën Kirili dhe Metodi". Drejtori i përgjithshëm i Alkaloid, Zhivko Mukaetov tha se me nënshkrimin e këtyre dy memorandumeve i ka hapur rrugë

zhvillimit të Programit për praktikë, që nënkupton përfshirjen e studentëve në proceset e prodhimit të kompanisë dhe nxitjen e punës së tyre hulumtuese.

Bashkëpunim me dy fakultete, biznesmeni dhe pronari i firmës ndërtimore "Trim&Lumi" nga Struga, Mendi Qyra e cilëson si një hap përpara jo vetëm për përgatitjen e programeve të tilla, por edhe për harmonizimin strukturor me institucionet e arsimit të mesëm dhe të lartë dhe harmonizimin me trendët botërore të programeve dhe praktikave mësimore. "Edhe përkundër dëshirës dhe kërkesave tona deri të shkollat e mesme profesionale apo fakulteteve për të nënshkruar një memorandum që nxënësit të detyrohen të bëjnë edhe praktikën në kompaninë tonë, deri më sot nuk ka ndodhur për shkak se shumë nxënës apo studentë zgjedhin vetë se ku kudo ta bëjnë praktikën e jo shkolla t'i obligojë ata", thotë Qyra. Ai njëherësh thotë se kompania tij, që kryesisht si veprimtari ka punimet në ndërtimtarë dhe ka nevojë për fuqi punëtore si murator, elektrikist, instalues të ujit apo saldues, gjithmonë ka kërkuar të nënshkruajë memorandume me shkollat e mesme profesionale që të paktën nxënësit gjatë pushimit veror, të vijjnë dhe të bëjnë praktikën dhe nëse tregohen se janë të mirë, atëherë mund dhe t'ju ofrohet punë.

KOMPANITË ITALIANE DETEKTOJNË DOBËSITË

## Italianët kthejnë sytë nga Maqedonia

Shkup, 7 maj - Kthehet interesi i kompanive italiane për investim në Maqedoni, tha sot ambasadori i Italisë, Karlo Romeo. Duke u përgjigjur në pyetje të gazetarëve para prezantimit të sotëm të pakos së re të masave financiare në Odën ekonomike, Romeo theksoi se procedurat biografike, administrata e ngadalësuar dhe kualifikimet joadekuate të fuqisë punëtore janë dobësitë kyçe që i kanë detektuar afaristët italianë.

"Pas periudhës së ngadalësimit dhe shtyrjes së vendimeve të kompanive italiane për të investuar në Maqedoni për shkak të krizës politike, në periudhën e fundit kemi vërejtur kthim të serishëm të interesit. Investuesit italianë janë të interesuar jo vetëm për tregun rajonal, por edhe për atë evropian", theksoi ambasadori. Për përfortimin e kapacitetit të formave vendore për bashkëpunim me investitorët e huaj, Oda ekonomike paralajmëroi projekt të ri. Siç tha Jadranka Arizankovska nga Oda, në vijim është paraqitja e kompanive të Maqedonisë të cilat do të dëshirojnë të bashkëpunojnë



me investitorët e huaj dhe të cilët gjatë vitit të ardhshëm përmes trajnimeve dhe mbështetjes konsultuese do të kenë mundësi ta përfortojnë kapacitetin e tyre dhe të përgjigjen në sfidën që e kërkojnë investitorët. Masat qeveritare për mbështetje financiare para kompanive italiane i prezantoi ministrja pa portofol e obliguar për Investime të huaja Zorica Apostoloska. Këmbimi i përgjithshëm tregtar midis Maqedonisë dhe Italisë në

periudhën janar-shkurt të vitit 2018 është 104,72 milionë dollarë amerikanë. Eksporti arrin 32,75 milionë që është rritje prej 37,5 për qind, ndërsa importi ka arritur 71,97 milionë dollarë që paraqet rritje prej 39,1 për qind në krahasim me periudhën janar-shkurt të vitit 2017. Është realizuar deficit prej 39,22 milionë dollarë amerikan. Italia është partneri i gjatë më i madh tregtar i Maqedonisë në periudhën janar-shkurt të vitit 2018.

## 8000 mijë kompani me mbështetje financiare qeveritare

Shkup, 7 maj - Rreth tetë mijë kompani do të mund t'i përmbushin kushtet për shfrytëzimin e mbështetjes financiare qeveritare, vlerësoi sot ministrja pa portofol e angazhuar për Investime të Huaja Zorica Apostoloska. Sipas Apostollovkës, numri fillestar i kompanive të cilat mund t'i shfrytëzojnë mjetet nga shteti ka qenë shtatë mijë, por me lehtësimin e mundësisë ligjore që kaloi në Kuvend, numri të paktën nga perspektiva e tanishme, do të arrijë tetë mijë. Duke u përgjigjur në pyetjen e gazetarëve para prezantimit të mbështetjes financiare qeveritare në Odën Ekonomike të Maqedonisë, ministrja i konfirmoi paralajmërimet e kryeministrit Zoran Zaev se intensivisht po negociohet me kompani të huaja për investim në Maqedoni. "Mes kompanive ka edhe italiane, kryesisht nga fusha e pajisjes mjekësore. Ka edhe shtete të tjera. Intensivisht po negociohet edhe atë shumë seriozisht", potencoi Apostollovska.



TETOVË-GOSTIVAR, RIKOSTRUIMI I PASHMANGSHËM

# PASIGURIA NË AUTOSTRADË, SUGAREVSKI PREMTON RIKONSTRUIM



Nga drejtorja Rrugët e Maqedonisë shprehen të vetëdijshëm për problemin dhe njoftojnë se për shkak të vjedhjeve apo dëmtimit të rrethojës, kanë ngritur një sërë padish ndaj personave të panjohur. Në Pollog, viteve të fundit numri i aksidenteve të shkaktuara nga kafshët në autostradë lëviz diku nga 100 deri në 120

Koha Urim HASIPI

Tetovë, 7 maj - Siguria në autostradën Tetovë-Gostivar është në nivelin më të ulët. Kjo autostradë viteve të fundit pothuajse është lënë pas dore nga autoritetet përgjegjëse, duke bërë kështu që

krahas pasigurisë - të ketë edhe shumë aksidente trafiku.

Ministri i Transportit, Goran Sugarevski thotë se janë në bisedime me ndërmarrjen Rrugët e Maqedonisë. "Absolutisht atë që ne, sipas asaj që e kemi në programin e ndërmarrjes publike për rrugë shtetërore, ku tani po flasim për pjesën e rikonstruimit dhe rehabilitimit të rrugëve dhe për atë që do të thotë shtesë pasi kishte një iniciativë për një korsi të veçantë atje, rreth kësaj kam biseduar gjatë javës së kaluar edhe me drejtorin dhe ne do ti ndërmarrim të gjitha masat e nevojshme që nevojiten për të përmirësuar infrastrukturën rrugore edhe në atë pjesë të rrugës", deklaroi Sugarevski. Nga ana tjetër, profesori universitar Vullnet Palloshi shprehet se është obligative që shteti apo ndërmarrja përgjegjëse të mirëmbajë rrugët dhe autostradat, sepse nëse nuk mirëmbahen, ata edhe dëmtohen. Kjo, sipas tij, është më kryesorja, sepse nëse mirëmbahen autostradat, ato më pak dëmtohen dhe më

pak kushton pastaj rikonstruimi.

"Ata kanë obligim që çdo pesë vjet të bëjnë rikonstruimin, rinovimin dhe rregullimin e të njëjtës. Por më shumë se 15 vite nuk është bërë asgjë në këtë drejtim, prandaj edhe është në atë gjendje kjo autostradë dhe ka shumë dëmtime. Obligim e ka ndërmarrja që të mirëmbajë gardhin përgjatë autostradës që të pengojë hyrjen e kafshëve. Obligim ligjor është mirëmbajtja e sinjalizimit vertikal dhe horizontal, si dhe mirëmbajtja e gardhit apo korsisë në mes të autostradës", thotë Palloshi. Sipas tij, mirëmbajtja duhet të bëhet edhe në pjesën e asfaltit. "Po ashtu duhet të mirëmbahet edhe asfalti, sepse ka plasaritje, gropa dhe deformime të tjera që në masë të madhe e vënë në rrezik jetën e vozitësve. Po ashtu pjesë e mirëmbajtjes janë edhe mburojat prej metali përgjatë autostradës që janë të dëmtuara, si dhe shtyllat ndriçuese që përkufizojnë fundin e rrugës e të cilët nuk janë funksionale", thotë Palloshi. Nga Policia e Tetovës thonë se për

shkak se kohëve të fundit janë shtuar aksidentet me kafshë në këtë autostradë, Sektori për Punë të Brendshme në Tetovë apelon deri tek vozitësit të jenë të kujdesshëm, në veçanti gjatë orëve të natës. Policia po ashtu apelon deri tek përgjegjësit që kujdesen për autostradën të ndërmarrin masa adekuate dhe të rregullojnë këtë problem me çka do të ndalohej qasja e kafshëve në autostradë. Nga drejtorja "Rrugët e Maqedonisë" shprehen të vetëdijshëm për problemin dhe njoftojnë se për shkak të vjedhjeve apo dëmtimit të rrethojës, kanë ngritur një sërë padish ndaj personave të panjohur. Në Pollog, viteve të fundit numri i aksidenteve të shkaktuara nga kafshët, lëviz diku nga 100 deri në 120. Rastet më të shpeshta janë vjedhjet e telave dhe shitja e tyre, por nuk janë të pakta edhe rastet kur bujqit për të arritur më lehtë deri tek arat e tyre, dëmtojnë telat mbrojtjes të autostradës dhe kjo ndodh në tërë autostradën prej Shkupi-Tetovë-Gostivar. (U.H)

## Furnizimi me ujë për Likovën do të përmirësohet

Likovë, 7 maj - Ministri i Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, Sadulla Duraki dhe kryetari i Komunës së Likovës, Erkan Arifi, dje morën pjesë në hapjen e punimeve për një pjesë të tubacionit të furnizimit me ujë në disa vendbanime në fshatin Likovë. "Ky është një projekt shumë i rëndësishëm infrastrukturor, i cili jo vetëm që do të përmirësojë furnizimin me ujë të banorëve të Komunës së Likovës, por do të ndikojë gjithashtu në përmirësimin e mbrojtjes së mjedisit jetësor dhe shëndetit të banorëve në këtë rajon", tha ministri Duraki në fjalimin e tij. Tubacioni i furnizimit me ujë do të ndërtohet në tri vendbanime, për një pjesë të boshtit qendror ndarës deri në boshtin lidhës për fshatin Nikushak, nga boshti qendror ndarës deri në boshtin lidhës për fshatin Llojan dhe nga boshti ndarës deri në boshtin lidhës në fshatin Opajë. Vlera e punimeve të tri pjesëve të projektit është rreth 92 milionë denarë dhe parashikohet që punimet në terren të përfundojnë brenda 7 muajve.



PRILLI MË I SHTRENJTË SE MARS

## Rriten shpenzimet e jetesës

Shkup, 7 maj - Shpenzimet e jetesës në prill të këtij viti shënojnë rritje prej 0.3 për qind në raport me muajin paraprak, ndërsa në raport me prillin e vitit të kaluar 1.4 për qind, bëri të ditur Enti Shtetëror Statistikor. Sipas të dhënave të publikuara shpenzimet e jetesës në prill në raport me muajin e kaluar shënojnë rritje prej 0.3 për qind, ndërsa në raport me prillin e vitit të kaluar tre për qind.

Rritje të indeksit të shpenzimeve të jetesës në prill të vitit 2018, në krahasim me muajin e kaluar, është shënuar te perimet e freskë-

ta dhe të ngrira, përveç patates dhe frutave të tjerë rrënjësor për 3.6 për qind, pemët e ngrira për 1.2 për qind, mishrave të tjerë të përpunuar prej 0.9 për qind, mishit për 0.7 për qind, prodhimet tjera ushqimore për 0.6 për qind, qumështit për 0.5 për qind, frutave të thata dhe prodhimet e arrave për 0.4 për qind, cigaret për 0.3 për qind, perimet e thata dhe perimet e tjera të përpunuara dhe të konservuara prej 0.2 për qind.

Në prill të vitit 2018 rritje të indeksit të shpenzimeve të jetesës është shënuar edhe te lëndët

djegëse për amvisëritë për 2.8 për qind, shërbimeve spitalore për 2.6 për qind, lëndët djegëse dhe lubrikantëve si pjesë e pajisjeve për mjetet e komunikacionit për 2.1 për qind, biçikletave për 1.6 për qind, disqeve, kasetave, disketave, filmave për 1.3 për qind, pajisjet fotografike dhe kinematografike dhe instrumente optike, shërbimet për rekreacion dhe sport për një për qind, riparimet e aparateve elektrike për 0.9 për qind, aparatet e vogla elektrike për 0.6 për qind, mobilitet për amvisëritë për 0.4 për qind, mjetet për pastrim dhe

mirëmbajtje të banesës, transporti ajror i udhëtarëve për 0.3 për qind, këpucët, materialet për mirëmbajtje dhe riparime të banesës, mjetet dhe pajisjet për shtëpi dhe kopsht, prodhimet e tjera mjekësore, telefon dhe telefaks- aparatet dhe telefon dhe telefaks-shërbimet, pajisjet për sport, kampim dhe rekreacion në natyrë për 0.2 për qind. Zvogëlimi i indeksit të shpenzimeve të jetesës në prill të vitit 2018, në krahasim me muajin e kaluar, është shënuar te sheqeri, mjalti dhe prodhimet e ëmbla për 0,9 për qind, miellit dhe drithëra-

ve të tjerë, peshku dhe frutave detare për 0.4 për qind, orizi, prodhimet e tjera të bukës, drithërat dhe vezët për 0.2 për qind.

Zvogëlimi i indeksit të shpenzimeve të jetesës është shënuar edhe te pakot turistike të aranzhimit për 7.5 për qind, kopshtet, bimët dhe lulet për 1.4 për qind, librat për 1.3 për qind, automobilët për 1.1 për qind, lëndët tjera personale për 0.4 për qind, enët e qelqit, pajisjet e kuzhinës dhe mjetet tjera për 0.3 për qind, pajisjet e informatikës dhe shërbimet për higjienë për 0.2 për qind.



## DEFEKT NË STACIONIN E NGARKIM-SHKARKIMIT NË TETOVË



Disa qytetarë kanë reaguar duke nënvizuar se në orët e mbrëmjes janë djegur këta mbeturina dhe është krijuar një erë e rëndë dhe padurueshme nga djegia e tyre

Koha

Urim HASIPI

# SËRISH PROBLEME ME MBETURINAT

Tetovë, 7 maj - Ditëve të fundit është krijuar sërish deponi e re në Tetovë. Tashmë disa ditë me radhë janë duke u deponuar sasi të mëdha të mbeturinave në hapësirat ku gjendet Stacioni për Ngarkim dhe Shkarkim në dalje të Tetovës, në afërsi të rrugës për në fshatin Trebosh. Në këtë mënyrë, mbeturinat nga qyteti i Tetovës, gjegjësisht një pjesë e tyre në vend se të dërgohet në Drislla, përfundon këtë vend. Ndërmarrja Publike Komunale në Tetovë has në vështirësi që tërë mbeturinat ti transportojnë në Drislla, dhe në këtë mënyrë - tashmë stacioni për ngarkim shkarkim është rikthyer në deponi. Disa qytetarë kanë reaguar duke nënvizuar se në orët e mbrëmjes janë djegur këta mbeturina dhe është krijuar një erë e rëndë dhe padurueshme nga djegia e tyre. Në ndërkohë, nga Ndërmarrja Publike Komunale Tetova-Tetovë, thonë se është paraqitur

problem teknik, gjegjësisht defekt në Stacionin për ngarkim dhe shkarkim dhe presin që një pjesë e dëmtuar të arrijë nga Kroacia dhe të rifillohet me përpunimin e mbeturinave. "Brenda mundësive tonajemi duke bërë transportin e mbeturinave për në Drislla. Pjesa më e madhe dërgohet atje, por tërë ato mbeturina që grumbullohet nga amvisëritë nuk mund të dërgohet menjëherë, prandaj edhe është krijuar kjo situatë e përkohshme, e cila presim që sa më shpejt të tejkalohet. Mohojnë kategorikisht se mbeturinat janë djegur", thonë nga Ndërmarrja Publike Komunale Tetova-Tetovë. Sipas autoriteteve të kësaj ndërmarrje, në Tetovë brenda ditës grumbullohen sasi e madhe e mbeturinave. Aktualisht në Tetovë grumbullojmë rreth 250 ton mbeturina brenda ditës. Kjo sasi pritet të rritet nga dita në ditë në sezonin që pason, sidomos kjo

sasi dyfishohet gjatë verës kur kthehen mërgimtarët dhe kemi dukshëm shtim të popullatës dhe me këtë - automatikisht rritet edhe sasia e mbeturinave si në qytet, po ashtu edhe në vendbanimet përreth", sqaron drejtori i kësaj ndërmarrje, Xhelal Ceka.

Nga Eco Guerilla theksuan se komuna nuk është e aftë që të menaxhojë me mbeturinat dhe duhet që pushteti qendror t'ia merr ingerencat Komunes së Tetovës në sferën e menaxhimit me mbeturinat dhe vetë organizojë të njëjtën. Kanë kaluar dhjetë vite që kur Tetova ishte ngulfatur nga mbeturinat, pasi të njëjtat ishin grumbulluar afër stacionit hekurudhor në Tetovë. Pothuajse që atëherë e këndej problemi me mbeturinat e përkohshme shfaqet kohë pas kohe. Në këtë drejtim janë edhe shqetësimet e shoqatave joqeveritare, të cilët kërkojnë që ky pro-

blem të zgjidhet urgjentisht. Përndryshe, mbeturinat nga rajoni i Pollogut vazhdojnë të mos transportohen në deponinë Rusino të Gostivarit. Gjatë verës së vitit të kaluar, ky stacion u lëshua në përdorim. Atë kohë u theksua se pas fazës së parë, do të ketë edhe faza tjetër që është selektimi i mbeturinave, por kjo ende nuk ka filluar.

"Faza tjetër e këtij projekti është sa i përket selektimit. Në këtë vend është përmbledhja e mbeturinave në përbërje të plotë dhe transportimin e tyre, kurse me fazën e dytë shohim që të bëjmë edhe selektimin e mbeturinave që mendojmë se do ndihmojë akoma më tepër ndërmarrjen publik", kishte deklaruar atë kohë kryetarja e Komunes së Tetovës, Teuta Arifi. Tashmë mbeturinat transportohen për në deponinë Drislla, që është shumëfish më e shtrenjtë.

## Deri më 21 maj subvencionet për stufat me peleta

Shkup, 7 maj - Qyteti i Shkupit përkujton se vijon turrja publike për kompensimin e një pjesë të shpenzimeve për furnizimin e stufave. Qytetarët do të blejnë stufa me peleta deri më 21 maj të vitit 2018, do ta marrin një pjesë të shpenzimeve për furnizim në shumë prej 70 për qind, por jo më shumë se 30.000 denarë me tatim personal të përfshirë për një amvisëri. Kjo thirrje do të realizohet sipas principit "i pari vjen, i pari shërbehesh". Qyteti i Shkupit e publikoi këtë thirrje publike që të përmirësohet cilësia e ajrit dhe të zvogëlohet ndotja e ajrit, posaçërisht nga grimcat partikulare të ngrohjes së shtëpive të cilat nuk janë të kyçura në ngrohjen qendrore. Përparësia e shfrytëzimit të paletave është e shumëfishhtë: fuqi më e madhe kalorifike, ndotje minimale e ajrit, prodhim i sasisë më të vogël të hirit, shiten në variant të papaketuara, në qese prej 15kg, për çka furnizimi mund të zhvillohet në vazhdimësi, sipas nevojës, nuk është e nevojshme hapësirë e madhe për deponim dhe ruajtje etj. theksojnë nga Qyteti i Shkupit. Stufat me peleta, megjithatë, janë më efikase nga ato klasike, më pak ndotëse, nuk ka nevojë për pastrim të përditshëm të hirit dhe janë të lehta për përdorim. Thirrja për subvencionim u shpall më 5 prill të vitit 2018 dhe është paraparë të zgjatë 45 ditë kalendrike, bashkë me 21 majin e vitit 2018, ose deri në shterjen e mjeteve të parapara financiare nga Buxheti i Qytetit të Shkupit për këtë qëllim. Deri më tani deri te Qyteti i Shkupit janë parashtruar 163 kërkesa për subvencionim.

## SUGAREVSKI PËR PROJEKTIN E VITIT TË ARDHSHËM

# UJËSJELLËS I RI NË ZHELINË, INVESTIM PREJ 665 MIJË EURO

Shkup, 7 maj - Në tremujorin e parë të vitit të ardhshëm pritet të ndërtohet tubacioni dhe rezervuari për ujë në Komunën e Zhelinës, me të cilin plotësisht do të zgjidhet problemi me furnizimin me ujë në 18 vendbanime. "Investimi është në vlerë prej 665 mijë euro, të siguruar përmes huas nga Banka Investuese Evropiane (BIE). Realizuesit dhe mbikëqyrja informuan se ndërtimi rrjedh konform afateve të dhëna dhe

presim të përfundojë në tremujorin e parë të vitit të ardhshëm", deklaroi ministri i Transportit dhe Lidhjeve, Goran Sugareski, i cili sot inspektoi në punët ndërtimore.

Sugareski potencoi se projekti është shumë i rëndësishëm për të gjithë komunën, në të cilën prej 18 vendbanimeve, vetëm në njërin plotësisht është rregulluar furnizimi me ujë. "Përmes këtij projekti do të krijojmë kushte që

ta zgjedhim këtë problem që të mundësojmë në periudhën e ardhshme vendbanimet e tjera normalisht të furnizohen me ujë", tha Sugareski. Ai shtoi se ndërtimi i sistemit për furnizim me ujë në Zhelinë është pjesë e përcaktimit programor të Qeverisë për sigurimin e nivelit të lartë të mbulimit në territorin e Maqedonisë me rrjet të ujësjellësit dhe kanalizimit.

Siç informoi ministri i Tran-

sportit, në vijim është realizimi i dhjetë projekteve në vlerë prej 3,3 milionë euro për ndërtimin dhe rikonstruktimin e ujësjellësve dhe kanalizimeve. Gjithashtu, me mjetet e BIE, tashmë janë lidhur marrëveshje për ndërtimin dhe mbikëqyrje të 11 projekteve në vlerë të përgjithshme prej 4,4 milionë euro, ndërsa në fazën e procedurës tenderiale janë tetë projekte me vlerë të përgjithshme prej 3,9 milionë euro. Sipas

Sugareskit, nga linja kreditore nga BIE në dispozicion mbesin rreth 12 milionë euro. "U bëjmë thirrje të gjitha komunave të cilat ende kanë në dispozicion mjete të shpejtojnë dhe të dorëzojnë projekte të gatshme deri te Ministria që të mund t'i realizojmë. Për këtë shkak apeli ka të bëjë deri te të gjithë kryetarët e komunave të cilët ende i kanë në dispozicion këto para", deklaroi Sugareski.



Ejetojmë një kohë kur, gjykoj i tejkalum përfaqësuesit tanë politikë! Ma në fund erdhi edhe kjo fazë! Një kohë kur mësojmë si të vihemi mbi ta, tuj dit edhe arsyen se përse. Ky quhet, ndërgjegjësim! Dikur aq shumë i lartësonim e i imagjinonim si supermenë ( ndaç për të ba t'mirën , ndaç zullumin!) sa veten e vinim në pozitën e miniaturanit të përvujtun e në nevojë! Një si tip mazohizmi qytetar ky; ishim votues mazohist, kështu diçka do e kisha përshkrujt veten tonë! Unë i bona goxha do vite përderisa arrita me i nda do faza jete, në etapa : nga periudha e mitizimit të tyne tash jetoj periudhën e ç'mitizimit të po të njajtëve ! Pra , m'u tani i nderum lexues kujto se sa e gjatë është jeta jote e se sa shumë mundesh me bo me të, për mos me e lan të të hik për hunde e pa e diktul! Por mbi të gjitha, për me bo diçka të mirë prej saj! Sepse , jeta , në kalkulimin e sotëm edhe mund të lexohet si Shans që t'a ka dhan Perëndia! Do e shfrytëzosh, apo do e djegësh kot ? Mendoje!

Sot psh, rrallë nga ne jua dijmë emrat ministrave e përfaqësuesve të institucioneve , shpesh nuk dijmë edhe kush i kujt parti politike është lider/e. Janë bo shumë parti politike, aty këtu rrotullohen emnat e njëjtë dhe për ne nuk është sfida kjo, sepse lypim diçka më të madhe! Hej, kjo asht mirë! Mbye mend, jemi tuj jetu një fazë të mirë të vetënjohjes ! Faza kur individi mer në peshë e e ban Zanin! Bajë Zanin! Nuk dua të bëj vetëqejf jo, sepse kam argumente të gjalla, psh , protestat për mbylljen e Jugohromit ( sado një zgjidhje me këtë gjigand ekonomik duhet me u gjetë, njerëzit janë të papunë!) , protesta : Almiri ose ma e reja psh- protestat për mbylljen e Kazinove . Më pëlqen fakti që përsëri edhe në Tetovë!...Jo për diçka tjetër, por asht qyteti i studentëve për ne shqiptarët këtej! Nëse përfaqësuesit tanë politikë i kanë harruar studentët, studentët kanë zgjedhur të zgjohen vetëvetiu! E kur këta të zgjohen me vrullin e së vërtetës, gjykoj gjërat do tunden sërrish ! Nga këta të rrinj , djem e vajza , mezi pres t'ju bashkangjitem në protestën e tyne të madhe që do përkonte në rritjen e e cilësisë nëpër universitete ( oh çfar basthardimi ka nëpë to!!!) dhe prandaj më vonë edhe në protestën e vazhdueshme për nevojën e hapjes së vendeve të reja të punës në vend të ikjes nga vendi!...Le t'a quaj këtë fazë jete : PROTESTË BURIMORE! E përse burimore? Sepse nuk t'a porosit partia, por e ban vetë, e pjell vetë, biles të pëlqen ma shumë, sepse të ka mësuar të kërkosh llogari! Thonë se duhesh me zgjedh mes lumturisë dhe së vërtetës. Nuk mund të jesh i qetë po i deshe të dyjat njëkohësisht. Unë do të kisha sygjerruar të zgjedhësh lumturinë , pos nëse nuk mer thirrjen për të vërtetën ! Kjo lloj thirrje në esencë të bën Lider/e! Por jo doemosdoshmërisht Të Mirë!

Kujto vetëm pak dhe pranoje psh

## Të jemi pjekur?!

se përfaqësuesve tanë politikë jua kemi harru edhe premtimet elektorale! E përse po na ndodh ky fenomen? Një përgjigje e shkathhtë odash do thoshte ngase : "atyre askush nuk iu beson kur i thonë premtimet". Në esencë nuk i beson kapacitetit të atij/ ( asaj më rrallë!) që e thotë premtimin! Premtimet i japin përpara shpresës personale ndërsa i përmbushin si rezultat frikës personale! Tuj mos pas frikë nga vetja , shpresën e shndrojnë në Fuqi që jua jep politika, vota jonë! Në këtë moment, këta liderë e humbin betejën morale para votuesve të tyne! Për më keq , e dijmë se në çfarë sorte votuesish t'stërkequn u shndëruam edhe ne , apo. Psh, kur ju aplaudojmë nëpër fushata , po të lus vetëm të kujtosh në monologun tënd të brendshëm : "ah çka ja fut kot bre..." - ka fol brendia jote, apo? Boju i sinqertë e pranoje se s'ta kan mbush synin! Ndosh-ta me ndonjë përashitim tek tuk! Të mos flasim më nëse jua mbajmë mend premtimet , sepse zakonisht koha e ardhshme "do të..." është ma e spikatura në fjalorin e tyre! Ka vite e dekada kur presim decentralizim funksional psh. Ndërsa e jetojmë ndërgjegjësimin politik kur sa vjen e më shumë bindemi se sa i rrëndësishëm është përfaqësuesi i Komunës, ai lokali psh. I pari i Komunës dhe Këshilli Komunal. Sado ende e trajtojmë si person VIP, shumë shpejt do e kuptojmë se ky dhe Këshilli duhen me

qenë në shërbimin tonë. Ndërsa për t'u vu në shërbimin tonë , nevojitet me jama msy të dijmë të kërkojmë atë që na takon si qytetarë e banues të zonës! Nuk di sa jemi në gjendje t'a bëjmë të dytën , nga droja e së parës...Ani se vazhdimisht jemi të ndërgjegjshëm se këta liderë hyjnë aty më "cop brekësh të grisuna" ( i thonë llafit...), e dalin nga detyra si milionerë! Ndërsa ne që i kemi votuar për kaq shumë herë, ende i arrojme brekët e para dy dekadave o më shumë! Jam e bindun që dakordohesh me shumëçka hodha në këtë letër gazete i nderuar lexues, por edhe një gjë le t'a kuvendojmë bashkë : a duhet ti japim rrëndësi protestës? Përgjigja ime është PO, e fuqishme biles ! Biles kisha mbajtur cikle emisionesh TV mbi Fuqinë e Protestës! Jam e bindun që serialeve turke do ju bëja konkurrencë djalli! Protesta del si rezultat i shpresës dhe i rrefuzimit të vdesësh për së gjalli! Pra, ne të dy u dakorduar që nuk iu besojmë më përfaqësuesve tanë politikë dhe se po ndërgjegjësoheshkemi ngadalë për peshën e madhe të votës sonë! E para. Pastaj u dakorduar se nuk jua mbajmë mënd emrat e as premtimet atyre, sepse mësuam t'i tejkalojmë e madje t'i injorojmë ngase na dëshpëruan shumë! E dyta. U dakorduar se "brekëgrisurit e djeshëm" që bahen milionerë pas katër vitesh n'politikë o në post, me çdo kusht duan të harrojnë

**Në protestë takon të ndryshëm, edhe të partisë në pushtet, por edhe asaj në opozitë, por edhe asaj me një kamb n'pushtet e me tjetrën n'opozitë, edhe atë që shet në tezgja, por edhe atë që të mëson fëmijën në shkollë, në protestë janë të gjithë bashkë, rrezatojnë të gjithë një gjë: solidaritet.**



dukun e gjendjen e tyne të djeshit , e prandaj me çdo kusht e rikrijonë veten në momentin kur bahen të pasun . E treta. Do dakordohemi lexues/ i /enderum/e se pikërisht kjo lloj filozofie rrishtakësh ka filluar të rrezikojë seriozisht sistemin e atyre pak vlerave që i krijuam me kohë e mund! Kjo ishte e katërta dhe quhet TRAUMË KAPITALE SHOQËRORE!

A nuk është kjo arsyeja e zemrës për me protestu vazhdimisht? Si individ, si grup, ose si turmë e madhe ... Në protestë takon të ndryshëm, edhe të partisë në pushtet, por edhe asaj në opozitë, por edhe asaj me një kamb n'pushtet e me tjetrën n'opozitë, edhe atë që shet në tezgja, por edhe atë që të mëson fëmijën në shkollë, në protestë janë të gjithë bashkë, rrezatojnë të gjithë një gjë: solidaritet. E kur e arrin dimezionin e solidaritetit, ndihesh i barabartë para së vërtetës tënde! Protesta është pjekuri politike...! Këtë do thoja unë! Sepse, interesi nga i cili dikush sillet si i verbër dhe prandaj hesht me devotshmëri, tjetrit ia hap sytë!

Ndërsa neve, aq shumë na janë hapur sytë sa kokërrllokët duhem mbajtur mos shpërthejnë me hidhnm të tërbum. Dhe le mos harrojmë se vetëm disponimi ynë i këtij lloj ndërgjegjësimi politik e përcakton vlerën e lumturisë së përgjithshme!

(Autorja është kolumniste e rregullt e gazetës KOHA)



Nga Adelina MARKU

## KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Rattkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Coce Dellep nr.11, | Q.T. Mavrovashja lok.14 - përdheshë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribuimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e hënë 7 maj | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006  
Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA  
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribuim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221  
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772



# Shën Gjergji, festa e gjelbërimit



Nga  
Arsim KOLARI

Kundruar nga prizmi i jetës së rëndomtë, jeta duket se "shkruan" më së shumti për veprimtarinë e popullit. Derisa te popujt e tjerë për emancipimin dhe edukimin e popullatës janë kujdesur institucionet arsimore, kulturore, shkencore e administrative, ndër ne "ligjet e jetës" janë krijuar pothuajse gjithandej ku është zhvilluar jeta nën sisteme të ndryshme pushtuese. Jeta e njeriut shqiptar u ndërtua mbi traditat e lëna nga të parët, të cilat realisht i dhanë ngjyrimë dëshirës për ta trashëguar atdheun. Në mesin e pasurive të trashëguara nga të parët, me të drejtë qëndrojnë ritet e zakonet tradicionale.

Festat e motmotit lidhin jetën e shqiptarit me natyrën dhe jetën e vendit. Si popull i vjetër, shqiptarët i kanë ruajtur festat e motmotit: Ditën e Verës, Nevruzin, Shën Gjergjin, Shën Mitrin, etj. Festa e Shën Gjergjit kremtohet me 6 maj me kalendarin e sotëm Justinian apo "allafranga", siç e quan populli, ndërkaq me kalendarin Julian apo "allaturka", i bie të jetë 23 prill.

Duke u bazuar në enciklopedinë katolike, e cila mban qëndrimin në ekzistencën historike të Shën Gjergjit, megjithëse pak dihet rreth jetës dhe veprimtarisë së tij, del se ai u lind në Nikomedia (Nicomedia, Iz-

mit), rajon në Turqinë e sotme. Shën Gjergji ka jetuar në shekullin III (e. r.) ndërmjet viteve 275-303. Prindërit e tij ishin të krishterë, babai nga Kapadokia (Cappadocia) kurse e ëma nga Palestina. Edhe vetë Gjergji më vonë, pasi që u bë ushtar romak, jetoi në Palestinë, ku protestoi kundër persekutimit të krishterëve nga ana e Romës pagane, ndaj u burgos dhe u torturua por, qëndroi besnik ndaj besimit të tij të krishterë. Me 23 prill 303 atij iu pre koka në qytetin Lyda të Palestinës, ku edhe u varros dhe akoma besohet të dihet varri i tij. Si rezultat i torturave që përjetoj Gjergji gjatë shekullit III dhe IV arriti të konsiderohet si "i shenjtë" (saint-shën). Pas zyrtarizimit të krishterimit, Shën Gjergji u bë simbol dhe mbrojtës i ushtrisë bizantine dhe shumë vende evropiane, për shkak se ai ishte ushtari i parë profesionalist i krishterë në Perandorinë Romake. Në vitin 1222, Këshilli Kombëtar në Oksford shpalli 23 prillin "Dita e Shën Gjergjit", si ditë feste anekënd Anglisë. Shën Gjergji festohet nga shumica e vendeve me popullatë të krishterë, pjesë të Lindjes së Mesme, tërë Evropa, SHBA dhe tejq Oqeania. Shumica e krishterëve: katolik dhe anglikan manifestimin për nder të këtij martiri e njohin si Saint George Day (Dita e Shën Gjergjit), Ortodoksët

poashtu e njohin si Dita e Shën Gjergjit (në Lindje të Mesme dhe Afrikën Veriore), si "Yuriev Den" (në Federatën Ruse dhe ish Republikat e Bashkimit Sovjetik), si dhe "Durdëvdan-Gjurgjovden" (tek sllavët në përgjithësi), ndërsa për çudi protestantët, të cilët veten e konsiderojnë si reformist të kishës, në veçanti të asaj perëndimore, nuk festojnë fare lidhur me Shën Gjergjin.

Edhe disa nga çifutët festojnë, respektivisht vizitojnë varrin e Shën Gjergjit, duke konsideruar qytetin Lyda si vend ku është varrosur profeti Elijah/Elisha (Iljasi apo Eljesai). Disa nga muslimanët konsiderojnë Shën Gjergjin si hazreti Hidri (Hızır, "i Gjelbëri"), respektivisht një takim metafizik i Hidrit dhe Iljasit në kohën e gjelbërimit, që përket me stinën e pranverës, i njohur tek sufistët si "Hıdırellez".

Ekziston një ngjashmëri sipërfaqësore ndërmjet Shën Gjergjit dhe Hidrit në aspektin gjuhësor, ngase emri Gjergj (George) rrjedh nga greqishtja e vjetër "georgeus" që do të thotë bujk, ndërsa El Hidri nga arabishtja gjithashtu do të thotë "i Gjelbëri". Këtë festë pagane ndër shqiptarët, disa studiues mundohen ta emërtojnë si festë fetare, ndërkaq që ritet e kësaj ditë-feste kanë të bëjnë me bimësinë, blegtorinë dhe mirëqenien

**Edhe kremtimi i festës së Shën Gjergjit hyn në pasurinë e folklorit tonë, për të cilën poeti i madh Gjergj Fishta e quajti "Ashti i Kombit". Festat e motmotit janë formë brilante dhe shumë koncize e informimit të popullatës për ardhjen e një stine të re. Ato bartin në vete porosinë, afirmojnë vlera e qortojnë mosvlera**



që i vjen shoqërisë nga to. Kjo datë shënon ardhjen e një stine të re, njëloj si Shën Mitri (bie më 8 nëntor), e që të dyja këto data ndajnë vitin në dy pjesë, verë-dimër.

Edhe kremtimi i festës së Shën Gjergjit hyn në pasurinë e folklorit tonë, për të cilën poeti i madh Gjergj Fishta e quajti "Ashti i Kombit". Festat e motmotit janë formë brilante dhe shumë koncize e informimit të popullatës për ardhjen e një stine të re. Ato bartin në vete porosinë, afirmojnë vlera e qortojnë mosvlera. Veç karakterit filozofik-edukativ, festat e motmotit përshkohen edhe me veçori argëtuese, nëpërmjet së cilës populli edhe argëtohet, por edhe bën thirrje që t'i përvishen punës për të siguruar egzistencën, pastaj edhe për të luftuar të jetojnë të lirë. Lidhur me këto motive të jetës, poligloti ynë Faik Konica, është shprehur: "Të mos i lëmë të humbasin këto festa të vjetra të racës sonë. Nuk i bëjnë dëm njeriut. Sjellin një gëzim të kulluar nëpër shtëpi. Në një vend ku jeta e të vegjëlve është aq e trishtuar, ndaj djalëria dhe vajzëria kanë këto pak raste të rralla për t'u dëfyer". Ndaj, të mos i neglizhojmë festat që sjellin harmoni në shoqëri, e që kanë për qëllim të na e bëjnë jetën më të dashur. Gëzuar na qoftë festa e Gjelbërimit...!

Dy muaj pas zgjedhjeve parlamentare ende nuk ka asgjë të re nga Italia lidhur me krijimin e qeverisë. Grupimet populiste të Lëvizjes së Pesë Yjeve dhe konservatorët e djathtë bllokojnë vazhdimisht njëri-tjetrin. Socialdemokratët që kanë qeverisur deri më tani u goditën rëndë në këto zgjedhje dhe kanë ngrirë në opozitë. Të gjitha përpjekjet për ndonjë formë koalicioni mes protestuesve, radikalëve të djathtë dhe më të moderuarve kanë dështuar. Presidenti i Italisë, Sergio Mattarella vëren me zhgënjim, se të gjitha përpjekjet e tij kanë shkuar dëm, sepse asnjë nga palët nuk do të afrohet, por këmbëngul në pozicionin e saj.

## PËRPJEKJA E FUNDIT PARA ZGJEDHJEVE TË REJA

Lëvizja e Pesë Yjeve kërkon zgjedhje të reja në qershor. Radikalët e djathtë duan më mirë të presin deri në fund të vitit. Secila parti ka kalendarin e saj me të cilin llogarit, se kur do të ishin shanset më të mira për të kapur shumicën në parlament. Presidenti Mattarella nuk është fort entuziast për

## Kërcimi i Italisë mbi vullkan

zgjedhje të reja. Ai e ndjen zhgënjimin e shumë italianëve, që jo pa të drejtë thotë, se zgjedhjet e reja do të sillnin ndoshta të njëjtin rezultat, pra një bllokadë të re. Nga ana tjetër zgjedhjet e reja shihen si shpërdorim i panevojshëm parash. E shteti italian i mbytur në borxhe nuk ka para për të dhuruar.

Për këtë arsye të hënën (07.05) presidenti italian ndërmerr përpjekjen e fundit për të sjellë në tryezën e negociatave si populistët e majtë ashtu edhe ata të djathtë me socialdemokratët. Ende shpresohet për një koalicion të mundshëm mes Lëvizjes së Pesë Yjeve dhe socialdemokratëve, ose me pjesë të kësaj partie në rrënim e sipër. Por edhe një koalicion mes "Lëvizjes" dhe partisë Lega Nord nacionaliste mund të mendohej. Për këtë duhej të sakrifikohej personi që lëviz fijet në prapaskenë, Silvio Berlusconi.

**Në Itali vazhdon sot (07.05) pokeri politik për një koalicion qeveritar. Por varianti pa qeveri mund të jetë ndoshta më mirë për Italinë, se ndonjë koalicion populist**

Por 81 vjeçari nuk është i gatshëm të largohet nga skena.

Nëse edhe kjo tentativë e fundit dështon, atëherë presidenti italian mund të vendosë një qeveri teknokrate që mund të miratojë buxhetin e vitit 2019 dhe të përgatisë zgjedhjet e reja në pranverën e ardhshme. Por edhe teknokratët duhet të përballën me mocionin e votëbesimit në parlamentin e përçarë italian. Një mundësi tjetër

është që kryeministri në detyrë, Paolo Gentiloni të vazhdojë të jetë në detyrë, por pa shumicë parlamentare. Kjo e bën shumë të vështirë miratimin e buxhetit të vitit të ardhshëm.

### TREGJE ENDE TË BUTË

Këtë cirk politik Italia e vazhdon, vetëm sepse për momentin ekonomia italiane po përfiton nga disa filiza të rritjes ekonomike. Tregjet financiare nuk kanë reaguar me panik ndaj pokerit të koalicioneve në Romë. Edhe normat e interesit për rifinancimin e kredive janë të përballueshme. Por për tregjet dhe eurozonën Italia është një vend i rëndësishëm, prandaj zgjidhja më e mirë do të ishte një qeveri e përkohshme. Ajo do të krijonte idenë e stabilitetit e do dukej më e besueshme se një përzjerje e të djathtëve e të majtëve. Nëse popu-

listët euroskeptikë vijjnë në pushet, atmosfera e qetë e deritanishme në tregje mund të ndryshojë. E nëse tregjet nuk kanë besim tek Luigi Di Maio i Lëvizjes së Pesë Yjeve apo tek Matteo Salvini i Lega Nord atëherë vendi rrezikohet nga kriza financiare. Borxhet e larta nuk mund të rifinancohen, ombrella e shpëtimit të euros duhej të aktivizohej. Kjo pasiguri rritet po të mendosh që do vijë një moment e Banka Qendrore Europiane do të rrisë normat e interesit, gjë që sjell automatikisht rritjen e obligacioneve shtetërore italiane. BE duhej kështu të mbështeste Italinë me qindra miliarda. Shpëtimi i Greqisë do dukej në një rast të tillë si një ushtrim i lehtë. Italia kërcen kështu mbi një vullkan virtual, që sillet si Vezuvi: Ende ai hesht, por llava mund të shpërthejë në çdo moment. (DW)



Nga  
Bernd Riegert



## SPROVË LEXIMI

# BURGU SI LABORATOR KRIJUES

(Romani "Një sagë e vogël" i Besnik Mustafajt, një projektion orvellian i grabitjes së spontanitetit të jetës njerëzore)

Koha Emin AZEMI

Romani "Një sagë e vogël" i Besnik Mustafajt sjell një model realiteti që përthehet në receptivitetin e vëzhguesit të sotëm si një alegori për gulagun shqiptar. Distanca estetike për një rrëfim që tematizon mungesën e lirisë dhe teprinë e depersonalizimit të njeriut, modelohet figurativisht përmes disa linjave narrative, të cilat kanë një hapësirë të përbashkët të eksplikimit psikologjik e social. (*Atmosfera orvelina në ambientet e burgut dhe nata e kaluar e Bardhylit dhe Lindës në dhomën speciale të burgut*) Herojtë e kësaj proze ndërtohen sipas një mekanizmi që autori e përdor në formë të teknikës së montazhit poli-semantik të ideve paralele për metafizikën e frikës ("Vetëbesimi i njeriut të lirë mbështete te guxi-

mi. Ai i të burgosurit te frika"), dualizmin e shpirtit dhe materies, si dhe të hapësirave të munguara të dinjiteteve personale brenda trashësisë që sjell muri i ndarjes në mes të atyre që jetonin në burgun e brendshëm dhe atyre që jetonin në lirinë burgosur jashtë.

Autori na ofron një shikim tredimensional të kuptimit të asaj që ai e ka konceptuar si burg, përmes tre tipave të heronjve që përjetojnë burgun: si i burgosur (Oso Huta, Omer Huta, Bardhyl Huta), si gardian burgu (Hyqmet Hidi) dhe si kronist letrar (Andrea Boteci). Është një refleksion mjaft i zhvilluar estetik i autorit për të identifikuar kodin e bashkëjetesës midis mitit për jetën e shkuar që kërkohet të harrohet dhe të panjohurës që sjell jeta jashtë burgut. Selvia, mamaja e Lindës, kot ishte munduar të gjejë një qytet ku nuk kishte

burg për ti siguruar së bijës një jetë të qetë bashkëshortore. Edhe pas një bredhjeje të lodhshme, ato të dyja, Linda dhe mamaja e saj, nuk kishin mundur ti ikin projektionit fatal të të jetuarit brenda kallëpeve që ti impononte uniforma e rëndë e kohës. ("Dënimi im tregoi sa të kota kishin qenë përpjekjet e stërmundimshme edhe në familjen time edhe në atë të Lindës për të ndërtuar për ne, fëmijët e tyre, një jetë pa lidhje me të kaluarën"). Përkatesia femërore e këtij kërkimi prej Sizifi të një qyteti pa burg, kufizohej me lëkurën e vrazhdë të realitetit, ku nuk mbetej jashtë ajo që më vonë do të përkufizohej si fat, por edhe si fatalitet.

Ideja e autorit për të plazmuar fatalitetin njerëzor në një shoqëri ku ishte pushkatar egoja para se ajo të shpërthente në shtratin normal të procesit social, nxjerr në pah heroin e mundur (Bardhyl Huta), por



edhe idealizon mundësinë e rikrijimit të epopesë së një kohe që kishte prodhuar kujtesë (përmes Andrea Bodecit) për gjithë ata që në unazat e përflakura të burgologjisë kishin injektuar një realitet të dyzuar për heronjtë e burgjeve – për ata që kishin vuajtur brenda tyre si Oso Huta me pasardhësit e tij dhe për ata që ishin munduar ta ngrënë në njëfarë morali sjelljen e të qenit gardian burgu (Hymet Hidi).

Shpresa dhe mjerimi ishin dy kuptime të kundërta që e karakterizojnë botën shpirtërore të heronjve të kësaj proze. ("Dihet se nuk ka gjë më të shtrenjtë se shpresa kur je në mjerim. Frika e humbjes së saj nuk është frikë e rëndomtë. Ajo shërben për të fshehur vullnetin e jashtëzakonshëm të njeriut për të mos u dorëzuar. Ky është guxim i vërtetë" (fq. 91). Përpjekja për të paraqitur shpresën më të plotë në trajtat e ekzaminit psikologjik të një jete që po luftonte ta largonte burgun nga inventari i kujtimeve, del të jetë një prej ideve që autori e zhvillon brenda koherencës semantike dhe filozofisë së gjallimit.

Për një raport të receptimit dhe përthimit në gjuhën frënge, veçohet: "Është shkrimi i Ridvan Dibrës, i bukur dhe interaktiv (duke sfiduar lexuesin), që "marton" poetikisht këto argumente: kapituj të shkurtër dhe fraza të thjeshta, idetë e sinkronizuara që vijnë si refrenet e një kënge, titujt dhe fundet e kapitujve që përmbledhin në pak fjalë çka ndodh; si në rrëfimet e dikurshme. Përkthimi i përcjell me sqimë këto veçori dhe i bën ato të natyrshme..."

Yllka NDOJ

Prej vdekjes së papritur të babait të tij, i bindur se është një vrasje, dhe ai e di identitetin e vrasësit të tij, Bala i vogël i kushton kohën e tij fantazisë për hakmarrje. Marrja e temës nga një këngë e lashtë e Ballkanit, shkrimtari Ridvan Dibra i jep asaj ngjyra letrare, duke shkruar një tregim të madh. Është një këndvështrimi interesant nga letrat franceze për shkrimtarin shqiptar.

Prej vdekjes së papritur të babait të tij, i bindur se është një vra-

RIDVAN DIBRA NË DIOPTRINË E KRITIKËS FRANCEZE

## NJË NGA PESË SHKRIMTARËT MË TË MËDHENJ SHQIPTARË QË JETOJNË



sje, dhe ai e di identitetin e vrasësit të tij, Bala i vogël i kushton kohën e tij fantazisë për hakmarrje. Marrja e temës nga një këngë e lashtë e Ballkanit, shkrimtari Ridvan Dibra i jep asaj ngjyra letrare, duke shkruar një tregim të madh. Është një këndvështrimi interesant nga letrat franceze për shkrimtarin shqiptar Dibrën, i klasifikuar si një nga pesë shkrimtarët më të mëdhenj që jetojnë shqiptarë me Ismail Kada-renë, Rexhep Qosen, Bashkim Shehun dhe Fatos Kongolin, i lidhur pikërisht për romanin e tij "Legjenda e vetmisë", që është cilësuar si "romani më i mirë" në vitin 2012.

Duke dhënë një gjendje sipërore me këtë roman kritika franceze veçon se "ne zhytemi në leximin e kësaj përralle me emocion", që vjen e maskuar në këtë roman.

Me heroin kryesor Balën e vogël, në sytë e të cilit shihet çdo gjë që formon botën e tij, libri ka hyrë në libraritë franceze e përkthyer nga Evelyne Noygues, prej botimeve "Le Ver a Soie", Paris, me titullin në frënge "Le Petit Bala / La légende de la solitude".

"Përmes syve të Balës shohim sesi jeta nis dhe e humb domethënien, ndjekim me ankth ligësinë e mizorinë e njerëzve. I ndarë mes

njerëzimit e pyllit, Bala tërhiqet pak e nga pak drejt këtij të fundit. Dhe aty në strofullën e pyllit ai rigjen veten, gjen shpirtat e tij që e pajtojnë disi me jetën... Bala është një fëmijë me ndjeshmëri ekstreme, një fëmijë që e gatuan fatin e tij me intensitetin e një Zoti të ri të territ..."

"Një libër që t'i shpërfill qëllimshëm nihilizmin e dyshimin e tejkualuar modern, por edhe ironinë e lojnat e shumë – përsëritura postmoderne. Një libër, në dallim prej të tjerëve para tij, sa më "jashtë meje", sa më impersonal e objektiv. Një libër që, qëllimshëm, t'i lërë mënjanë "artificet kompozicionale", duke respektuar deri në adhurim burimin e parë, domethënë legjendën. Një libër që t'i kundërvihet postulatit të Xh. Kallerit se "epika rrëfen ngjarje, kurse lirika tenton të jetë vetë ngjarje", duke synuar një "epikë" që të rrëfejë ngjarje e, njëkohësisht, të jetë vetë ngjarje", është shënuar në libër

Ndërsa shtypi francez vazhdon në të njëjtin artikull me titull "Bala i vogël, Edipi në pyll, vetmia universale", duke shënuar se "Pas vdekjes brutale të babait, i bindur se bëhet fjalë për një vrasje dhe se e njeh

identitetin e vrasësit, Bala i vogël ua kushton kohën e tij fantazive të hakmarrjes. Duke e marrë temën nga një këngë e vjetër ballkanase, Ridvan Dibra ofron një mozaik letrar, duke firmosur një tregim mjaft drithërues..."

Për një raport të receptimit dhe përthimit në gjuhën frënge, veçohet: "Është shkrimi i Ridvan Dibrës, i bukur dhe interaktiv (duke sfiduar lexuesin), që "marton" poetikisht këto argumente: kapituj të shkurtër dhe fraza të thjeshta, idetë e sinkronizuara që vijnë si refrenet e një kënge, titujt dhe fundet e kapitujve që përmbledhin në pak fjalë çka ndodh; si në rrëfimet e dikurshme. Përkthimi i përcjell me sqimë këto veçori dhe i bën ato të natyrshme..."

Prej vitit 1995, që nis shkrimin me romanin e parë "Nudo", jeta letrare e Dibrës ka qenë intensive duke vazhduar me tregimet "Prostituta e virgjër", "Stina e ujkut", 2000, romanet "Triumfi i Gjergj Elez Alisë", "Triumfi i dytë i Gjergj Elez Alisë", 2003, "Kanuni i Lekës së vogël" – 2011, "Gjumi mbi borë", 2016, dhe së fundi "Treni i muzgut" – 2017 etj., duke u bërë një nga zërat më modernë në letërsinë shqipe.



“Unë mendoj se diçka e ngjashme me atë që quhet në anglisht “abuzimi seksual dhe ngacmimi” gjendet kudo në botë; siç thonë italianët: ‘Tutto il mondo è paese’. Ka nuanca të ndryshme kudo, varësisht nga zakonet dhe historia që ka formuar vendet. Unë kam parë dhe dëgjuar tregime të pabesueshme dhe mizore në të tria vendet ku kam jetuar. Do të ishte një subjekt i madh”

Nga Seth Rogoff

# ORNELA VORPSI: MBI EROTIZMIN, ABUZIMIN SEKSUAL DHE NGACMIMIN



“Vendi ku askush nuk vdes kurrë” i Ornela Vorpsit (Dalkey Archive 2009) është një nga romanet më të mira postkomuniste. I botuar fillimisht në italisht në vitin 2003, ai humton traumat e autoritarizmit, patriarkatin hiper-seksual dhe dhunën në shumë forma, duke ofruar njohuri dhe shikime poetike individuale dhe kolektive, mbi migrimin/mërgimin dhe kuptimin e artit dhe letërsisë. Vorpsi, e lindur në Tiranë më 1968, emigroi në Itali kur ishte 22 vjeçe. Jetoj 6 vite në Milano para se të shkonte në Paris, ku ajo banon aktualisht. Që nga debutimi i saj i mrekullueshëm me “The Country Where No One Ever”, ka botuar libra të shumtë në italisht dhe frëngjisht, përfshirë ‘La mano che non mordi’ (2007) dhe ‘Tu convoiteras’ (2014). Përveç shkrimit, Vorpsi punon si artiste vizuale, kryesisht piktoresh dhe fotografe.

**Do të doja të dëgjoja më shumë për procesin e shkrimit të librit “Vendit ku askush nuk vdes kurrë”. U botua italisht, por që rrënjësor thellë me ndjeshmëritë shqiptare. Si do ta përshkruanit, si erdhi ky libër?**

-Isha në Francë kur e fillova këtë libër. Shkrimi erdhi drejt meje. Endesha pa qëllim dhe isha kaq e trazuar për artin bashkëkohor, sepse doja të pikturoja.

Isha në këtë gjendje kur një ditë u ula në një bar dhe shkrova një novelë të shkurtër. Çjupa ishte e qartë-italisht. I mbërtheva ato fragmente që po shkruaja pa e ditur se çfarë do të bëja. Nuk kisha ëndërruar kurrë të bëhesha shkrimtare, doja të bëhesha piktoresh. Kështu që i mbërtheva fort, si për të justifikuar ekzistencën time, edhe pse ekzistenca nuk ka nevojë të justifikohet; është e mjaftueshme në vetvete. Humnerat brenda meje më nxitën të “prodhoja”. Kështu u krijua ky libër. Në një gjendje të përhumbur. Sigurisht, Shqipëria ishte e pranishme. Por ajo më digjte shpirtin aq shumë sa u detyrova, pa vetëdije, ta shprehja në një gjuhë të huaj, një gjuhë që nuk kishte lidhje me fëmijërinë. Ky libër, siç ndodh me një pikturë, erdhi me fragmente. Kam marrë kënaqësi të veçantë në lidhjen e fragmenteve si një lloj misteri – një libër që mund të lexosh si një roman, por gjithashtu si novela të dallueshme. Mendoj se kjo frymë erdhi nga përvoja ime në artet e bukura.

**-Politika e trupit i qaset “Vendit ku askush nuk vdes kurrë”, sidomos politika e trupit femëror, duke përfshirë zbulimin e tij. Një politikë e ngjashme e seksualitetit mund të shihet në veprat e shkrimtarëve të tjerë postkomunistë, si Herta Müller. Si mendoni se krahasohet kjo politikë me atë në Evropën Perëndimore – në Itali dhe Francë, për shembull? A mendoni se ka mënyra për të menduar mbi seksualitetin dhe fuqinë që mund të nxirret prej punës suaj për këtë moment aktual, ndërsa gratë gjerësisht vazhdojnë të përballen me abuzimin dhe ngacmimin seksual, që po vjen gjithnjë e më shumë në vëmendjen e publikut?**

-Janë vende krejt të ndryshme dhe periudha krejt të ndryshme. Është e vështirë t'i përmbledhësh siç duhet këto pyetje të mëdha. Në Itali kam gjetur ngjashmëri me erotizmin shqiptar. Janë dy popuj mesdhetarë, jo shumë larg gjeografikisht dhe dy popuj me një farë prirejje patriarkale. Kjo, me përjashtim të Italisë Jugore, ku figura e gruas si nënë, por si një nënë e moshuar dhe jo një grua, e bën atë një shenjtoresh; atje ju gjeni veten në një fushë pothuajse patriarkale. Unë mendoj se diçka e ngjashme me atë që quhet në anglisht “abuzimi seksual dhe ngacmimi” gjendet kudo në botë; siç thonë italianët: ‘Tutto il mondo è paese’. Ka nuanca të ndryshme kudo, varësisht nga zakonet dhe historia që ka formuar vendet. Unë kam parë dhe dëgjuar tregime të pabesueshme dhe mizore në të tria vendet ku kam jetuar. Do të ishte një subjekt i madh.

**Në romanin “Vendi ku askush nuk vdes kurrë”, narratori dëshiron të bëhet piktor, një artist, në varrin e një dervishi mistik. Cili ishte sfondi juaj në artet pamore në Shqipëri, në Itali? Cili ishte edukimi arsimit për artet në Shqipëri? Më intereson ky momenti i varrit – a mund ta përpunoni më shumë atë që keni shkruar për të?**

-Ishte shumë e vështirë të hyje në shkollën e artit në Tiranë. Konkursi i hyrjes ishte shumë

i vështirë. Të rinjtë vinin nga e gjithë Shqipëria dhe kishte vetëm 20 vende për disiplina të ndryshme. Metodën e mësimdhënies u importuan nga BRSS. Na mësonin “realizmin socialist”. Arti varej nga ideologjia në pushtet. Në veprat tona artistike duhej t'i këndonim lavde jetës sonë të lumtur, heronjve tanë, atdheut dhe komandantit Enver Hoxha. Ne u mbytem nga ky art, që synonte dhe ishte e detyruar të na edukonte.

Sa i takon momentit në varr: Isha në një stërvitje ushtarake, që ishte pjesë e detyrueshme e edukimit tonë; ne duhej të ishim të përgatitur në rast se vendi pushtohej. Nuk e di se si, por në një momenti ishim të braktisur. Donim vetëm të ishim të lirë për pak orë. Kështu u habitëm mbi një varrezë fshati, një varrezë me të vërtetë të vogël. Gruaja që po pastronte në varrezat na tregoi për varrin e dervishit. Pa besuar vërtetë, por të etur të mos humbnim asnjë mundësi – si një agnostik i mirë me një edukim ateist, hasa misterin që bën botën dhe e putha varrin e dervishit, duke kërkuar të pranohesha në akademi në Tiranë. Ai e dëgjoj dëshirën time! Por ndjeva një farë terrori kur u përballa me fytyrën e tij të butë dhe buzëqeshjen enigmatike!

**A mendoni se sfondi i arteve pamore ndikon në shkrimet tuaja? Dhe si ka qenë**

**marrëdhënia mes letërsisë dhe artit pamor?**

-Mendoj se jam formuar nga edukimi që piktura më ofroi. Këtu vjen dashuria ime për fragmentet. Piktura është një kompozim që e thyen kohën për të qëndruar e pastër në të tashmen. Kam probleme me kronologjinë, me rrjedhën e kohës, me procesin që kërkon rrëfimi. Më pëlqen të shpërbëhen kohët (e kaluara – e ardhmja) dhe kohët që përdor në narracionet e mia janë shpesh çështje emocionale, që nuk janë të shkruara në logjikën e kohës që përgjithësisht respektojmë – kohët e mia janë të gabuara.

**Nënat dhe etërit duken të mëdhenj në “Vendin ku askush nuk vdes kurrë”. Si është e mundur të rindërtohet familja (apo ideja e familjes) që ka përjetuar ose ka dëshmuar një lëkundje të tillë të themeleve – apo edhe rënien e konceptit tërësisht? Apo është ky një rindërtim i domosdoshëm apo edhe i dëshirueshëm? Marrëdhënia midis nënës dhe vajzës është veçanërisht prekëse në roman. A mund të na rrëfeni më shumë mënyrat se si kjo marrëdhënie qendrore ndikon në punën tënde si shkrimtare dhe artiste?**

-Unë tregoj historinë e një nëne dhe të fëmijës, të prekur nga “edukimi” i Nënës Parti që është në pushtet. Kjo Nëna Parti i ka burgosur bashkëshortin kësaj gruaje, e ai është gjithashtu babai i vajzës së vogël – karakteri në libër. Jeta e tyre ndryshon plotësisht. Ata e gjejnë veten në pjesën e marginalizuar të shoqërisë shqiptare, të dënuar nga ana tjetër, sepse janë të afërm të një të burgosuri politik. Marrëdhënia nënë-bijë i nënshtrohet kësaj drame. Nëna nuk është më në gjendje të jetë një nënë, ajo është në prag të çmendurisë.

Nëse është e dëshirueshme ose e nevojshme për të rindërtuar veten – unë mendoj se përgjigja ndaj kësaj është shumë subjektive. Figura e nënës është shumë e pranishme në shkrimet e mia. Shpesh pyes veten: A mund të jetë çdo grua një nënë? Një nënë ka fuqi të madhe mbi një fëmijë. Duke e dashur atë, tekta e do, ajo gjithashtu mund ta vrasë atë.

**Në kontekstin çek ose polak, për shembull, një mit i madh i jetës e kulturës disidente është shfaqur për të formësuar kujtesën kolektive të epokës komuniste. Si mendojnë shqiptarët në lidhje me të kaluarën komuniste në këtë pikë? A ka heronj? A ka katilë? Me fjalë të tjera, a ka një kujtesë kolektive, edhe nëse (thellësisht) problematike dhe/ose imagjinare?**

-Shqiptarët, për mendimin tim, nuk mendojnë se janë as heronj, as katilë. Është një popull që ka ruajtur një vetëdije për ashpërsinë dhe absurditetin e periudhës komuniste. Sot, ata po përpiqen të rimarrin veten në çdo aspekt. I gjej ende të pyesin veten e të punojnë. Shumë të pasur dhe shumë të varfër, nuk ka klasë të mesme, ende nuk është formësuar një e tillë.

Ka mjaft artistë, shkrimtarë dhe regjisorë shqiptarë që kanë punuar me përvojën e gjallë të këtij regjimi kundër njerëzimit.

(Ribotuar në “Gazeta Shqiptare”, marrë me shkurtime nga “epiphany”. Përshtati f.n)

Intervista e plotë:  
<http://epiphanyzine.com/features/2018/4/26/a-conversation-with-ornela-vorpsi-on-eroticism-sexual-abuse-and-harassment-and-selfhood>



## Fuqia e vëzhgimit dhe origjinaliteti i imagjinatës

Rudyard Kipling (Bombay sot Mumbai, 30 dhjetor 1865 - Londër, 18 janar 1936), shkrimtar anglez. Në fëmijëri e mësoi gjuhën hinduse, vazhdoi shkollën ushtarake në Devonshire, ndërsa më 1882, u kthye në Indi dhe punoi si gazetar. Udhëtoi në Japoni, Amerikë dhe në Afrikë të Jugut. Me një temë të njëjtë mori pjesë në jetën letrare dhe politike në Angli.


Proza e tij na tregon një pasqyrë të jashtëzakonshme të jetës indiane, dhe botës së ushtarëve britanik, e posaçërisht për botën e fëmijëve dhe të kafshëve. Librat më të rëndësishëm dhe më të lexuar të tij janë ato për xhunglën, që karakterizohet me njohuri të shkëlqyeshme të botës sekrete, të kafshëve në Indi.

Në vitin 1907 fitoi Çmimin Nobel për Letërsi, me motivacion: «Duke pasur parasysh fuqinë e vëzhgimit, origjinalitetin e imagjinatës, fuqinë e ideve dhe talentin e shquar për transmetimin të cilat karakterizojnë krijimet e këtij»

Kanë kaluar mbi 150 vjet nga lindja e Rudyard Kipling, shkrimtari dhe poeti i famshëm britanik prej të cilit kujtojmë, mes titujve më të famshëm që kanë bërë historinë e letërsisë, të paharrueshmin "Libri i xhunglës" dhe "Kapitenë guximtarë". Poezia e tij "Në mundsh" (e 1895-s) na tregon sugjerimet që Kipling si baba i drejton të birit në mënyrë që të bëhet "Burrë". Është ky një himn të mrekullueshëm për jetën, që Kipling i kushton të birit, ku të qenin burrë e përbëjnë vlerat, liria dhe vullneti për të konsideruar çdo hap të ekzistencës tonë si një ecje drejt diçkaje të re. Një reflektim marramendës në vargje që nga "fëmijë" na mëson të bëhemi burra.

Pesëdhjetë poezi të reja të poetit britanik Rudyard Kipling (1865-1936) janë zbuluar kohët e fundit. Dorëshkrimi i autorit të njohur të "Librit të xhunglës" është gjetur në arkivin e një ish-drejtuari të Cunard Line, e cila konsiderohet si kompania më e madhe e lundrimit në Britani. Dorëshkrimi ruhej në një shtëpi në Nju Jork. Mes poezive ka vargje për kohën e luftës së parë botërore, të cilën Kipling e mbështeti, duke ndihmuar të birin të futej në trupën e Irish Guards (rojat irlandeze).

"Njeriu i njëmijte" mbart të njëjtat nota solemne të miqësisë së vërtetë dhe mundimeve që dikush heq gjersa të gjejë "njeriun e njëmijte", mikun e zemrës që është i gatshëm të hidhet në ujëra të panjohur me dikë, që është i guximshëm mjaftueshëm për ta ndjekur "në trekëmbësh dhe më tej".



ROLAND KIJPLING

### NË MUNDESH...

Në mundesh të ruash arsyen  
Kur bota e humbet fillin  
E fajin ta hedhin, e vetes t'i besosh  
Sa here për ty dyshojne, e s'të përfillin  
Por dhe dyshimet drejtë t'i gjykosh.  
Në mundesh të rrih në pritje, nga pritja pa u lodhur  
E kur të urrejnë, urrejtje të mos ushqesh  
Madje ndaj shpifjeve të rrih pa folur  
Me thjeshtësi, me to pa rënë ndesh...  
Në mundesh të mendosh, por jo gjer në shkatërrim  
Të ëndërrosh, por jo si rob ëndërrimesh  
E të trajtosh njëlloj e pa dallim  
Ngadhënjim e shpartallim, burim mashtrimesh.  
Në durosh dot që thënie e tua të drejta  
Në kurthe për trutharet, kopuket do t'i kthejnë,  
Të thyejnë gjërat më të shtrenjta, e prapë t'i ndërtosh  
Me vegla pune që nuk vlejnë!  
Në mundesh, fitoret që korrur, t'i flijosh  
Si në kumar, në një të vetme lojë  
Të rrezikosh, të humbesh, e prapë te fillosh  
Dhe humbjet kurrë të mos i zesh me gojë!  
Në i detyrosh dot muskul, nerv, dhe puls e zemër  
Të të shërbejnë edhe kur gjithçka të duket e kotë  
E të qëndrosh, kur s'ka asgjë veç vullnetit,  
Që veç një fjalë, 'qëndro' gjithnjë të thotë.  
Në mundesh të flasësh me maskarenjtë  
Por nderin tënd ta ruash  
E të ecësh përkrah mbretit pa krenarinë që të verbon  
Nëse armiku ose miku s'të bëjnë dot të vuash  
Dhe gjithçka në e çmon, përveç sa e meriton.  
Në mundesh të mbushësh ti minutat,  
Aq të rënda, me vepra që peshojnë,  
Dije, dhe mos ki asnjë dyshim  
E jotja do jetë bota me ç'ka Brenda  
Dhe burrë do jesh, o biri im...

### NJERIU I NJËMIJTË

"Një njeri nga një mijë," tha Solomoni,  
Do të qëndrojnë më pranë se një vëlla.  
Dhe ia vlen që teksa kërkon për të gjysmën e ditëve të tua  
Ta gjesh përpara tjetrit.

Nëntëqindenëntëdhjetenëntë varen  
Nga ajo që bota sheh te ti,  
Por Njeriu i Njëmijte do të qëndrojë miku yt,  
Me gjithë botën që të është vënë kundër.  
Kjo as premtan, as lutet, as tregon,  
Por do t'i japë fund kërkimit ndër ta.  
Nëntëqindenëntëdhjetenëntë  
prej tyre largohen  
Prej pamjes tënde apo prej veprimeve apo prej lavdisë.  
Por vetëm njëri të gjen ty dhe ti gjen atë.  
Pjesa e mbetur e botës nuk ka rëndësi  
Për Njeriun e Njëmijte që mbytet apo noton  
Me ty në çdo ujë.  
Ti mund të përdorësh portofolin e tij pa e zgjatur,

Më pas ai mund të përdorë tëndin për shpenzimet e veta,  
Dhe të qeshë dhe të takojë në shëtitjet e përditshme,  
Si të mos ketë pasur kurrë hua mes jush.

Nëntëqindenëntëdhjetenëntë kërkojnë  
Argjend ose ar në marrëveshjet e tyre;  
Por Njeriu i Njëmijte, ai vlen sa për të gjitha ato,  
Sepse ti mund t'i shfaqësh atij ndjenjat e tua.  
Gabimi i tij është gabimi yt, dhe e drejta e tij është e drejta jote,  
Në kohën e duhur ose jo.  
Çohu dhe mbështete në sy të kujtdo,  
Për arsyet e tua!  
Nëntëqindenëntëdhjetenëntë s'mund të durojnë  
Turpin apo talljet apo të qeshurën,  
Por Njeriu i Njëmijte do të qëndrojë krah teje,  
Në trekëmbësh dhe më tej!  
Përktheu: Ivana Dervishi

### NËSE...

Nëse do t'arrish të mos hutohesh, kur të gjithë  
rreth teje hutohen, duke ta hedhur fajin ty;  
nëse do t'arrish të kesh besim te vetja, kur të gjithë dyshojnë te  
vetja,  
duke llogaritur edhe dyshimin e tyre;  
nëse ti do t'arrish të presësh pa u lodhur nga pritja,  
nëse ti i përgojuar, s'do të humbasësh kohë me përgojime,  
apo nëse i urryer, ti nuk do të merresh me urrejtje,  
pa kërkuar të dukesh shumë i mirë, apo tepër i urtë;  
nëse ti do t'arrish të ëndërrosh, pa e bërë ëndërrën padronen tënde;  
nëse ti do të arrish të mendosh, pa e bërë mendimin qëllim në  
vetvete.  
Nëse ti do t'arrish të përballesh me suksesin dhe dështimin  
duke i trajtuar këta dy mashtrues njëlloj,  
nëse ti do t'arrish të dëgjosh të vërtetën të deformuar  
nga mashtrues që duan të të fusin në kurth si një naiv,  
apo të shikosh të shemben gjërat për të cilat ti jep jetën  
dhe të kërrusësh shpinën për t'i mbledhur ato me mjete të  
përshtatshme;  
nëse do t'arrish të mbledhësh të gjitha fitimet e tua  
dhe t'i rrisësh ato vetëm duke hedhur një zar,  
të humbasësh dhe të fillosh përsëri, krejt nga fillimi  
pa marr frymë dhe të mos thuash asgjë për humbjet;  
nëse ti do t'arrish të shtrëngosh zemrën, nervat dhe muskujt,  
megjithëse i raskapitur për ca kohë, që t'u shërbeje qëllimeve  
të tua,  
dhe të mbahesh fort, kur asgjë s'mbetet më tek ty  
përveç vullnetit që të urdhëron: «mbahu fort!»;  
nëse do të arrish të flasësh me turmat duke ruajtur virtutet e  
tua,  
ose të shetisësh me Mbretin dhe të mos i humbësh marrëdhëniet  
e tua të zakonshme;  
nëse as armiqte apo miqtë e shtrenjtë s'do t'arrijnë të të godasin  
nëse të gjithë kanë rëndësi për ty, por askush tepër;  
nëse ti do t'arrish të përjetosh minutën e pamëshirshme  
dhe t'i japësh vlerë secilit nga të gjashtëdhjetë sekondave  
atëherë bota do të jetë jotja, me gjithçka që ajo përmban,  
dhe- ajo çka vlen më tepër, ti do të jesh Njeri, biri im!

Përktheu: Faslli Haliti



## “SHAKAJA”,

## MILAN KUNDERA



Një libër i bukur që të zhyt në mendime dhe në reflektime. Jeta e Ludvikut ndryshon nga një shaka, nga një kartolinë e shkruar për ti bërë përshtypje një vajze të cilën donte ta shtinte në dorë. Një shkrim aspak i tmerrshëm apo tendencioz dhe kundër regjimit por pas akuzave dhe analizimeve të bëra edhe vetë shkruesi fillon ta shohë si diçka të tmerrshme. Kjo shaka i kushtoi shumë, përjashtim nga partia, punë të mundimshme në minierë por mbi të gjitha tjetërsimin e personit dhe humbjen e besimit tek të tjerët. Ludviku dashurohet me Luçinë një dashuri e madhe që e bën të përfjetojë dëshirimin e zjarrtë dhe ngrohtësinë e puthjeve midis hekurave që ndanin botën nga "ushtarët e zinj" të minierës por që e humbet sepse nuk

arrin ta kuptojë. Një histori brilante, një njeri që ushqen mosbesim dhe ndjenja hakmarrjeje për çka u detyrua të kalojë...

Një libër për të mos u humbur, i cili ngjason me fatin e shumë njerëzve dhe intelektualëve në Shqipërinë komuniste.

Në një intervistë, Milan Kundera shprehej: "Fillova të shkruaja "Shakanë" rreth vitit 1961, pak a shumë i sigurt se do të publikohej. Gjatë viteve gjashtëdhjetë, shumë përpara Pranverës së Pragës, realizmi socialist dhe gjithë ideologjia zyrtare kishin marrë fund, ata ishin tashmë vetëm një lloj fasade që askush nuk e merrte më seriozisht. Pasi e mbarova në dhjetor 1965, dorëshkrimi mbeti për rreth një vit në zyrat e censurës që, në fund, nuk kërkoi asnjë ndryshim. Romani u


botua në pranverën e vitit 1967 dhe pati një sukses të menjëhershëm, tri botime me rreth 117 000 kopje tirazh. Në pranverën e vitit 1968 libri fitoi çmimin e Bashkimit të Shkrimtarëve Çekoslovakë. Romanin e përdora më vonë për një skenar për mikun tim Jaromil Jireš, i cili bëri një film që kurrë nuk më doli nga zemra.

Kritika letrare nuk u mor shumë me aspektin politik të librit, duke theksuar ndërkaq esencën e tij ekzistenciale (...). Pra, në fillim të udhëtimit tim si romancier, jam ndier i kuptuar në mënyrë të përkryer në atdheun tim. Por ishte një moment që zgjati vetëm pak. Një vit më vonë, në vitin 1968, pushtimi rus krijoi sërish një regjim stalinist të stërlashtë dhe shtypës nga pikëpamja intelek-

tuale. Ky ishte momenti kur "Shakaja" u zhduk nga libraritë dhe bibliotekat.

Gruaja ime shpesh më qesëndis: "Ti mbërrite në Paris si një fitimtar ndaj tankeve ruse". Në ato javë të shtatorit 1968, gazetata, në fakt, nuk flisnin për gjë tjetër përveçse për tanket ruse në Pragë dhe romani i një çeku tërhoqi automatikisht simpatinë e lexuesve dhe emrat e kritikëve të mëdhenj. Për të gjithë unë isha gati një ushtar në bordin e një tanku dhe të gjithë vlerësonin guximin me të cilin kisha luftuar kundër totalitarizmit. Por kur unë po shkruaja "Shakanë", nuk isha ndier kurrë veçanërisht trim. Sfidat ime nuk ishin politike, por ekskluzivisht estetike."

Botoi DITURIA, Tiranë



## “Kënga e qyqes”, Robert Galbraith

Robert Galbraith është pseudonim i J. K. Rowling, autore e serisë "Harry Potter" dhe e romanit "Rastësisht një vend bosh". Kur një modele me jetë të trazuar bie nga ballkoni i hotelit në rrugën Mejfër dhe gjen vdekjen, të gjithë mendojnë se ajo ka vrarë veten. Por vëllai i saj ka dyshimet e veta, ndaj pajton një hetues privat, Kormoran Strajkun, për të shqyrtuar rrethanat. Strajku është veteran i luftës - i plagosur fizikisht dhe psikologjikisht - dhe jeta e tij është një dramë. Rasti i jep atij një spirancë shpëtimi nga ana financiare, por me kosto personale: sa më shumë gërmon në botën e ndërlikuar të bukuroshes modele, aq më shumë errësohen gjërat - dhe sa më pranë i afrohet së vërtetës, aq më kërcënuet varet mbi të rreziku i tmerrshëm... Një sekret përshkënditës i botës elegante përshkon atmosferën e Londrës - nga rrugët e heshtura të Mejfërit në baret e Ist Endit e deri në Soho - Kënga e Qyqes është një libër i mrekullueshëm. Ky është romani i parë i serisë me dedektivin Kormoran Strajk, i JK Rowlingut, shkruar me pseudonimin Robert Galbraith.

### Komente mbi librin

"Kënga e Qyqes është një libër i madh? Përgjigjja është e thjeshtë. Po. Është i mahnitshëm." **Chicago Tribune**

"Një roman mjeshtror, një vepër arti e letërsisë së krimin." **Huffington Post**

"Një nga romanet më të mira të krimin që unë kam lexuar ndonjëherë." **Alex Gray**

"Robert Galbraith ka një pendë të mrekullueshme për të përshkruar Londrën dhe për të na bërë të dashur një hero të ri." **Daily Mail**

"Me një talent të rrallë, Galbraith kombinon një detektiv kompleks e imponues dhe një asistente barabar të mirëformuar dhe inteligjente në një krim enigmatik... Lexuesit mund të shpresojnë të shohin shumë më tepër nga ky ekip i paharrueshëm..." **Publishers Weekly**

"Një roman debutues brilant, i ambientuar në botën e pamëshirshme të stilistëve dhe modeleve." **The Times**

## “HIJA E ERËS”, CARLOS RUIZ ZAFON

Ndihem krenare sa herë e them me zë të lartë që unë e kam takuar shkrimarin Carlos Ruiz Zafon, i dyti më i lexuari në Spanjë, pas Miguel Servantesit, i përkthyer në më shumë se dyzet gjuhë të botës dhe ndër ta në shqip nga Shtëpia Botuese "Dituria". Në treg nuk gjenden shumë libra me emrin e tij, pasi ai ka botuar pak tituj, por ama kush i ka lexuar ato libra nuk i ka hequr kurrë nga kujtesa. Libri që kam zgjedhur sot për ndjekësit e mi në Gong News është "Hija e erës".

"Çdo libër ka një shpirt. Shpirtin e personit që e shkroi dhe të atij që e ka lexuar, që ka jetuar dhe ëndërruar me të. Çdo herë që një libër ndryshon lexues, sa herë dikush kalon sytë në faqet e tij, shpirti i librit rritet dhe forcohet."

Kjo është një nga thëniet e shumta të këtij librin që tregon mbi të gjitha mardhëniet e fuqishme të lexuesit me librin dhe mënyra sesi Zafon e përshkruan këtë mardhënie, e ka bërë çdokënd të lexojë veprat e tij të etur për të ditur më shumë. "Hija e erës" është vëllimi i parë i sagës me katër libra. Në shqip kanë ardhur tre prej tyre gjer tani dhe është në proces përkthimi "Labirinti i shpirtrave", që kurorëzon këtë histori.

Ngjarjet në këtë libër ndodhin në Barcelonë, vendit të tij të lindjes, por në intervistën që



kam zhvilluar me këtë shkrimtar, ai më ka rrëfyer që spuntun për këtë roman e ka marrë nga rrugët e Los Anxhelosit të mbushura me libra, që ngjanin si labirinte magjike, ku hyje për të mos dalë më kurrë. Për gjashtëmbëdhjetë vite me rradhë Zafon ka punuar për të krijuar

një rrjet magjik historik që marrin pikënisje në romanin "Hija e erës".

Historinë e këtij romani do e përmbledhja me të njëjtat fjalë që ka zgjedhur dhe Shtëpia Botuese "Dituria" për t'a prezantuar me lexuesin:

"Në Barcelonën e vitit 1945, një mungesë vjeshte, pronari i një dyqani librash të përdorur shoqëron djalin e tij njëmbëdhjetëvjeçar, Danielin, në Varrezën e Librave të Harruar, një vend i fshehtë ku mbulohej nga harresa mijëra vëllime, kujtimin e të cilëve e ka fshirë koha, dhe i kërkon Danielit të zgjedhë një libër, për të cilin do t'i duhet të kujdeset gjatë gjithë jetës. Hija e erës është libri që djali zgjedh, një libër "i magjepsur", por që do të shënojë, në të mirë e në të keq, pjesën tjetër të jetës së tij, duke e futur në një botë misteresh dhe intrigash, që lidhen me figurën e Hulian Karaksit, autorit të librit."

Ky roman dhe çdo vepër e Zafon duhet lexuar për të gjetur shpresën dhe ëndrrat e vrarë nga realiteti. Këto libra kanë fuqinë të zgjojnë magjinë tek ne dhe t'a shëndërrojnë atë në realitet.

Ashtu siç ka thënë dhe Zafon: "Librat janë pasqyra ku ne shohim se kush jemi ne në të vërtetë." (Flogerta Krypi)





## Kurti kërkon në zgjedhje sa më parë

Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka thënë që sa më parë, vendi do të duhet të shkojë në zgjedhje. Kurti, në mbledhjen e Këshillit të Përgjithshëm të këtij subjekti politik, deklaroi se Qeveria aktuale, duhet të humbë mbështetjen që e ka në Kuvendin e Kosovës. Ai ka folur për arrestimin e Marko Gjuriqit, që sipas tij, ishte spektakël dhe prodhoi vetëm reagimin e Listës Serbe që tha se do të veprojë njëanshëm për ta formuar Asociacionin e Komunave me shumicë serbe. "Dëshirojnë ta sjellin 'Zajednicën' në gusht kur Kuvendi është në pushim. Kurti ka përsëritur qëndrimin e Vetëvendosjes për dialogun me Serbinë, ku theksoi se ai nuk duhet të udhëhiqet nga presidenti Hashim Thaçi. "Ai në njërin anë i frikësohet shumë Gjykatës Speciale. Ai duke folur për largimet nga Vetëvendosje, ka thënë se partia e tij, mori një goditje të rëndë, por sipas Kurtit, VV-ja është një hap larg fitores dhe mund të vijë shumë shpejt në pushtet.



## Punoni për standardet

Ambasadorja e BE-së, Romana Vlahutin në një deklaratë për mediat nga qyteti i Shkodrës ku ajo mori pjesë në festën e luleve është pyetur nëse e meriton politika shqiptare Europën, por ajo u përgjigj shkurt duke thënë se populli shqiptar e meriton Europën. Vlahutin, u shpreh se shqiptarët janë evropianë, ajo që duam të bëjmë është që të sjellim standardet evropiane në Shqipëri. "Populli shqiptar e meriton Europën. Sepse bashkësia europiane nuk është bashkësi politikanësh, por bashkësi midis njerëzve. Ky është fillimi më i bukur i javës së Evropës këtu. Kam ardhur me një pjesë të ambasadorëve të vendeve anëtare, jam e lumtur. Shkodranët janë evropianë prej qindra shekujsh, shqiptarët janë evropianë, ajo që duam të bëjmë është që të sjellim standardet evropiane këtu", tha Vlahutin.

# TRUMPI T'I KTHEJË SYTË NGA BALLKANI



"Ka ardhur koha për të vepruar në Ballkanin Perëndimor", titullohet raporti që katër veteranë të diplomacisë amerikane prezantuan në Institutin Amerikan për Paqen, në Uashington

Titulli është alarmues. Edhe vendi është zgjedhur me qëllim. Institutin Amerikan i Paqes, USIP, ndodhet përballë Departamentit të Shtetit, pra është sikur t'u thuash zyrtarëve ulur në karriget e zyrave në anën tjetër të rrugës: hej, koha nuk pret sepse Ballkani Perëndimor është kthyer sërish në rajon me stanjacion dhe destabilitet për shkak të qeverisjes së dobët, ndikimeve nga jashtë dhe marrëdhënieve të tensionuara etnike e midis shteteve.

Raporti i shkruar për dy organizata amerikane të fokusuar në konfliktet ndërkombëtare, Institutin EastWest dhe Komitetin Nacional për Politikën e Jashtme amerikane,

thekson nevojën imediate që Amerika dhe Bashkimi Evropian të veprojnë për të penguar destabilizimin dhe shpërthimin e mundshëm të dhunës në Ballkan. Autorët Thomas Graham, Jonathan Levitsky, Cameron Munter, Frank G. Wisner mendojnë se SHBA dhe EU duhet të përmirësojnë strategjinë dhe të rigjallërojnë parteritetin.

### KOHA NUK PRET

Ambasadori Wisner është i shqetësuar për situatën në rajon. Progresi ka ngecur, në disa raste situata është përkeqësuar. Njerëzit duhet të tregojnë më shumë kujdes për situatën aktuale, sepse koha nuk pret. "Mënyra se si duhet vepruar me situatën në Ballkanin perëndimor njihet prej ne të gjithëve: integrimi gradual në NATO dhe BE".

Ky vit është i rëndësishëm për Ballkanin me takimet e nivelit të lartë të BE-së, të NATO-s. Vendeve duhet t'u ofrohet një rrugë e besueshme dhe e arritshme e anëtarësimit në institucionet transatlantike. "Kjo rrugë nuk shihet ende", thotë Wisner. BE-ja mbetet primare, roli i Amerikës është ai i katalizatorit. Ballkani është pjesë e Evropës dhe një Evropë e lirë dhe e plotë përmban edhe Ballkanin. Vendi që kërkon urgjentsisht më shumë vëmendje është

Bosnjë-Hercegovina. Dhe për Bosnjën u fol shumë. Po ashtu për Kosovën, ku u theksua nevojja e vazhdimit të dialogut Kosovë-Serbi, i cili duhet të përfundojë me njohjen e Kosovës nga Serbia. NATO duhet të ndihmojë Kosovën të ngrejë forcën e armatosur dhe KFOR duhet të qëndrojë në Kosovë. "Por, një bazë e përhershme e NATO-s ose SHBA-së në rajon do provokonte pa nevojë Serbinë dhe Rusinë", thuhet në raport.

### KËMBIM TERRITORESH KOSOVË - SERBI?

Nga salla u shtrua pyetja për idenë e këmbimit të territoreve Kosovë - Serbi. Ambasadori Wisner, pranon që kjo ide është hedhur prej presidentit serb. "Nuk kemi zgjidhje tjetër përveç se të japim përgjigje me kujdes. Ideja e këmbimit të territoreve është një ide, së cilës nuk i ka ardhur koha ende. Dhe unë nuk mendoj se do t'i vijë koha tani shpejt. Ka shumë çështje të tjera që duhen zgjidhur... Si për shembull Asociacioni i komunave serbe".

Për drejtorin e Institutit EastWest, Cameron Munter, "edhe marrëdhëniet ekonomike midis Kosovës dhe Serbisë luajnë një rol. Po ashtu krijimi i besimit social tek njerëzit". Shqipërinë nuk e përmendi askush në takim, as nga folësit, as nga publiku. Por

raporti sugjeron se formula për Shqipërinë është nxitja e reformave. "Kandidate që më 2014 për pranim në BE, Shqipëria ka pasur vështirësi në zbatimin e reformave për fillimin e negociatave. SHBA duhet ta inkurajojë Shqipërinë për të shfrytëzuar shansin e ofruar për hapjen e negociatave", thuhet në të.

### MAQEDONIA ME LAJMETË MIRA DHE JO TË MIRA

Për Maqedoninë prioritetet duhet të jetë pranimi në NATO dhe në BE. "Amerika duhet të shfrytëzojë ndikimin që ka në nivelet më të larta të Maqedonisë dhe Greqisë, për të theksuar rëndësinë e zgjidhjes së çështjes së emrit. Duke bërë bilancin e bisedimeve Maqedoni - Greqi ambasadori Wisner numëron lajmet e mira dhe ato jo të mira: "Sot, numri i çështjeve që duhet të zgjidhen midis Shkupit dhe qeverisë greke, është ulur shumë. Atmosfera e dialogut midis palëve është shumë e ngrohtë. Kryeministrat dhe ministrat e të dy vendeve merren vesh mirë. Ekziston mundësia që të gjendet zgjidhja. Por, duhen javë, për të mos thënë muajt të tërë deri sa palët të kenë pranuar një zgjidhje politike, e cila duhet zbatuar më pas". Plani që kanë diplomatët është ta bindin presidentin Trump se "Ballkani është i rëndësishëm".



# KOSTOJA E DEPRESIONIT NË EVROPË, MILIARDA DOLLARË



"Një punim i kryer në vitin 2013 tregon se kostoja e depresionit klinik është 113 miliardë dollarë në vit në Evropë. Mund të themi se edhe tani kostoja vjetore të paktën në këtë nivel", vë në dukje Young. Ai thekson se barnat përbëjnë nën 10 për qind të koston, krahas trajtimit të mjeku apo në spital

Kostoja që shkakton depresionin në Evropë arrin në 113 miliardë dollarë në vit, thotë profesor Allan Young, kryetari i Shoqatës Britanike të Psikofarmakologjisë. Young, i cili vizitoi qytetin turk Antalya për të marrë pjesë në Kongresin e Dhjetë Ndërkombëtarë të Psikofarmakologjisë dhe Simpoziumin e Gjashtë Ndërkombëtarë të Psikofarmakologjisë për Fëmijët dhe Adolehentët, për "AA" tha se kanë bërë një sërë gjetjesh nga punimet disavjetore që i kanë zhvilluar në lidhje me depresionin.

Sipas Young, gjasat që një njeri gjatë jetës së tij të vuajë nga ndonjë çrregullim mendor janë 25 për qind. "25 për qind është shkallë

shumë serioze dhe mund të themi se këto çrregullime janë mjaft të përhapura", thotë Young. Duke u bazuar në të dhënat e punimeve aktuale, Young thekson se depresioni është dy herë më i lartë te femrat në krahasim me meshkujt.

"Në këtë ndikojnë faktorë të ndryshëm. Në parim, mendohet se kjo buron nga shkaqe psikosociale. Nëse e mendojmë në nivel botëror, jeta e femrave është më e vështirë. Po ashtu, femrat mund të shprehen më qartë, pra janë më të sinqerta, në lidhje me simptomat. Po ashtu, këtu gjenden edhe faktorë biologjikë. Barnat kontraktive orale që përmbajnë hormonin estrogjen dhe progesteron që mer-

ren nga femrat, natyrisht kanë dobi për kontrollin e lindjes, por është vërejtur se ato mund të shkaktojnë depresion", tregon Young.

Duke folur për koston që shkakton depresionin, ai thotë se ky çrregullim bart me vete një barrë e cila vihet mbi shoqërinë. "Një punim i kryer në vitin 2013 tregon se kostoja e depresionit klinik është 113 miliardë dollarë në vit në Evropë. Mund të themi se edhe tani kostoja vjetore të paktën në këtë nivel", vë në dukje Young. Ai thekson se barnat përbëjnë nën 10 për qind të koston, krahas trajtimit të mjeku apo në spital. Sipas profesorit Young, personat që vuajnë nga depresioni nuk duhet ta fajësojnë veten, por

duhet të kërkojnë ndihmë sa më parë. Ai thotë se ka grupe me rrezik të lartë në këtë aspekt, andaj duhet kryer aktivitete për detektimin paraprak të personave që vuajnë nga depresioni në shoqëri sipas historisë familjare.

## Jerusalemi vendos shenjat rrugore të ambasadës amerikane

Të paktën tri shenja rrugore "Ambasada Amerikane" janë vendosur në Jerusalem më 7 maj, një javë para bartjes së misionit amerikan në këtë qytet, ka raportuar agjencia e lajmeve Reuters. Shenjat në gjuhën angleze, hebreje dhe arabe janë vendosur afër konsullatës amerikane, e cila nga

14 maji do të shërbejë si ndërtesë e ambasadës amerikane, pasi të zhvendoset nga Tel Avivi. Vendimi i presidentit amerikan, Donald Trump për të njohur Jerusalemin si kryeqytet të Izraelit dhe bartjen e ambasadës në këtë qytet është përballur me pakënaqësi në gjithë botën, duke përfshirë aleatët krye-

sorë në Evropë. Ky vendim është cilësuar si përpjekje amerikane për të dëmtuar paqen në mes të izraelitëve dhe palestinezëve. Bartja e ambasadës ishte planifikuar fillimisht të ndodhte në vitin 2019, mirëpo Izraeli ka shpejtuar procesin duke eliminuar pengesat burokratike.



Numri i palestinezëve të plagosur si pasojë e përdorimit të forcës joproportionale nga ushtria izraelite në protestat paqësore të mbajtura nga 30 marsi në kufirin e Gazës nën rrethim ka arritur në afro 8000

## 8000 palestinezë të plagosur



Numri i palestinezëve të plagosur si pasojë e përdorimit të forcës joproportionale nga ushtria izraelite në protestat paqësore të mbajtura nga 30 marsi në kufirin e Gazës nën rrethim ka arritur në afro 8000.

Zëdhënësi i Ministrisë së Shën-

detesisë së Palestinës, Eshref Kudra deklaroi se si pasojë e ndërhyrjeve të ushtrisë së Izraelit në protestat e "Marshimit të Kthimit të Madh", të organizuara në kufirin e Gazës, janë plagosur 7945 persona. Ai vuri në dukje se 100

nga të plagosurit janë stafi i ndihmës së parë që japin shërbime shëndetësore në protesta. Kudra thotë se ushtria izraelite ka sulmuar 25 ambulanca me plumba të vërtetë dhe gaz lotsjellës. Palestinezët, që nga dita e premte më 30

mars në kuadër të përvjetorit të 42-të të Ditës së Tokës filluan demonstratat e tyre paqësore nën emrin "Marshi i Kthimit të Madh" në kufirin e Rripit të Gazës që gjendet nën bllokadën e Izraelit. Ushtarët izraelitë janë duke hapur zjarr me plumba të vërtetë ndaj palestinezëve të cilët kërkojnë "kthimin në tokat nga të cilat janë dëbuar dhe heqjen e bllokadës së paligjshme ndaj Gazës që nga viti 2006". Në protesta deri më tani janë martirizuar 50 palestinezë, në mesin e të cilëve ka gazetarë dhe persona nën moshën 18 vjeçare ndërsa 8.000 të tjerë janë plagosur. Palestinezët planifikojnë që këto protesta të vazhdojnë deri më 15 maj.



## Air France para falimentimit

Ministri i Ekonomisë së Francës, Bruno Le Maire tha se nëse kompania ajrore kombëtare Air France nuk ndërmerr hapat e nevojshëm ballafaqohet me rrezikun e falimentimit. Le Maire i cili mori pjesë në një program në kanalën BFMTV theksoi seriozitetin e gjendjes në kompaninë ajrore kombëtare Air France, ku punëtorët e saj janë në grevë për 2.5 muaj me kërkesën për rritjen e pagave dhe përmirësimin të kushteve. "Nuk e kuptoj gjendjen aktuale, përderisa Air France ishte në rrugë të drejtë. Aktualisht problemi kryesor është mbijetesa e kompanisë e cila po ballafaqohet me rrezikun e falimentimit në qoftë se nuk i ndërmerr hapat e nevojshëm për konkurrencë", tha Le Maire. Duke u bërë thirrje pilotëve dhe punonjësve të kompanisë ajrore, Le Maire tha se "kompania është në rrezik" dhe se ata nuk duhet të kërkojnë më shumë se pagat e ofruara nga menaxhmenti. Ai paralajmëroi se mbijetesa e Air France është në rrezik dhe u bëri thirrje të gjithë punonjësve të veprojnë me përgjegjësi. Pilotët, punonjësit e kabinës dhe shërbimit në tokë të Air France të cilët janë anëtarë të 11 sindikatave vazhdojnë grevën e tyre për më shumë se 2 muaj me qëllim të përmirësimit të kushteve të punës dhe rritjes së pagave për 6 për qind. Kryeshefi ekzekutiv i Air France, Jean-Marc Janillac pas refuzimit të rritjes së pagës së propozuar nga kompania në një votim në mesin e punonjësve, ditë më parë njoftoi se ka dhënë dorëheqje. Menaxhmenti i kompanisë njoftoi se në çerekun e parë të vitit 2017 greva ka shkaktuar humbje prej 269 milionë euro në të ardhura. Duke bërë të ditur se greva ka ndikuar sidomos gjatë muajve prill dhe maj, parashikohet se humbja e shkaktuar si pasojë e grevës do të jetë "të paktën 300 milionë euro".



Në bazë të nenit 158 të Ligjit për mbrojtje shëndetësore (Fl. Zyrtare e RM me nr. 43/12, 145/12, 87/13, 39/14, 43/14, 10/15, 154/15, 192/15, 17/16 dhe 37/16) në bazë të pëlqimit të Ministrisë së Financave nr. 18-4666/2 të datës 30.04.2018, Vendimit për shpalljen publike me nr. 04-371/3 të datës 3.05.2018, nga U.D. Drejtori i IPSH Spitali i përgjithshëm "Dr. Ferid Murad" Gostivar më datë \_\_\_\_ publikon

### SHPLLJE PUBLIKE

Për punësim të punëtorëve shëndetësor për kohë të pacaktuar edhe atë:

1. IPSH Spitali i përgjithshëm "Ferid Murad" Gostivar publikon shpallje publike për punësim të punëtorëve shëndetësor për kohë të pacaktuar të punës në vendet e punës në vijim:

- mjek specialist të ORL I (një) realizues
- doktor të medicinës 9 (nëntë) realizues
- motra medicinale 10 (dhjetë) realizues.

2. Kandidatët duhet ti plotësojnë **kushtet e përgjithshme** të parapara sipas Ligjit për mbrojtje shëndetësore:

- të jetë shtetas i RM
- të jetë i rritur;
- të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore
- të mos i është kryer ndalesë e plotfuqishme për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose obligimit.

3. Krahas kushteve të përgjithshme të vërtetuara me Ligj nga pika 2, kandidatët për mjek specialist të ORL duhet ti plotësojnë **kushtet e veçanta** që vijojnë:

- të ketë kryer arsimin e lartë (VII/1) ose 240 kredi në bazë të EKTS-Fakulteti medicinal dhe specializim për ORL;
- të ketë dhënë provimin specialistik;
- licencë për punë si mjek specialist për ORL;
- vërtetim për njohje të një prej gjuhëve të huaja (angleze, gjermane ose frënge);
- me dhe pa përvojë pune.

Orari javor i punës është 40 orë. Neto pagesa fillestare për mjek specialist është 32.977 denarë.

4. Krahas kushteve të përgjithshme të vërtetuara me Ligj nga pika 2, kandidatët për doktor të medicinës duhet ti plotësojnë **kushtet e veçanta** që vijojnë:

- të ketë kryer arsimin e lartë (VII/1) ose 240 kredi në bazë të EKTS-Fakulteti medicinal;
- të ketë dhënë provimin profesional;
- licencë për punë;
- vërtetim për njohje të një prej gjuhëve të huaja (angleze, gjermane ose frënge);
- me dhe pa përvojë pune.

Orari javor i punës është 40 orë. Neto pagesa fillestare për doktor të medicinës është 25.969 denarë.

5. Krahas kushteve të përgjithshme të vërtetuara me Ligj nga pika 2, kandidatët për motra medicinale duhet ti plotësojnë **kushtet e veçanta** që vijojnë:

- Arsim të mesëm të mjekësisë - motër medicinale (PMP shkalla-IV);

- të ketë dhënë provimin profesional;

- me dhe pa përvojë pune;

Orar të plotë të punës – punë me ndërrime është 40 orë. Neto pagesa fillestare për motër medicinale është 16.441 denarë

6. Të bashkëngjitur me fletëparaqitjen kandidatët për **specialist të ORL** obligohen të parashtrijnë edhe dokumentet në vijim:

- fletëparaqitje me të dhëna për kontakt;
- biografi të shkurtër (CV);
- diplomë dhe certifikatë për fakultet të mbaruar të mjekësisë dhe specializim në drejtimin ORL me sukses mesatar, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter;

- nostrifikim të diplomës për kandidatët që kanë mbaruar jashtë vendit dhe ekuivalencë të notave, në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter;

- vërtetim për shtetësi të RM, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter;

- vërtetim mjekësor jo më të vjetër se 6 muaj, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter;

- vërtetim që nuk i është kryer ndalesë e plotfuqishme për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose obligimit, jo më të vjetër se 6 muaj origjinal ose kopje të vërtetuar në noter;

- licencë për punë si mjek specialist për ORL, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter;

- vërtetim për njohjen e një gjuhe të huaj (anglisht, gjermanisht ose frëngjisht) origjinal ose kopje të vërtetuar në noter;

7. Të bashkëngjitur me fletëparaqitjen kandidatët për **doktor të medicinës** obligohen të parashtrijnë edhe dokumentet në vijim:

- fletëparaqitje me të dhëna për kontakt;

- biografi të shkurtër (CV)

- diplomë dhe certifikatë për fakultet të mbaruar të mjekësisë me sukses mesatar, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter;

- nostrifikim të diplomës për kandidatët që kanë mbaruar jashtë vendit dhe ekuivalencë të notave, në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter;

- vërtetim për shtetësi të RM, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter;

- vërtetim mjekësor jo më të vjetër se 6 muaj, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter;

- vërtetim që nuk i është kryer ndalesë e plotfuqishme për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose obligimit, jo më të vjetër se 6 muaj origjinal ose kopje të vërtetuar në noter;

- vërtetim për provim të dhënë profesional origjinal ose kopje të vërtetuar në noter;

- licencë për punë si doktor të medicinës origjinal ose kopje të vërtetuar në noter;

- vërtetim për njohjen e një gjuhe të huaj (anglisht, gjermanisht ose frëngjisht) origjinal ose kopje të vërtetuar në noter;

8. Të bashkëngjitur me fletëparaqitjen kandidatët për **motra medicinale** obligohen të parashtrijnë edhe dokumentet në vijim

- fletëparaqitje me të dhëna për kontakt;

- biografi të shkurtër (CV);

- diplomë me sukses mesatar ose certifikatë/dëftesë për arsim të mbaruar për të gjitha vitet – drejtimi motër medicinale, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter;

- vërtetim për shtetësi të RM, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter;

- vërtetim mjekësor jo më të vjetër se 6 muaj, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter;


- vërtetim që nuk i është kryer ndalesë e plotfuqishme për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose obligimit, jo më të vjetër se 6 muaj origjinal ose kopje të vërtetuar në noter;

9. Afati për paraqitje të shpalljes publike është 5 (pesë) ditë pune nga dita e shpalljes.


10. Dokumentacioni i dorëzuar jo në kohë, i pakompletuar dhe i parregullt nuk do të jetë lëndë për shqyrtim nga ana e Komisionit për selektim të kandidatëve.

11. Paraqitja e dokumentacionit të nevojshëm si dhe numri i telefonit për kontakt, të dorëzohen të IPSH Spitali i përgjithshëm "Dr. Ferid Murad" Gostivar, adresa: Major Çede Filiposki 29- Gostivar, me postë ose në Arkivin pranë IPSH Spitali i përgjithshëm "Dr. Ferid Murad" Gostivar me shenjë për shpallje publike për punësim.

IPSH SPITALI I PËRGJITHSHËM  
"Dr. Ferid Murad"  
GOSTIVAR,



Republika e Maqedonisë  
Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit  
Hapësinor



MKC EN ISO 9001:2009

**Ministria e mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor e Republikës së Maqedonisë**

**SHPLL**

**Projekt A - leje e integruar ekologjike për DPTU Buçim DOO – Radovish, Instalacioni për brejtjen e xeheve të bakrit dhe përfitimi i bakrit katodik.**

**Rr.Sv.Spaso Radovishki p.n, 2420 Radovish**

Në përputhje me nenin 95 pika 1 të Ligjit për mjedisin jetësor (Gazeta zyrtare e RM 53/05, 81/05, 24/07, 159/08, 83/09, 48/10, 124/10, 51/11, 123/12, 93/13, 187/13, 42/14, 44/15, 129/15, 192/15 dhe 39/16), deri te Ministria e mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor është dorëzuar kërkesë nr.11-12603/1 nga 31.12. 2013 për marrjen e A - lejes të integruar ekologjike.

**Kategoria e instalacionit:**  
Instalacioni sipas Rregullores për përcaktimin e aktiviteteve të instalacioneve, bjen nën aktivitetet nga Shtojca I Pika:2

2. Prodhimi dhe përpunimi i metaleve

2.5 a) Instalacione për prodhimin e metaleve me ngjyrë nga xehet, koncentratet ose lëndët e para minerale me procese metalurgjike, kimike ose me procese elektrolitike. Kapaciteti i projektuar: 2800 t/vit

Drejtoria mjedisit jetësor pranë MMJPH përgatiti,  
**Projekt A- Leje të integruar ekologjike për DPTU Buçim DOO – Radovish, Instalacioni për brejtjen e xeheve të bakrit dhe përfitimi i bakrit katodik.**

Projekt Leja do jetë e shpallur , në Ueb faqen zyrtare të Ministrisë së mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor [www.moep.gov.mk](http://www.moep.gov.mk)

Informacione në lidhje me Projekt Lejen, të interesuarit do të mundet të marrin në Ministrinë e Mjedisit jetësor dhe planifikimit Hapësinor në tel: 076 445 942 (e-mail: [n.aliti@moep.gov.mk](mailto:n.aliti@moep.gov.mk)).

Të interesuarit, në **afat prej 14 ditëve** nga dita e shpalljes në mjetet e informimit, do të mundet ti dërgojnë vërejtjet e tyre në lidhje me Projekt Lejen, në formë të shkruar, deri te Ministria e Mjedisit jetësor dhe planifikimit Hapësinor në këtë adresë: Bulevardi "Goce Delçev" nr. 18 ( ndërtesa e MTV kati 10 ), 1000 Shkup.

Republika e Maqedonisë  
Ministria e Mjedisit  
Jetësor dhe Planifikimit  
Hapësinor

Bul. "Goce Delçev" nr. 18,  
1000 Shkup,  
Republika e Maqedonisë  
Tel. (02) 3251 400  
Faks. (02) 3220 165  
E-mail:  
[infoeko@moep.gov.mk](mailto:infoeko@moep.gov.mk)  
Sajt: [www.moep.gov.mk](http://www.moep.gov.mk)



KOMUNA E  
ČAIRIT

ОПШТИНА  
ЧАИР

**KRYETARI I KOMUNËS -**  
Bul. Hristijan T. Karposh Nr. 5 | Tel: 02/2616-860 | faks: 02/2616-867  
info@cair.gov.mk | www.cair.gov.mk

Nr. \_\_\_\_\_ prej \_\_\_\_\_

Në bazë të nenit 35 paragrafi 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7 dhe 8 të Ligjit për planifikim hapësinor dhe urbanistik ("Gz. Zyrtare e RM" nr. 199/14, 44/15, 193/15, 31/16 dhe 163/16) Komuna e Čairit miratoi:

**KUMTESË**

Njoftohen qytetarët, personat juridik nga hapësira e përfshirë me **Propozim – PDU për kuart qyteti SSI 04 Blloku 08, komuna e Čairit – Shkup**, administrata shtetërore, organizata shkencore dhe profesionale, komuna e Čairit – Shkup organizon:

**PREZANTIMI PUBLIK DHE ANKETA PUBLIKE**

Ndaj **Propozim – PDU për kuart qyteti SSI 04 Blloku 08, komuna e Čairit – Shkup**, i cili përfshin hapësirë prej **14,86 ha**, me këto kufij:

- Në veri kufiri fillon për boshtin e rrugës ndihmëse të posa planifikuar C6 – Rruga Vukovarska.
- Në lindje kufiri fillon për boshtin e rrugës ndihmëse të posa planifikuar C8 – Rruga Kemal Sejfulla, deri te pika e kryqëzimit të hendekut rrugor prej D 75.
- Në jug kufiri fillon për boshtin e rrugës së posa planifikuar anësore Xhon Kenedi prej C4, deri te pikat e kryqëzimit të hendekut rrugor prej D 75 deri te rruga ndihmëse e re e planifikuar C5 – Rruga Dizhonska.
- Në jug kufiri fillon për boshtin e rrugës së posa planifikuar anësore rruga C5 – Rruga Dizhonska - 1, prej boshtit të pikës thyese me rrugën ndihmëse të posa planifikuar C4, deri te pika e kryqëzimit të rrugës ndihmëse të posa planifikuar C6 – Rruga Vukovarska.

Në kufijtë e përfshirjes të PDU planifikohen këto dedikime:

**A – Banim**  
A1 – Banim në shtëpi banimi  
A2 – Banim në ndërtesë banimi

**B – Dedikime komerciale dhe afariste**  
B2 – Njësi të mëdha tregtare

**C – Institucione publike**  
C1 – Arsim dhe shkencë  
C2 – Mbrojtje shëndetësore dhe sociale  
C4 – Institucione shtetërore

**D – Infrastruktura**  
E1 – Infrastruktura komunale (rrjeti rrugor primar dhe sekondar)  
E2 – Infrastruktura komunale (garazhe në kate dhe trafostacion)

**Propozim – PDU për kuart qyteti SSI 04 Blloku 08, komuna e Čairit – Shkup**, do të ekspozohet në hapësirat e Komunës së Čairit, në afat prej dhjetë (10) ditë pune (nga data 10.05.2018 deri më 23.05.2018), secilin ditë pune prej ora 8,30 deri më 16.30.

**Prezantimi publik i Propozim – PDU për kuart qyteti SSI 04 Blloku 08, komuna e Čairit – Shkup**, do të mbahet me datë **14.05.2018** me fillim në ora 09.30 në hapësirat e Komunës së Čairit – Shkup, zyra nr. 8. Fletët anketuese për pjesëmarrje në anketën publike gjenden në hapësirat e Komunës së Čairit, zyra nr. 8.

Në afatin e përcaktuar personat e interesuar fizik dhe juridik, administrata shtetërore, organizatat shkencore dhe profesionale munden të dorëzojnë vërejtjet dhe propozime ndaj propozim planit, në formë elektronike nëpërmjet sistemit informativ e –urbanizëm ose në formë me shkrim.

përpiloi : T.S..  
miratoi: Xh.H.

Kryetar i Komunës së Čairit  
Visar Ganiu



FUNDI I SEZONIT NË LPFM-SË PO BËHET MË INTERESANT

# "LUFTË" E ASHPËR PËR EVROPË


Në përjashtim të FC Shkupi, e cila deri në fund do të zhvillojë edhe katër xhiro, Sileksi, Rabotnički, Akademia Pandevi dhe Renova, që bashkë me Shkupin konkurrojnë për një vend në Evropë, do të zhvillojnë edhe tre xhiro. Mes këtyre skuadrave po zhvillohet një "luftë" e madhe për pozitën e tretë dhe të katërt dhe deri në fund nuk dihet se çfarë do të ndodh

Koha

Bujar KURTAJ

Shkup, 7 maj - Skuadra e Shkëndijës javën e kaluar e ka kaluar me sukses edhe Kratovën ku mund 3:1 Sileksin. Kuqezinjtë kështu koleksionuan fitoren e 26-të sezonale, duke shkuar kështu në kuotën e 82 pikëve, 29 pikë më shumë se Vardari i vendit të dytë, ndërsa prekin shifrën e 91 golave të shënuar në 33 ndeshje të këtij sezoni. Janë këto dy skuadrat që prej moti kanë mësuar fatin e tyre. Shkëndija është kampion i ri, kurse Vardari nuk rrezikohet në pozitën e dytë dhe në sezonin tjetër sigurt do të jetë pjesë e kualifikimeve në Liga Evropë. Ndryshe, deri në fund, vëmendja do të përqendrohet tek skuadrat që po garojnë për pozitën e tretë dhe të katërt që qojnë në Liga Evropë si dhe për mbijetesë.

FC Shkupi nuk ka shkuar përtej barazimit në përballjen me "Skopjen". Deri në minutën e 89-të djemtë e trajnerit Zekirja Ramadani kanë pasur epërsi me 0-1, por Petkovski me një gol të bukur, mposhti Zendelin dhe barazoi sh-



frat në 1-1. Një rezultat që nuk u konvenon aspak bardhekaltërve, të cilët tani e shohin vetën në vendin e shtatë me 39-të pikë, shtatë më shumë se "Skopje", por ka një ndeshje më pak, atë me Pelisterin të cilën do ta luajë nesër (e mërkurë) në Çair. Ky barazim ka larguar edhe më shumë FC Shkupin nga pozita e katërt, e cila qon në Liga Evropë, ndërsa epërsia mes tyre dhe Rabotniçkit tani është gjashtë pikë. Deri në fund bardhekaltërit do të zhvillojnë edhe katër xhiro, ku në lojë janë 12-të pikë, derisa brenda dhe jashtë do të përballen me Pelisterin, Renovën e pret në Çair dhe në fund përsëri para tifozëve të saj do të pret Vardarin. Gjithçka është e hapur, por ajo që duhet ta bëjnë futbollistët e Shkupit, është që ti fi-

tojnë të gjitha ndeshjet dhe më pas të shohin se çfarë do të bëjnë konkurrentët e tyre për pozitën e katërt, Rabotnički, Akademia Pandevi dhe Renova. Ndryshe, këta të fundit deri në fund do të zhvillojnë edhe tre xhiro, ndërsa pas barazimit 1-1 me Vardarin, aktualisht gjenden në vendin e gjashtë me 41 pikë. Mirëpo, skuadra tetovare ka orar më të rëndë, pasi të dielën do të jenë mysafir i FC Shkupit, pastaj në xhiron e parafundit do të luajnë me rivalin e saj lokal Shkëndijën, ndërsa në fund do të përballen si mysafir me Pobodën, një përballje mjaftë e vështirë pasi skuadra nga Prilepi po lufton për mbijetesë. Duke i marr parasysh renditjen tabelore, nuk duhet anashkuar as skuadrën e Akademia Pandevit, skuadër kjo e cila aktua-

lisht gjendet në vendin e pestë me 42 pikë, katër pikë më pak se pozita e tretë e cila i takon Sileksit dhe tre më pak se Rabotnički në vendin e katërt. Në xhiron e ardhshme, Akademia P. do të pret Rabotniçkin, një rival i drejtpërdrejtë për pozitën e katërt, më pas do të luajë si mysafir ndaj Vardarit, ndërsa në xhiron e fundit do të presin Sileksin, gjithashtu një rival për të dalë në Evropë. Sa i përket mbijetesës, "luftë" e madhe po zhvillohet mes tre skuadrave, "Skopjes", Pobodës dhe Pelisterit. Skuadra shkupjane gjendet në pozitën e tetë me 32 pikë, aq sa ka edhe Pobeda, ndërsa me një pikë më pak, Pelisteri gjendet në pozitën e fundit. Cekim, një rang më të ulët shkojnë dy ekipet e fundit, kurse pozita e tetë luan në balotazh për mbijetesë.



## Tri skuadra gjermane pas Shaqirit

Xherdan Shaqiri ka rënë nga elita e futbollit anglez me skuadrën e tij Stok Siti. Ylli nga Kosova do të largohet nga klubi i njohur anglez pas rënies në Çampionship. Shaqiri ka një klauzolë largimi nga Stok prej 14,5 milionë euro. Por për gjilanasin mund të ketë një rikthim në kampionatin gjerman Bundesliga. Borussia Dortmund mbetet skuadra favorite në Gjermani për transferimin e Xherdanit. Por së fundmi në garë është futur fuqishëm edhe finalisti i Kupës së Gjermanisë, A인트raht Frankfurt. Sipas mediave gjermane, Frankfurt është gati të paguaj klauzolën prej 14,5 milionë euro për transferimin e Xherdanit. Klubi gjerman po tenton ta bind tani gjilanasin për rikthim në Bundesliga. Gjithsesi në Gjermani, Shaqiri mbetet objektiv edhe i skuadrës së Hofenhaim. Ndërkohë në Angli, 26-vjeçari po kërkohet nga Everton, Southampton, Njukasëll dhe Hadersfeld.

## Muriqi, kampion në Ligën e Parë turke me Rizesporin



Një trofe i rëndësishëm në karrierën e Vedat Muriqit. Futbollisti i përfaqësueses së Kosovës ka festuar triumfin e skuadrës së tij Rizespor

në Ligën e Parë turke. Ekipi nga verilindja e Turqisë e kishte siguruar vendin e parë që javën e shkuar, megjithatë festa e ligjshme u orga-

nizua pas ndeshjes së fundit, që të ashtuquajturit "Skifterat e Detit të Zi" zhvilluan në "Yeni Rize Stad" kundër Gazishehir Gaziantep, duke fituar me shifrat 4-2. Muriqi ka qenë një nga lojtarët kryesorë për skuadrën e drejtuar nga Ibrahim Yzmylez. 24-vjeçari iu bashkua Rizesporit në muajin janar nga Gençlerbirliği. Sulmuesi ishte pikë referimi në majtë e repartit të avancuar dhe u aktivizua si titullar thajse në të gjitha sfidat duke shënuar 8 gola. Ish-lojtari i Teutës dhe Besës së Kavajës rikthehet menjëherë të luajë në Superligën turke, kësaj radhe me ngjyrat e Rizespor, klub me të cilin nënshkroi për dy vite e gjysmë në muajin janar.

Në 4 vite në Turqi shtatlarti ka gjetur rrugën e rrjetës në 41 raste mes Superligës, Ligës së parë dhe Kupës së vendit euro-aziatik.

## Demiri për të tretën herë në ekipin e javës

Shkup, 7 maj - Mbrojtësi i krahut të majtë Besir Demiri, për herë të tretë në kampionatin ukrainas po i siguron vetes një vend në ekipin ideal të javës. Portali prestigjioz ukrainas "footboom.com", ka bërë përzgjedhjen e ekipit ideal të javës së 30-të, ashtu që Demiri ka zënë vendin e mbrojtësit të majtë. Këta shkruajnë se futbollisti nga Maqedonia, në përballjen me Dinamo Kievin, e cila u mbyll me barazimin 1:1, ka pasur një kontribut shumë të madh që vendasit nuk ia dolën të shënojnë më shumë se një gol. Raportohet se Demiri, nuk ka lejuar kundërshtarët të kalojnë në krahun e majtë. Sipas "footboom.com", Demiri jo rrallë herë i ka dalë në ndihmë edhe sulmit të skuadrës së tij Mariupol dhe ndeshjen e mbylli pa gabime.





Në bazë të nenit 89-a paragrafi 1 alineja 5 e Ligjit për arsim të mesëm (Gazeta Zyrtare e RM nr. 44/95, 24/96, 34/96, 35/97, 82/99, 29/02, 40/03, 67/04, 55/05, 113/05, 35/06, 30/07, 49/07, 81/08, 92/08, 33/10, 116/10, 156/10, 18/11, 51/11, 6/12, 100/12, 24/13, 41/14, 116/14, 10/15, 98/15, 145/15, 30/16, 127/16, 67/17), nenit 90 alineja 6 e Statutit të shkollës, Vendimit për publikim të shpalljes për zgjedhje të drejtorit nga Kryetari i Qytetit të Shkupit nr. 08-3512/1 të datës 23.04.2018, Vendimit për publikim të shpalljes publike për zgjedhje të drejtorit të shkollës të sjellë nga Këshilli i shkollës më datë 02.05.2018 me numër veprimi 02-397/3 Këshilli i shkollës së SHMQSH "Cvetan Dimov" – Shkup publikon

**SHPALLJE PUBLIKE**  
Për zgjedhje të drejtorit të shkollës

Kandidatët për drejtor krahas kushteve të përgjithshme të parapara me Ligj, duhet të përmbushin edhe kushtet në vijim:

- të kenë arsim sipëror;
- ti plotësojnë kushtet për mësimdhënës, pedagog ose psikolog në shkollë të mesme;
- në momentin e zgjedhjes me vendim të plotfuqishëm të mos i jetë shqiptuar sanksion për kundërvajtje – ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
- të kenë aftësi të përgjithshme shëndetësore;
- të kenë minimum 5 (pesë) vjet përvojë pune në punë edukativo-arsimore në institucion të verifikuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës;
- të jenë shtetas të Republikës së Maqedonisë;
- të kenë të dhënë provimin për drejtor të shkollës;
- të kenë të dhënë test psikologjik dhe testin për integritet;
- të mos jenë të gjykuar

-njohe të gjuhës angleze, jo më të vjetër se pesë vjet TOEFL IBT – së paku 30m pikë, IELTS – së paku 3 pikë, BULATS – së paku 20 pikë ose KET (Cambridge English).

Kandidatët për drejtor duhet të dorëzojnë dokumentet në vijim:

- fletëparaqitje në lidhje me shpalljen publike me biografi të shkurtër (CV) dhe letër motivimi;
- Program për punë të Drejtorit të shkollës prej vitit 2018 deri në vitin 2022;
- diplomë/certifikatë për arsim sipëror të mbaruar;
- dëshmi se kundër kandidatit nuk i është shqiptuar sanksion për kundërvajtje – ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës të dhënë nga organi kompetent (dëshminë të cilën do ta parashtrojë kandidati të jetë e dhënë nga organi kompetent ne kohëzgjatje derisa të zgjasë shpallja publike);
- vërtetim për përvojën e punës në punë edukativo-arsimore të dhënë nga institucione dhe të verifikuar nga Ministria e Arsimit dhe shkencës për kryerje të punës edukativo-arsimore;
- certifikatë të shtetësisë së Republikës së Maqedonisë;
- certifikatë për provim të dhënë për drejtor të shkollës;
- dëshmi se kandidati ka dhënë test psikologjik dhe test për integritet;
- dëshmi se kundër kandidatit nuk ka aktakuzë që është futur në fuqi juridike të dhënë nga Gjykata themelore në vendin e lindjes (dëshmi të mos jetë më e vjetër se 6 (gjashtë) muaj.
- dëshmi se kandidatët për drejtor janë në gjendje të përgjithshme shëndetësore (certifikatë të mjekut) pas zgjedhjes do ta parashtrojë vetëm kandidati i zgjedhur, i cili do të dërgohet në kontroll mjekësor në llogari të punëdhënësit, në pajtim me nenin 25, paragrafi (7) i Ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 167 / 2015).
- dëshmi për njohje të gjuhës angleze, jo më të vjetër se pesë vjet TOEFL IBT – së paku 30m pikë, IELTS – së paku 3 pikë, BULATS – së paku 20 pikë ose KET (Cambridge English).

Afati për parashtrimin e dokumenteve, i caktuar në nenin 96 të Statutit të shkollës është 8 (tetë) ditë fillimi i ditës së ardhshme të ditës së publikimit.

Me kandidatët të cilët përmbushin kushtet do të realizohet intervistë për çka do të informohen enkas.

5. Vendi i punës drejtor i shkollës është vend i punës me autorizime të posaçme. Mandati i drejtorit të zgjedhur do të jetë 4 (katër) ditë, duke konsideruar nga dita e emërimit.

Neto pagesa mujore fillestare parashihet në pajtim me matjet dhe kriteret e caktuara në Marrëveshjen kolektive për arsim të mesëm sipas koeficientit të kompleksitetit 3.422 dhe neto shumë prej 28.814,00 denarë + shtesë të punës së kaluar në shumë prej 0,5% për secilin vit stazh të punës, të shpërndarë në 5(pesë) ditë pune me 40 (dyzet) orë pune në javë me orar ditor të punës prej ora 08:30 deri në ora 16:30.

Zgjedhja do të realizohet në afatet e parapara në pajtim me nenin 92-a të Ligjit për arsim të mesëm ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 44/95, 24/96, 35/97, 82/99, 29/02, 40/03, 42/03, 67/04, 55/05, 113/05, 35/06, 30/07, 49/07, 81/08, 92/08, 33/10, 116/10, 156/10, 18/11, 51/11, 6/12, 100/12, 24/13, 41/14, 116/14, 10/15, 98/15, 145/15, 30/16, 127/16, 67/17), ndërsa më së voni në afat prej 60 (gjashtëdhjetë) ditë.

Dokumentet e nevojshme, në zarf të mbyllur në formë origjinale ose kopje të vërtetuara në noter, parashtrohen deri në Shkollën e mesme të Qytetit të Shkupit "Cvetan Dimov" – Shkup, rr. "Xhon Kenedi" nr. 16, Komuna e Çairit, 1000 Shkup me shenjë deri te Këshilli i shkollës – "Komisioni për shqyrtimin e dokumenteve në lidhje me shpalljen publike për zgjedhje të drejtorit të shkollës" përmes postës ose postës së shpejtë ose në arkivin e shkollës.

Dokumentet e pakompletuara dhe të parashtuara pas afatit do të refuzohen dhe nuk do të shqyrtohen nga ana e Komisionit. Kontakt personi në lidhje me shpalljen publike është Sekretarja e shkollës – Blerta Veliu me kontakt telefonin 02/2611-530 dhe kontakt e-mail adresë [sucvetandimov@yahoo.com](mailto:sucvetandimov@yahoo.com)

Kryetari i Këshillit të shkollës së SHMQSH "Cvetan Dimov" – Shkup  
Ajten Ajdini Kadriu

Në bazë të nenit 17 të rregullores për realizim të ekskursioneve për nxënësit dhe aktivitetet tjera të lira për nxënësit e shkollave fillore SHF "Goce Dellçev" – Manastir publikon

**SHPALLJE PUBLIKE**

Për pranimin e ofertave për realizim të ekskursioneve

1. Ekskursion dyditor me nxënësit e klasës së IX në relacionin: Manastir – Kavadar – Dojran – Strumicë (bujtje), Shkup – Manastir.
2. Ekskursion dyditor me nxënësit e klasës së VI në relacionin: Manastir – Strugë – Dibër – Mavrovë (bujtje), Kërçovë – Manastir.
3. Ekskursion njëditor me nxënësit e klasës së III në relacionin: Manastir – Ohër – Strugë – Vevçan.

Kriteri për lidhjen e marrëveshjes është çmimi më i ulët. Shkolla si ofertues më të volitshëm do të zgjedhë ofertuesin i cili përmbushë kriteret minimale në vijim:

- të jetë i regjistruar në pajtim me dispozitat pozitive në R. M për kryerje të veprimtarisë përkatëse turistike;
  - të ketë të realizuara në mënyrë të suksesshme së paku tri ekskursione për nxënësit dhe aktivitetet tjera të lira në tri vitet e fundit;
  - të përmbushë kushtet për transport të grupeve të fëmijëve, në pajtim me Ligjin për siguri në komunikacion rrugor dhe Rregulloren për kërkesat e posaçme teknike të makinave;
  - Afati për grumbullimin e ofertave është 5 ditë pune nga dita e publikimit;
- Ofertat të parashtrohen deri te Komisioni për grumbullimin e ofertave në SHF "Goce Dellçev" Manastir, rr. "Vienska" nr. 13.

SHF "Goce Dellçev" Manastir

<p style="text-align: center;">REPUBLIKA E MAQEDONISË UNIVERSITETI "Shën.KIRILI DHE METODI" - SHKUP FAKULTETI PËR MJEKËSI VETERINARE SHKUP</p>		<p style="text-align: center;">REPUBLIC OF MACEDONIA UNIVERSITY "Ss. CYRIL AND METHODIUS" SKOPJE FACULTY OF VETERINARY MEDICINE SKOPJE</p>
--	---	--

Në bazë të nenit 135 paragrafi 1 të Ligjit për arsim sipëror (Gazeta Zyrtare e RM nr. 35/08, 103/08, 26/09, 99/09, 115/10, 17/11, 51/11, 123/12, 15/13, 24/13, 57/13, 41/14, 116/14, 130/10/2015, 20/2015, 154/15, 30/16, 120/16, 127/16), nenit 34 paragrafi 2 të Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistentë – doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup – teksti i pastruar (Lajmëtarit universitar nr. 274 të datës 31 dhjetor 2013) dhe nenit 48 të Rregullores për marrëdhëniet e brendshme dhe punën e Fakultetit të mjekësisë veterinarë në Shkup në përbërje të UKIM – teksti i pastruar (Lajmëtarit universitar nr. 361 të datës 3 prill 2017), Dekani i Fakultetit për mjekësi veterinarë në Shkup shpall

**KONKURS**

Për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor

1. Një mësimdhënës në të gjitha titujt mësimor-shkencor në sferën mësimore-shkencore 40713 – Sëmundjet e shpendëve;

Kushtet: Krahas kushteve të përgjithshme kandidatët duhet të plotësojnë edhe kushtet e posaçme të parapara me Ligjin për arsim sipëror, Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistentë – doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup dhe aktet e Fakultetit për mjekësi veterinarë në Shkup.

Së bashku me fletëparaqitjen duhet të dorëzohen edhe dokumentet në vijim: biografi e shkurtër, dëshmi për plotësimin e kushteve të përgjithshme dhe posaçme, certifikatë të shtetësisë, listë të punimeve shkencore dhe profesionale dhe nga një kopje për secilin punim. Dëshmitë për plotësimin e kushteve të përgjithshme dhe të posaçme dorëzohen në origjinal ose kopje të vërtetuara në noter.

Zgjedhja e kandidatëve bëhet në pajtim me Ligjin për arsim sipëror dhe Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistentë – doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup.

Orari i punës së mësimdhënësit është i caktuar në pajtim me aktet e Fakultetit.

Konkursi zgjatet 8 ditë nga dita e publikimit.

Dokumentet të dorëzohen në ndërtesën e Fakultetit për mjekësi veterinarë në Shkup, rr. "Lazar Pop Trajkov" nr. 5-7, tel. 02 3240 700.

Dokumentet e pakompletuara dhe dokumentet e dorëzuara pas afatit nuk do të merren në procedurë të shqyrtimit.

Në bazë të nenit 156, 157, 158, 159 dhe 160 të Ligjit për mbrojtje shëndetësore (Gazeta Zyrtare e RM nr. 43/12, 145/12, 87/13, 164/13, 39/14, 43/14, 132/14, 188/14, 10/15, 61/15, 154/15, 192/15, 17/16 dhe 37/16), Pëlqimi për punësim nga Ministria e financave të RM nr. 18-4758/2 nga data 27.04.2018, Vendimit për publikim të shpalljes nr. 0401/1059/1 nga data 03.05.2018,u.d. Drejtori i Institutit, publikon

**SHPALLJE**

**për punësimin e 1 (një) personi në vendin e punës doktor medicine, specialist internist për kohë të pacaktuar dhe 1 (një) personi në vendin e punës doktor medicine, specialist pediatër për kohë të pacaktuar.**

1. IPSSH Instituti për sëmundje të mushkërive tek fëmijët Kozle, Shkup ka nevojë për punësimin e 1 (një) personi në vendin e punës doktor medicine, specialist internist për kohë të pacaktuar dhe 1 (një) personi në vendin e punës doktor medicine, specialist pediatër për kohë të pacaktuar.
2. Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet e përgjithshme të parapara me Ligj:
  - Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë
  - Të jetë i moshës së rritur;
  - Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore
  - Të mos i jetë shqiptuar me vendim të plotfuqishëm ndalesë për realizim të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.
3. Përpos me ligj të vërtetuara kushtet e përgjithshme nga pika 2 Kandidatët për **Doktor medicine, specialist internist** duhet të plotësojnë edhe kushtet e posaçme në vijim:
  - Të mbaruar arsim sipëror - Fakulteti Mjekësisë.
  - Licencë për punë,
  - Certifikatë për provim të dhënë profesional për mjekësi interne
4. Orari i punës javore është 40 orë. Paguesa neto bazë për **Doktor medicine, specialist internist** është 32.755,00 denarë.
5. Si shtojcë me fletëparaqitjen kandidatët për vendin e punës **Doktor medicine, specialist internist** janë të obliguar të dorëzojnë dokumentet në vijim:
  - Fletëparaqitje me të dhënat për kontakt
  - Biografi të shkurtër (CV)
  - Diplomë me sukses mesatar, Certifikatë për Fakultet të mjekësisë të mbaruar, origjinal ose kopje të vërtetuara në noter, origjinal ose kopje të vërtetuara në noter
  - Certifikatë nga mjeku jo më të vjetër se 6 muaj, origjinal ose kopje të vërtetuara në noter
  - Certifikatë të shtetësisë së Republikës së Maqedonisë, origjinal ose kopje të vërtetuara në noter
  - Kopje të letërnjoftimit të vërtetuar në noter
  - Certifikatë se nuk i është shqiptuar ndalesë e plotfuqishme për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës në original ose kopje të vërtetuara në noter
  - Certifikatë për provim të dhënë specialistik për mjekësi interne, në origjinal ose kopje të vërtetuara në noter,
  - Licencë për punë, origjinal ose kopje të vërtetuara në noter
6. Përpos me ligj të vërtetuara kushtet e përgjithshme nga pika 2 Kandidatët për **Doktor medicine, specialist pediatër** duhet të plotësojnë edhe kushtet e posaçme në vijim:
  - Të mbaruar arsim sipëror - Fakulteti Mjekësisë,
  - Të dhënë provimin profesional për pediatri
  - Licencë për punë,
7. Orari i punës javore është 40 orë. Paguesa neto bazë për **Doktor medicine, specialist pediatër** është 32.755,00 denarë.
8. Si shtojcë me fletëparaqitjen kandidatët për vendin e punës **Doktor medicine, specialist pediatër** janë të obliguar të dorëzojnë dokumentet në vijim:
  - Fletëparaqitje me të dhënat për kontakt
  - Biografi të shkurtër (CV)
  - Diplomë me sukses mesatar, Certifikatë për Fakultet të mjekësisë të mbaruar, origjinal ose kopje të vërtetuara në noter, origjinal ose kopje të vërtetuara në noter
  - Certifikatë nga mjeku jo më të vjetër se 6 muaj, origjinal ose kopje të vërtetuara në noter
  - Certifikatë të shtetësisë së Republikës së Maqedonisë, origjinal ose kopje të vërtetuara në noter
  - Kopje të letërnjoftimit të vërtetuar në noter
  - Certifikatë se nuk i është shqiptuar ndalesë e plotfuqishme për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës në original ose kopje të vërtetuara në noter
  - Certifikatë për provim të dhënë specialistik për pediatri, në origjinal ose kopje të vërtetuara në noter,
  - Licencë për punë, origjinal ose kopje të vërtetuara në noter
9. Afati për paraqitje është 5 (pesë) ditë nga dita e publikimit të shpalljes.
10. Dokumentacioni i dorëzuar pas afatit, jo i plotë dhe i pakompletuar nuk do të jetë lëndë e shqyrtimit nga ana e komisionit për selektim të kandidatëve.
11. Pas selektimit të realizuar të kandidatëve të paraqitur nga pika 2 të cilët i plotësojnë kushtet nga shpallja publike, do të realizohet provim kualifikues në pajtim me nenin 160 paragrafi 2 nga Ligji për mbrojtje shëndetësore edhe për kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet në pajtim me shpalljen publike, do të realizohet pjesa (test) profesional në pajtim me nenin 160 paragrafi 3 nga Ligji për mbrojtje shëndetësore.
12. Fletëparaqitja me dokumentacionin e përgjithshëm dhe telefoni për kontakt, të dorëzohet në IPSSH Institutit për sëmundje të mushkërive tek fëmijët Kozle, Shkup lagjia Kozle p.n., Shkup me postë apo në arkivin e IPSSH Institutit për sëmundje të mushkërive tek fëmijët Kozle, Shkup, me shenjë për Shpallje publike për punësim.
13. Shpallja e publikuar më datë 07.05.2018 anulohet dhe konsiderohet si i pavlefshëm, ndërsa në fuqi ligjore është shpallja e publikuar më datë 08.05.2018.

**IPSSH Instituti për sëmundje të mushkërive tek fëmijët Kozle, Shkup**  
**UD Drejtor**  
**D-r Angello Andonovski**  
**Ekk i Dipl. Rijad Alimi**

Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor të Republikës së Maqedonisë

**PUBLIKON**

Kërkesë për marrje të A – Lejes së integruar ekologjike

Në pajtim me nenin 96 paragrafi 1 të Ligjit për mjedis jetësor (Gazeta zyrtare e RM 53/05, 81/05, 24/07, 159/08 dhe 83/09, 48/10, 124/10, 51/11, 123/12, 93/13, 187/13, 42/14, 44/15, 129/15, 192/15 dhe 39/16), deri te Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor është parashtuar Kërkesë për A – Leje të integruar ekologjike UP1-11/3 nr. 693/2017 të datës 10.05.2017.

Parashtrues i kërkesës:

SHNTT TRASMET SHPK Shkup – Bazë asfalti TRASMET (në truallin në fshatin Popoec, Komuna e Kërçovës)

Adresa:

Kosturski Heroi nr. 38/2/1

Koordinatat në lokacionin sipas sistemit nacional i koordinatave:

N 41,447486 E 20,813931

Kontakt person:

1. Igor Ilievski, Inxhinier për siguri dhe shëndet gjatë punës e-mail: [zpr.igor@gmail.com](mailto:zpr.igor@gmail.com)

Kategoria e instalacionit:

3. Industria e mineraleve, 3.5 Bazat e stacionuara të asfaltit

Kapaciteti projektuese:

200t/h

Lloji i aktivitetit:

Prodhim i masës së nxehtë asfalti;

Kërkesa në formë të shtypur, do të jetë e mundshme për publikun e interesuar në afat prej 15 ditëve pas daljes së kësaj shpallje në shtypin ditor, në lokalet e:

- Komuna e Kërçovës
- Boris Kidriq nr. 1 6250 Kërçovë
- Çdo ditë pune, Sektori për mjedis jetësor

Kontakt telefoni 045 223-001

Njëkohësisht, kërkesa do të jetë e mundshme edhe në formë elektronike, në ueb faqen zyrtare të Ministrisë së Mjedisit

Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor [www.moepp.gov.mk](http://www.moepp.gov.mk)

Informacionet në lidhje me kërkesën, publiku i interesuar mund të marrë në Ministrinë e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit

Hapësinor në numrin e tel. 02 3251-478 (e-mail [f.balieu@moepp.gov.mk](mailto:f.balieu@moepp.gov.mk))

Pala e prekur, në afat prej 30 ditëve nga dita e publikimit të kërkesës, ka të drejtë të parashtrojë mendime dhe komente në formë me shkrim deri te Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor bulevardi "Goce Dellçev" nr. 18 ndërtesa e RTM (kati 10), 1000 Shkup.

**Shitet truall 7628 m2, kultura N, klasa 6, në vendin e quajtur KRST, Komuna e Gazi Babës. Të interesuarit mund të paraqiten në numrin e telefonit 075 730-487.**

**URGJENTISHT**

**Shes truall të urbanizuar Po+Pr+2 menjëherë në fillim të Industrisë së lehtë "Momin Potok" – Shkup, me sipërfaqe të përgjithshme prej 890 m2 së bashku me objektet ekzistuese prej 180 m2. Çmimi 178.000 euro. Numri i telefonit: 078 – 201 – 960**

**URGJENTISHT**

**Shitet shtëpi në lagjen Serava-Shkup në rr. "7 korriku" nr. 8 afër spitalit gjinekologjik, shtëpia është e ndërtimit të ri me dokumentacion të kompletuar. Kontakt tel. 070-775-703; 071 372 221**



LAMTUMIRA E MALLËNGJYER E VENGER

GJITHMONË

DO TË JEM

TIFOZI

ARSENALIT



Këtë fundjavë, Arsen Wenger e ka drejtuar Arsenalin në ndeshjen e fundit në shtëpi dhe natyrisht se ka qenë një ndeshje plot emocione për strategun francez. Pasi të mbyllet sezoni, 68-vjeçari do të largohet nga posti i trajnerit të Topçinjve, ku qëndroi plot 22 vite

Një lamtumirë emocionuese i dhuruan tifozët e Arsenalit, trajnerit që për 22 vite drejtoi skuadrën londineze. Arsen Wenger u prit në fushë mes duartrokitjeve të të gjithë të pranishmëve në "Emirates Stadium", teksa lojtarët e të dyja skuadrave nderuan me respekt maksimal teknikun 68-vjeçar, duke formuar një 'pasillo', ku francezi parakaloi. Në takimin e tij të fundit përpara tifozëve të Arsenalit, skuadra i dhuroi 3 pikët trajnerit, duke mposhtur me "goleadë" 5-0 Barnlin. Në përfundim të takimit drejtuesit e klubit i dhuruan teknikut francez një minitrofe të Premier Ligës, që simbolizonte sezonin 2003-2004, kur të

ashtuquajturit "të pathyeshmit" e Arsenalit, nën drejtimin e Venger fituan titullin kampion pa e provuar humbjen. Në mbyllje 68-vjeçari i dha lamtumirën fansave bardhekuq me fjalët kuptimplota: Do të jem gjithmonë një tifoz i Arsenalit. Ëndrrat na bëjnë të jemi gjithnjë të bashkuar në çdo qelizë. Ka qenë një aventurë e mrekullueshme. Ndihej i nderuar që kam qenë me ju për shumë vite. Para së gjithash, jam një nga ju, një tifoz i Arsenalit. Ky grup lojtarësh që po lë është i veçantë. Ju kërkoj t'i mbështesni sezonin e ardhshëm. Dua t'ju përhëndes me një frazë të vetme: do të më mungoni. Keni përfaqësuar një

fazë të rëndësishme të jetës sime dhe shpresoj të takohemi përsëri shumë shpejt", ka thënë Venger. Venger thotë se nuk dëshiron ti bëjë presion klubit për zëvendësuesin e tij. "Mendoj se është mirë që të mos flas publikisht për trajnerin e ri, sepse nuk jam i përfshirë në këtë gjë. Nuk dua t'i bëj presion klubit për të zgjidhur këtë ose atë... – sepse nuk dua të kem të bëjë me këtë. Mendoj se ai do ta trashëgojë një skuadër që është shumë më e mirë sesa e mendojnë njerëzit. Jam i bindur se bashkimi i kësaj skuadre është shumë i veçantë dhe me lojtarët e rinj të duhur, ky ekip do të sfidojë në sezonin e ardhshëm", deklaroi Venger.

## Klopp pranon se janë të interesuar për Dembele

Ousmane Dembele nuk ka arritur të përshtatet mirë në futbollin spanjoll. Pas transferimit të Barcelona nga Borussia Dortmund, francezi ka pësuar një lëndim që e mbajti disa muaj jashtë fushave të blerta. Por me tu kthyer në fushë ai nuk ka arritur të jetë një titullar te Barcelona dhe kësaj duket se largimi i tij nga "Camp Nou" është afër. E ardhmja e tij duket se do të jetë në kampionatin anglez Ligën Premier. Ka qenë trajneri i Liverpoolit, gjermani Jurgen Klopp që ka pranuar se janë të interesuar për transferimin e Dembeles. I pyetur nga gazetarët nëse janë duke tentuar transferimin e Dembeles, Klopp u përgjigj: "A është në tregun e transferimeve ai? Po, tani jemi të interesuar", deklaroi Klopp. Barcelona për transferimin e reprezentuesit francez pa-



goi te Borussia Dortmund 105 milionë euro plus bonuset. Por pasi nuk ka luajtur shumë me katalanasit, besohet se Dembele mund të largohet nga "Camp Nou" për një shumë rreth 90 milionë. 20-vjeçari ka shënuar vetëm dy gola me fanellën e Barcelonës në të gjitha garat dhe ka bërë tetë asistime.

## Liverpuli arrin marrëveshjen me Fekir

Liverpuli ka arritur marrëveshjen me vlerë 75 milionë euro për fantazistin e Lionit, Nabil Fekir këtë verë, sipas raporteve nga Franca. Megjithatë "Të Kuqtë" nuk kanë bërë një zëvendësues direkt të Kuntinos në janar, i cili shkoi te Barcelona, ata kanë qenë në kërkim të një lojtari që do të mbushte boshllëkun e lënë nga braziliani. Dhe tani "RMC Sport" pretendon se sulmuesi i Lionit, Fekir, ka nënshkruar një kontratë pesëvjeçare për t'u transferuar në "Anfield". Liverpooli do të paguajë 75 milionë euro plus bonuse për Fekir, i cili ka shënuar 17 gola këtë sezon në Ligue 1. Ka qenë pikërisht ish-trajneri i Liverpoolit Zherard Hulier që thuhet të ketë



ndihmuar anglezët të arrijnë marrëveshjen. Ai thuhet të ketë udhëtuar në Angli disa javë më parë për të finalizuar marrëveshjen dhe bashkë me Fekir në Liverpool do të udhëtojë edhe vëllai i tij Jassin Fekir.

Publicitet

Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 dhe nenit 23 paragrafi 1 të Ligjit për marrëdhënie pune Gazeta Zyrtare e RM nr. 167/15 dhe Ligjit për ndryshim dhe plotësim të LMP (Gazeta Zyrtare e RM nr. 27/16) dhe pëlqimit të Ministrisë së financave nr. 18-4108/2- të datës 11.04.2018 dhe Ministrisë së punës dhe politikës sociale Shkup nr. 04-4121/4 dhe nenit 22 të Statutit të Shtëpisë, UD Drejtori i IPK Shtëpia për persona të moshuar "Kiro Krsteski – Pllatnik" – Prilep publikon:

### SHPALLJE

Për themelimin të marrëdhënies së punës për kohë të pacaktuar të punës

- Mirëmbajtës të higjienës..... 4 realizues
- Geronto-nikoqir.....5 realizues
- Mjeshtër të përgjithshëm.....1 realizues

Krahas kushteve të përgjithshme të parapara me Ligjin për marrëdhënie pune kandidati duhet të përmbushë edhe kushtet e posaçme në vijim:

Kandidatët me numër rendor 1 duhet të kenë të mbaruar arsimin katër ose trevjeçar.

Kandidatët me numër rendor 2 duhet të kenë të mbaruar arsimin fillor.

Kandidatët me numër rendor 3 duhet të kenë të mbaruar arsimin e mesëm katërvjeçar – pa përvojë pune.

Së bashku me lutjen kandidatët duhet të parashtrorjnë:

- diplomë për arsim të mbaruar
- certifikatë të shtetësisë së RM
- certifikatë të lindjes

-të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës dhe

-me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

-në mënyrë aktive të njeh gjuhën maqedonase

Shpallja zgjatë 8 ditë pune nga dita e publikimit në shtypin ditor në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën që e flasin 20% e qytetarëve që flasin gjuhë zyrtare ndryshe nga gjuha maqedonase.

Dokumentet e nevojshme të parashtrohen deri në IPK Shtëpia për persona të moshuar "K. K. Pllatnik" Prilep, rr. "Nada Llameska" 1a, Prilep, tel. 048 435-011.

Zgjedhja do të realizohet në afat prej 5 ditëve nga dita e përfundimit të shpalljes.

Shtëpia për persona të moshuar "Kiro Krsteski – Pllatnik" – Prilep

Në bazë të nenit 20, 21 dhe 22 të Rregullores për licenca për kryerje të veprimtarisë energjetike (Gazeta Zyrtare e RM nr. 143/11, 78/13, 33/15 dhe 207/16) Shoqëria për konfeksion të veshjeve, eksport-import, përfaqësim tregtar në vend dhe jashtë vendit TEKSPORT SHPKNJ, Shkup në vijim publikon:

### LAJMËRIM

Shoqëria për konfeksion të veshjeve, eksport-import, përfaqësim tregtar në vend dhe jashtë vendit TEKSPORT SHPKNJ, Shkup më datë 16.02.2018, ka parashtruar Kërkesë për dhënie të licencës për kryerje të veprimtarisë energjetike prodhim të energjisë elektrike nga burime të ripërtëritura me UP1 nr. 12-09/18 deri tek Komisioni rregullator për energjetikë i RM.

#### Emri i kërkuar:

Shoqëria për konfeksion të veshjeve, eksport-import, përfaqësim tregtar në vend dhe jashtë vendit TEKSPORT SHPKNJ, Shkup, rr. Hristo Tatarçev nr. 69, Shkup.

#### Lloji i veprimtarisë energjetike:

Prodhim i energjisë elektrike.

#### Rajoni ku do të realizohet veprimtaria:

Prodhimi i energjisë elektrike do të bëhet nga centrali fotovoltaik në çatinë e objektit në PK 263/83 dhe 263/39, KK Marino, Komuna Ilinden, Shkup, Republika e Maqedonisë.

#### Përkrahimi i mënyrës, objekteve dhe mjeteve për kryerje të veprimtarisë:

Shoqëria për konfeksion të veshjeve, eksport-import, përfaqësim tregtar në vend dhe jashtë vendit TEKSPORT SHPKNJ, Shkup do të prodhojë energji elektrike në çati, i locuar në objekt në PK 263/83 dhe 263/39, KK Marino, Komuna Ilinden, Shkup. Prodhimi i energjisë elektrike përmes sistemit inverter do të dorëzohet në sistemin distribues. Fuqia e instaluar e centralit fotovoltaik do të jetë 108,00 kW.

#### Kohëzgjatja e licencës:

Kërkuar kërkon që kohëzgjatja e licencës të jetë 35 vjet.

#### Afat për parashtrimin e propozimeve, mendimeve dhe sugjerimeve në lidhje me Kërkesën për dhënie të licencës:

Palët e interesuara juridike dhe fizike mund me shkrim të parashtrorjnë deri tek Komisioni rregullator për energjetikë i RM, mendime dhe propozime në lidhje me Kërkesën në afat prej 5 (pesë) ditëve nga dita e publikimit të këtij Lajmërimi për Kërkesë në shtypin ditor.

#### Adresa e Komisionit rregullator për energjetikë të RM

rr. Makedonija, pn, Pallati Llazar Pop Trajkov, kati 6, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë

Shoqëria për konfeksion të veshjeve, eksport-import, përfaqësim tregtar në vend dhe jashtë vendit TEKSPORT SHPKNJ, Shkup



Mediat britanike konfirmojnë që Ferguson ndodhet në sallën e reanimacionit në terapi intensive, ndërkohë që operacioni ka shkuar mirë, por trajneri ka nevojë për një periudhë të pacaktuar kurimi. Urimet për një shërim të shpejtë nuk kanë munguar për këtë ikonë të futbollit botëror

FERGUSON NË TERAPI INTENSIVE

# FUTBOLLI NË ANKTH DHE LUTJE



Sër Aleks Ferguson është ende në gjendje kritike për jetën, pas operacionit të kryer në tru, për shkak të një hemorragjie cerebrale që ka pasur mbrëmjen e 5 majit. Trajneri legjendar i Mançester Junajted, tashmë 76 vjeç, ndodhet ende në spital nën mbikëqyrjen e mjekëve, ndërkohë që e gjithë bota e futbollit lutet e shpreson

për rikuperimin e tij. Edhe pse ende nuk ka dalë një buletin mjekësor në lidhje me gjendjen e Ferguson, mediat britanike konfirmojnë se situata nuk është e mirë, por mjekët po bëjnë të pamundur për ta shëruar. "The Sun" shprehet se familjarët e trajnerit janë të shqetësuar për gjendjen dhe lutet që Sër Aleks të kalojë këtë problem, ndërkohë që

kërkojnë edhe ruajtjen e privatësisë dhe evitimin e deklaratave të gabuara në lidhje me gjendjen e ikonës së futbollit britanik. Mediat britanike konfirmojnë që Ferguson ndodhet në sallën e reanimacionit në terapi intensive, ndërkohë që operacioni ka shkuar mirë, por trajneri ka nevojë për një periudhë të pacaktuar kurimi. Urimet për një shërim të shpejtë nuk

kanë munguar për këtë ikonë të futbollit botëror. Cekim, Ferguson u largua nga detyra e trajnerit të Mançester Junajted në vitin 2013, pas 26 vitesh në drejtimin e "dajve të kuq", ku fitoi 13 tituj kampionë, 5 Kupa të Anglisë, 4 Kupa të Ligës, 2 Çampions Liga, 1 Kupa të Kupave, 1 Botëror për skuadra, 1 Superkupë të Evropës, 1 Kupë Interkontinentale dhe 10 "Community Shield". Ndërkohë që, Sër

Aleks ka fituar edhe 3 kampionate në Skoci, 4 Kupa të Skocisë dhe një Kupë të Ligës në vendlindjen e tij. Trajneri pati probleme shëndetësore teksa ndodhej në shtëpinë e tij në Uilmslou dhe më pas u transportua me urgjencë në spital me autoambulancë. Ai u transferua nën shoqërimin e forcave të policisë në spitalin e "Salford Royal Hospital", ku dhe ndodhet nën mbikëqyrjen e mjekëve dhe kujdesin e familjarëve.

## Messi, klasiku historik i "El Clasico"

Leo Messi e zgjeron rekordin e tij si golashënuesi më i mirë historik i klasikeve spanjolle. Në ndeshjen e fazës së dytë të La Liga-s, Barcelona-Real Madrid, ylli argjentinas ka shënuar një gol të ri, atë të rezultatit 2-1, që më pas ndryshoi dhe u "vulos" në shifrat 2-2. Në fazën e parë, ai arriti kuotën e 25 golave, pasi shënoi nga pika e penalltisë golin e dytë të fitores 0-3, në "Bernabeu". Tw shtunwn nw mbrëmje u ngjit në shifrën e 26 golave. Argjentinasi ka shënuar gjithsej 15 gola në "Santiago Bernabeu" dhe 11 gola në "Camp Nou", kundër "madridistëve". Në aspektin e kompeticionit, golat e pesë herë fituesit të "Topit të Artë" janë të ndarë në këtë mënyrë: 18 gola në La Liga, 2 gola në Ligën e Kampionëve dhe 6 në Superkupën Spanjolle. Përveç kësaj, 22 gola janë shënuar me këmbën e majtë nga "10" e Barçës, ndërsa 4 gola të tjerë me të djathtën. Messi e ka arritur këtë



kuotë golash në gjithsej 37 klasike të luajtura deri më tani. Goli i tij i parë kundër Real Madridit u shënuar në "Camp Nou", në sezonin 2006-2007, si pjesë e një "hat-trick", në barazimin 3-3. Përveç kësaj, ky gol i ri i Messit e dërgon në 44, numrin e golave të tij në këtë

sezon (33 gola në kampionat, 6 gola në Çampions, 4 gola në Kupën e Mbretit dhe 1 gol në Superkupë), me një total prej 551 golash si profesionist.

Ndeshja e së dielës mbrëma, Barcelona-Real Madrid 2-2, e kishite brenda edhe sfidën mes Lionel

Messit dhe Cristiano Ronaldos, teksa të dy luftojnë për të qenë shënuesit më të mirë në historinë e kësaj përballjeje. Të dy shënuan nga një gol në "Camp Nou", por argjentinasi vijon të ketë 8 gola më shumë e ylli i "Los Blancos", për momentin. Kujtojmë se Alf-

do Di Stefano, César Rodríguez dhe Ferenc Puskas janë disa nga lojtarët klasikë historikë të "El Clasico", në këtë drejtim. KR7 është barazuar në gola me Di Stefano, si golashënuesi i dytë më i lartë. Portugezi ka shënuar 18 gola ndaj Barçës në 29 ndeshje: 9 gola në La Liga, 5 gola në Kupën e Mbretit dhe 4 gola në Superkupën Spanjolle.

Lionel Messi është golashënuesi më i mirë në historinë e klasikeve spanjolle, me 26 gola. Ai i tejkalon të tjerët, por Cristiano Ronaldo nuk heq dorë dhe, pavarësisht se ka shumë gola më pak se "Pleshti", dëshiron të vazhdojë të shënojë për ta rrëzuar atë. Debutimi i Ronaldos në "El Clasico" erdhi më vonë, për shkak se ai arriti te Real Madridi në vitin 2009. Portugezit iu desh njëfarë kohe për t'i shënuar gol Viktor Valdes. Për herë të parë, kjo ndodhi më 16 prill 2011, në përplasjen e La Liga-s, në "Bernabeu".



**DASHI** 21. mars - 20. prill

Ata që janë në një lidhje do jetojnë të lumtur gjatë kësaj dite pranë atij që duan. Mbrëmja do jete edhe me romantike dhe emocionuese. Beqaret do kenë me shume fat sesa mendonin dhe do e gjejnë personin me të përshtatshëm. Financat duhen menaxhuar me kujdes dhe maturi. Po e tepruar me shpenzimet do keni vështirësi të mëdha me vonë dhe nuk do dini çfarë të bëni.

**DEMI** 21. prill - 21. maj

Konfigurimi i yjeve nuk do jete shume pozitiv për ata që janë në një lidhje. Do debatoni here pas here me atë që keni në krah dhe nuk do jeni aspak në humor. Edhe beqaret do e kenë shume të vështirë ta gjejnë personin e përshtatshëm prandaj do duhet të presin ende. Në planin financiar do jete dite e mbushur me fat, por kjo nuk do të thotë që ju të shpenzoni sa të dëshironi.

**BINJAKET** 22. maj - 21. qershor

Ata që janë në një lidhje do kenë një dite të zakonshme dhe pa asgjë të veçantë. Merrni gjatë ditës si t'iu vijnë. Beqaret do kenë mundësi të nisin aventura të këndshme dhe do ndihen shume mire. Duhet të prisni edhe pak për të filluar një lidhje serioze dhe afatgjate. Në planin financiar askush nuk mund t'iu ndale të kryejnë shpenzimet që keni menduar. Vetëm bëni shume kujdes!

**GAFORRJA** 22. qershor - 22. korrik

Venusi do i beje atë që janë në një lidhje me sharmante he me shprehës. Do e mbani gjithë kohës pas vete partnerin dhe ai do ndihet me se miri që iu ka në krah. Beqaret nuk do kenë shume fat për të filluar një lidhje serioze kështu që do bëjnë mire të qëndrojnë edhe pak kohe vetëm. Financat do jene përgjithësisht të stabilizuara dhe pa probleme.

**LUANI** 23. korrik - 22. gusht

Jeta sentimentale e çifteve do jete shume e trazuar gjatë kësaj dite. Do keni probleme të shumta me partnerin dhe nuk do i pranoni ato që ai do iu thotë. Beqaret duhet të bëjnë ende shume durim sepse as sot nuk është dita e duhur për të gjetur dashurinë. Financat do jene të mira, por po u tundat të kryeni shpenzime të mëdha mund të keni ndonjë tronditje.

**VIRGJERESHA** 23. gusht - 23. shtator

Pasioni në çift do jete edhe me i zjarrte gjatë kësaj dite dhe do ndiheni shpesh si mbi re në krahët e atij që dashuroni. Shfrytëzojeni ditën deri në sekondën e fundit. Beqaret do kenë takime të njëpasnjëshme dhe do iu jepet mundësia të zgjedhin personin që iu përshtatet me tepër. Financat do jene të paqëndrueshme kështu që duhen shmangur investimet e mëdha.

**PESHORJA** 24. shtator - 23. tetor

Turbullirat me ne fund do mbarojnë në jetën tuaj sentimentale dhe do e shihni më me optimizëm të ardhmen. Do jeni me të qete edhe për të marre disa vendime. Beqaret nuk do mendojnë për të krijuar një lidhje, por për ta do ketë surpriza sidomos gjatë ndonjë feste. Financat do i menaxhoni me shume maturi dhe kujdes prandaj nuk do keni as me të voglin problem.

**AKREPI** 24. tetor - 22. nëntor

Çështjet e zemrës do shkojnë me se miri gjatë kësaj jave. Do flisni për gjithçka me atë që keni në krah dhe nuk do keni as keqkuptimin me të vogël. Beqaret do jene gjithë kohës të dëshpëruar sepse jo vetëm që nuk do gjejnë dashurinë, por dhe miqtë nuk do iu qëndrojnë afër. Financat nuk do jene problematike kështu që ne këtë plan nuk do keni për çfarë të merakoseni.

**SHIGJETARI** 23. nëntor - 21. dhjetor

Duke filluar që sot lidhja me partnerin do përforcohet tej mase dhe do mendoni për një të ardhme afatgjate se bashku. Partneri do i mbaje edhe disa premtime që kishte bere prej kohe. Beqaret nuk do kërkojnë me ngulm dashurinë sepse do ndihen mire edhe ashtu si janë. Financat do përmirësohen fale kontratave të mira që ju do nënshkruani.

**BRICJAPI** 22. dhjetor - 20. janar

Çdo gjë do jete rutine në jetën tuaj në çift dhe nuk do përjetoni asnjë emocion të veçantë nga çfarë keni përjetuar deri me sot. Beqaret do kenë një takim vendimtar që ne orët e para të mëngjesit. Mos e humbni për çfarëdo lloj arsyeje. Në planin financiar duhet të kërkonit me çdo mënyrë strategjinë e duhur për ta stabilizuar situatën. Me pak mund t'ia dilni.


**UJORI** 21. janar - 19. shkurt

Nuk do e toleroni aspak atë që keni në krah sot dhe debatet me njeri tjetër do jene shume të mëdha. Ata që kane kohe që janë futur në një vorbull mosmarrëveshesh mund të marrin edhe vendime për një ndarje të mundshme. Beqaret do tërhiqen nga persona të cilët janë të angazhuar. Kujdes mos bëni ndonjë gabim për të cilin të pendoheni gjithë jetën. Financat do jene shume të mira.

**PESHQIT** 20. shkurt - 20. mars

Klima yjore do favorizojë bashkëpunimin dhe komunikimin në çift. Me ne fund do i zgjidhni disa probleme të vogla që keni pasur dhe do flisni lirshëm edhe për disa tema delikate. Beqaret do jene të turpshëm dhe nuk do përfitojnë nga ftesat që do iu bëhen. Në planin financiar priten përmirësime të ndjeshme. Mund të shpenzoni për disa objekte që iu kane mbetur fiksim.

12 VITE PA TË DASHURIN TONË



**DR. LUTFI TURKESHI**  
(1947-2006)

Koha nuk ndryshon asgjë, neve na mungon volumi i zërit tënd, zemra jonë ende është e mbushur me trishtim, lotët tonë ende rrjedhin në heshtje, pra koha është ajo që s'ndryshon asgjë ngase ne aq shumë e ndjejmë edhe sot mungesën tënde.

Gjithmonë do të mbetesh krenaria e familjes sonë.

*Të përkujtojnë plot dhimbje: bashkëshortja Suzana, djali Neritoni dhe vajza Rina me familjet e tyre.*

LUMË NË BOSNJE E HERCEGOVINË	B	VEGËL KUZHINE SPORTI I PERSONIT NË FOTO, ... TAI	P	KOHA	BASKETBOLLISTI AMERIKAN, SHEKIL	REOMIRI	EMRI I SKENËS SE SPORTISTIT NË FOTO	IRIDIUMI	QYTET NË MALI EMRI I VËRTETË I SPORTISTIT NË FOTO	C
NJËSIA E REZISTENCËS ELEKTRIKE				BOTA (LAT. SHQ.) POLITIKANI RUMUN, KORNEL						
VEND NË TAILANDË, VENDLINDJA E SPORTISTIT NË FOTO						PËRGËZON KALIUMI				
AKADEMIA E DETARISË								MEJREME ZEQIRI KRIPËRA QË FITOHEN NGA BMET E DEJIT		
ISH HIPNOTISTI I NJOHUR, KEBIR						QË KA VËLLIM TË MADH				
							STRIPI I ILLUSTRUAR, FORD			
							KOMPANI GREKE E NAFTËS			
							LOKAL NATE			I RI, ÇUN
							ISH MBRET I NORVEGJISË			
							VETURË FRENËGE			
							FOSFORI	SHKRONJA FOINJE ILIR REXHEPI		
Mensur Mamuti	TELEVIZIONI	BOKSIERI AMERIKAN, RODRIGEZ	KËNGËTARJA FRENËGE, PIAF	SHOKU, JARANI	TUBERKULOZI I KOCKAVE BELGIJKA					
FRIKËSOHEM								ELVIRA DIAMANTI REPUBLIKA SOCIALISTE FEDERATIVE		
PRINCI SHQIPTAR, VILHELM					AKTORI AMERIKAN, MIKI BLERTAS YLA					
KOHA	SPORT MARCIAL, FUSHA E SPORTISTIT NË FOTO LITRI								LUKSEMBURGU	
ZAMBAKU I BARDHË (NOFKA E SPORTISTIT NË FOTO)								PETË ME SHUMË SHITRESA		

ZGJIDHJET: B, P, C, OM, ORBISI, SURIN, URON, NAUTIKA, MZ, AINUL, KABA, ALAN, OKTA, PAB, OLAV, RENO, P, ÇC, RIA, HARMU, TREMBEM, ED, VIDU, RURKI, KIK BOKS, L, LOTUSI, FLI.



## 13 VJEÇARJA shndërrohet në "gjarpër" sapo del në diell!



Një 13 vjeçare nga India, është detyruar të bëjë jetë ndryshe nga të tjerët. Kjo për shkak të një gjendjeje të rrallë shëndetësore që e bën lëkurën e saj të rrjedh gjak sa herë i ekspozohet dritës së diellit. "Gjithçka që mund të bëj është të shoh fëmijët e moshës time që luajnë dhe gëzojnë jetën e tyre. Unë shpesh pyes veten se pse i jam nënshtruar këtij lloj ndëshki-

mi nga Perëndia. Çfarë mëkati kam kryer për të vuajtur këshu?", ka thënë ajo në një intervistë për mediat e huaja. Madje ajo ka deklaruar se ndjen keqardhje pasi miqtë e saj e quajnë atë "Vajza Gjarpër". Vedika Gupta vuan

nga çrregullimi gjenetik 'ichthyosis', e cila e ka "mbyllur" atë në dhomën e saj të gjumit. Ekzistojnë 20 lloje të ndryshme të ichthyosis, të cilat mund të ndikojnë më pak se në tre fëmijë të lindur në vit në Mbretërinë e Bashkuar.

Pasi ka bërë vizita tek mjekë të ndryshëm, të cilët nuk kanë arritur të lehtësojnë vuajtjen e Vedikës, adoleshjentja ka filluar përdorimin e një locioni trupi që ndihmon në parandalimin e tharjes së lëkurës



## Gjendet pika e dobët e tumoreve

Gjendet pika e dobët e tumoreve. Është një proteinë e cila nëse bllokohet, sëmundja vetëshkatërrohet automatikisht. Proteina është e njëjtë me atë që prodhohet nga qelizat e shëndetshme në kushte stresi. Eksperimentet janë bërë në laborator mbi minjtë, në rastin e kancerit të prostatës, por që studiuesit thonë se mekanizmi mund të jetë i njëjtë edhe për tumoret e tjerë. Zbulimi është bërë nga Universiteti i Kalifornisë në San Francisco dhe është publikuar në revistën Science Translational Medicine. Autorët shpjegojnë se tumoret më agresivë, shpenzojnë shumë më tepër energji dhe për tu rritur me shpejtësi, ato optimizojnë përdorimin e saj, falë kësaj proteine, e cila ka një mënyrë frenimi. Dhe pikërisht për këtë arsye këto lloj tumoresh bëhen të varur nga kjo proteinë që është vendimtare për zhvillimin e tyre. Kështu duke bllokuar këtë proteinë, tumoret nuk ushqehen më e kështu fillojnë të vdesin.

## Grupi i gjakut o: I mirë për të tjerët, por i keq për atë që e ka

Të pasurit grup gjaku o dyfishon rrezikun e vdekjes nga plagët e rënda. Të dhënat vijnë nga një studim i ri dhe shkencëtarët besojnë se ky grup gjaku është i lidhur me nivelet e ulëta të një agjenti koagulimi, që mund të çojë në gjakderdhje të madhe. Sipas të artikulli nga britanikja "Mirror", të dhënat e pacientëve të pavionit të emergjencës në Japoni, treguan se ata persona që kishin grup gjaku o përbënin 28 për qind të vdekjeve. Ndërsa përqindja e vdekjeve tek pacientët me grupe të tjera gjaku, të gjithë së bashku ishte 11 për qind. Dr Wataru Takayama, nga Spitali Universitar Mjekësor dhe Dental i Tokios, i cili udhëhoqi punën kërkimore tha se studimet e kohëve të fundit sugjerojnë se grupi i gjakut o mund të jetë një faktor me potencial të rrezikshëm për he-

morragjinë. "Humbja e gjakut është shkak kryesor i vdekjeve tek pacientët me trauma të rënda, por studimet për lidhjet mes grupeve të gjakut dhe rrezikut të vdekjes nga traumat, kanë qenë të pakta", shpjegoi eksperti. Ai shtoi se grupi i tij i punës dëshiron pikërisht që të testonte hipotezën se shanset për të mbijetuar nga trauma, varen nga grupi i ndryshëm i gjakut. Lloji i gjakut përcaktohet nga proteinat që ndodhen në sipërfaqe të qelizave të kuqe të gjakut. Grupet e tjera kryesore të gjakut janë A, B dhe AB. Tipi o mund t'i dhurohet të gjitha grupeve të tjera pa pasur asnjë efekt negativ. Megjithatë, personat me grup gjaku o kanë nivele më të ulëta të faktorit të njohur si Van Willebrand, një agjent që mund të parandalojë vdekjen nga gjakderdhja.



535 – Xhon II përfundon sundimin e tij si Papë katolik  
1521 – Parlamenti në Uorms shpall dekret kundër Martin Luterit  
1541 – Hernando de Soto zbulon Lumin Misisipi  
1660 – Parlamenti anglez kërkon nga Mbreti Çarls II të japë dorëheqje  
1721 – Michelangiolo dei Conti zëvendëson Papa Klementin XI si Inoqenti XIII  
1821 – Lufta greke për pavarsi: Grekët mundin turqit në Gravia  
1914 – Themelohet Paramount Pictures  
1926 – Bëhet fluturimi i parë mbi Polin e Veriut (Bennett dhe Byrd)  
1933 – Mohandas Gandhi fillon grevën 21 ditore të urisë kundër tiranisë britanike në Indi  
1945 – V-E Day; Gjermania nënshkruan dorëzimin e pakushtëzuar; Përfundon Lufta e II Botërore në Evropë  
1949 – Miratohet kushtetuta e Gjermanisë Perëndimore  
1960 – BRSS dhe Kuba rifillojnë marrëdhëniet diplomatike  
1984 – BRSS kumton se nuk do të merr pjesë në Lojrat Olimpikë Verore në Los Angeles  
1988 – Fransoa Miteran zgjedhet kryetar i Francës.



Kujdes nga gjarpri, merimanga dhe akrepit. Por mbajeni në mend këtë: Më shumë keni gjasa të mbyteni nga një grerëz dhe qen. Prej 1610 njerëzve të mbytur nga kafshët mes viteve 2008 dhe 2015, 478 prej tyre janë mbytur nga bletët dhe grerëzat, 272 nga qentë, thuhet në hulumtimin e publikuar nga Wilderness & Environmental Medicine. Gjarpërinjtë, merimangat dhe akrepat janë shkakuar të 99 vdekjeve brenda tetë vjetëve. Duke përdorur të dhënat e "Centers for Disease Control and Prevention", hulumtuesit kanë zbuluar se 72 njerëz janë mbytur nga kafshët tjera, siç janë kuajt, macet dhe derrat. Vetëm gjashtë njerëz vdesin në vit nga kafshimi i gjarprit dhe gjashtë nga helmi i merimangës.

### STUDENTI

Një student e zë një peshk të artë. Më lësho dhe do ta plotësoj një dëshirë - thotë peshku. Si një? A nuk janë tri? - pyet me habi studenti. Eee, tash është me sistemin e Bolonjës...



E gjithë urtësia njerëzore përmbahet në këto dy fjalë: prit dhe shpreso. (Alexander Dumas)



KALENDARI HISTORIK 8 MAJ



A E DINI SE...



BARSOLETA



THËNIA E DITËS